



Kompania Rajonale e Ujësjetjesit

*Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija*

RAPORTI VJETOR 2021

K.R.U. "GJAKOVA" SH. A.

GJAKOVË



Përgatitur në Shkurt, 2022

KRU "Gjakova" Sh.A.

Te dhënat për kompaninë

KRU "Gjakova" Sh.A. Gjakovë ka kapacitet dhe mund të furnizon me ujë të pijshëm rreth 230.000 banor, me kapacitet 1000 lit/sec, apo prodhim të ujit të pijes në sasi prej 86.400 m³ në ditë. Në kemi: Kaptazhën në lumin Bistrica të Deçanit, Kanalin derivues prej 9 km, Liqenin e Radoniqit si i vetmi burim dhe burimet e fshatrave Damjan 1 & 3, Gërquinë, Opterushë, Hoqë e Madhe, Senoc, Drenoc dhe burimin në Batushë, që shërbejnë për furnizim për këto fshatra, Kapaciteti (Maksimal) i Liqenit është 117 milion m³ kur është i mbushur plotë, në kotën mbidetare prej 456 m, gjatësia maksimale e Liqenit është 5.035 m, gjerësia maksimale e Liqenit është 2.100 m', thellësia maksimale është 61 m, sipërfaqja e Liqenit me ujë në kuotën maksimale është 644 hektar. Stacioni i filtrave për trajtimin e ujit faza I & II, 40 rezervuare të ujit me kapacitet prej: 23.543 m³, 36 stacione pompimi, rrjet primar dhe sekondar të ujësjellësit të rrethoruar në ArcMAP 1.213 km. Përveç furnizimit me ujë të pijshëm KRU "Gjakova" bënë shërbime për menaxhimin dhe largimin e ujërave të përdorura me një rrjet prej: Gjakovë 58 km, rrjet kanalizim fekal të regjistruara në Arc GIS, dhe Rahoveci 23 km, rrjet kanalizimi fekal, në kuadër të rrjetit kemi edhe 1865 puseta të kanalizimit fekal dhe 1355 puseta të kanalizimit atmosferik.




Foto nga mbulueshmëria me furnizim me ujë nga KRU Gjakova (2021)

I. HYRJE

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2021. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese.

Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2021 ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbështet për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

FJALA HYRESE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV



Visar Hasi

**U.D. Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Ujësjellësit
"Gjakova" SH.A. –Gjakovë**

K.R.U. " Gjakova" SH.A. falë angazhimit të përkushtuar të gjithë punonjësve ka arritur që ti tejkaloj vështirësit që pandemia ka shkaktuar , dhe ka arritur të përmbyll pasqyrat financiare me një rezultat pozitiv dhe të kënaqshëm operativ, duke ruajtur trendin pozitiv të ngritjes së realizimit të hyrave të përgjithshme, veçanërisht tek të hyrat e konsumatorëve të mëdhenj, dhe të hyrat tjera operative. Ka arrit maksimumin e zhvillimeve pozitive në të gjithë treguesit e performancës së ndërmarrjes, me theks të veçante është bërë arritje maksimale në treguesit kryesor te performances .

Në drejtim të kryerjes së punëve operative teknike Ndërmarrja është munduar që të arrijë rezultatet e planifikuara. Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit është arritur që të mirëmbahet sipas planit të paraparë. Suksesi është arritur përmes organizimit të punës, formimit të grupeve të rregullta të kontrollës të cilët në kontinuitet kanë inspektuar rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Falë ndihmës së institucioneve vendore, donatoreve ndërkombëtar, si dhe mjeteve tona vetanake me një profesionalizëm të lartë është arrit Implementimi i suksesshëm i të gjitha projekteve të planifikuara .

Me një organizim maksimal te stafit te kësaj Njësie kemi arritur që të kemi furnizim të mjaftueshëm të Liqenit me ujë, te sigurojmë ujë të pastër dhe cilësor gjithmonë duke i plotësuar standardet e kërkuara nga rregullorja për kualitet të ujit nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (I.K.SH.P).Në aspektin e Prodhimi i ujit është prodhuar me kapacitet të plotë, aq sa kishte nevojë për furnizim të gjithë konsumatorëve.

Në anën tjetër KRU"Gjakova" me sukses ka realizuar planin e biznesit edhe në aspektin e realizimit të projekteve, duke arrit kështu të implementoj projektet e planifikuara, të cilat kanë pas impakt në rritjen e performances teknike, zvogëlimin e humbjeve të ujit, zvogëlim të shpenzimeve operative, rritje/maksimizim të ardhurave dhe furnizim më kualitativ për konsumatorët.

Menaxhmenti i Kompanisë gjatë vitit 2021, si dhe tërë stafi i Kompanisë janë munduar me përkushtimin e tyre maksimal ti arrijnë caqet e dëshiruara të biznesit dhe konsumatorit ti ofroj shërbimet më të mira. Nuk ka munguar bashkëpunimi me Konsumatorin, informimi i vazhdueshëm i tyre për shërbimet, shqyrtimi me kohë dhe ne mënyrë efektive të kërkesave të tyre, intensifikimin i aktivitetit për zvogëlimin e humbjeve te ujit, rritjen e faturimit dhe arkëtimit, si dhe organizimit të punës dhe motivimit të mirë të stafit.

Gjithashtu Kompania ka qenë shumë aktive në revidimin dhe konsolidimin e kornizës ligjore e regullative .

Opinionin e Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2021 , me auditimin e bërë gjatë vitit 2021, e prezanton qartë punën profesionale dhe përkushtimin e Ekzekutivit në zbatimin e

standardeve më të larta në proceset e punës. Kompania me mjete vetenake ka arrit ti kryej me kohë obligimet e klientëve dhe institucioneve të Shtetit të Kosovës .

Për fund posaçërisht falënderojë Bordin e Drejtorëve të K.R.U. " Gjakova " SH.A. Gjakovë për përkrahje të vazhdueshme dhe inkurajuese për projektet dhe përkrahjen e Menaxhmentit të K.R.U. "Gjakova " SH.A. Gjakovë. Falënderojmë NJPMNP dhe partnerët tanë afaristë, që pa bashkëpunimin reciprok nuk do të kishim mundur të përmbyllim këtë vit suksesesh.

Mbi të gjitha më lejoni të shpreh mirënjohje dhe respekt për madhërinë e tij - Konsumatorin tonë besnik , i cili na beson dhe i pëlqen produkti i jonë , ujë me cilësi, sasi dhe shtypje të mjaftueshme, me furnizim 24 orësh, e që shpresojmë të kenë begatuar dhe lehtësuar shumë nevojat e përditshme dhe jetën e tyre në përgjithësi .

FJALA HYRESE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Viti 2021 për KRU "Gjakova" ka qenë vit i sfidave, pandemia preku si te gjitha bizneset edhe biznesin tonë, u munduam ta tejkalonim me nje angazhim maksimal të punëtorëve menaxhmentit, kuptohet me përkrahjen maksimale edhe të Bordit të Drejtorëve . Ne si Bord i Drejtorëve jemi përpjekur që të kemi një rrol aktiv në mbështetje të menaxhmentit në realizimin e objektivave të Kompanisë të përcaktuara në Planin e Biznesit të Ndërmarrjes si dhe duke zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet në fuqi .

Gjatë vitit 2021, Bordi i Drejtorëve ka zhvilluar 12 mbledhje te rregullta, 1 Mbledhja jashtezakonshme, dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Akcionarin per vitin 2020. Në periudhat midis mbledhjeve Bordi i Drejtorëve ka marrë vendime qarkulluese kur ka qenë e nevojshme, ka monitoruar rregullisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse performancën e KRU "Gjakova" Sh.A. dhe zhvillimet e rrezikut brenda saj, janë zhvilluar rregullisht diskutime me anëtarët e Drejtorisë në lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit dhe likuiditetit, si dhe mbi drejtimin e aktivitetit të Ndermarrjes dhe strategjitë e rrezikut. Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar gjithashtu në mënyrë të hollësishme zhvillimet e mëtejshme në lidhje me qeverisjen e korporatës dhe ka monitoruar zbatimin e politikave përkatëse. Gjatë veprimtarisë së tij monitoruese dhe këshilluese, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur kontakte të drejtpërdrejta me punëtorët përgjegjës të Drejtorive, audituesin, si dhe drejtuesit tjerë përgjegjës për funksionet e ndermarrjes. Ai gjithashtu ka pasur një shkëmbim të vazhdueshëm informacioni dhe pikëpamjesh me përfaqësuesit e autoriteteve mbikqyrëse për çështje me rëndësi. Gjithashtu, Bordi i Drejtorëve nga drejtoritë ka marrë raporte të rregullta dhe të hollësishme për çështje të rëndësishme në lidhje me performancën në fushat përkatëse të aktivitetit të Ndërmarrjes. Bordi i Drejtorëve ka kryer detyrat e tij të përcaktuara në legjislacionin, statutin e Ndermarrjes dhe Kodin e Etikes. Gjatë mbledhjeve tremujore ai ka diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me Ndermarrjes duke u kushtuar vëmendje të veçantë në formën e 'temave në fokus'. Dëshiroj të përfitoj nga rasti për të falënderuar klientët tanë për besimin e tyre të vazhdueshëm dhe të gjithë punonjësit e KRU "Gjakova" Sh.A. për punën e tyre të palodhur dhe përpjekjet e palëkundura gjatë vitit 2021, si dhe për të kërkuar angazhimin e tyre të vazhdueshëm për të përballuar çdo sfidë që po kalojmë.

Duke e përmbyllur këtë fjalë dhe duke iu referuar të dhënave, të cilat do të gjeni në këtë raport, kam kënaqësinë të përgëzoj Kryeshefin Ekzekutiv, të gjithë menaxherët, zyrtarët dhe punonjësit e kompanisë tone për punën e zellshme që kanë bërë. Njëkohësisht një falënderim dhe mirënjohje e veçantë për të gjithë institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat kontribuuan për suksesin tonë.

2.1 AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDERMARRJES

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë arritja e realizimit të objektivave të planifikuara për vitin 2021 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera nga aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2021. Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2021 si edhe vitet tjera ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Janë hartuar nga ekzekutivi dhe aprovuar nga BD një serë rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve, si dhe Planifikimi i Biznesit për periudhën 2021-2023.

KRU "Gjakova" Sh.A. gjatë vitit 2021 ka realizuar performancë pozitive në të gjithë treguesit e performancës krahasuar me vitin 2020 dhe BP e vitit 2021 e që në mënyrë detale janë të prezantuara në kriteret e kërkuara si më poshtë në këtë raport .

Punët Administrative -janë hartuar dhe aprovuar një sërë rregullore të brendshme të Kompanisë ,manuale , si dhe akte tjera të cilat kanë bërë që puna të kryhet në mënyrë profesionale dhe e bazuar në infrastrukturën ligjore të ligjeve në fuqi në Kosovë.

Raportet teknike , financiare dhe administrative prezantojnë në mënyrë të përgjithësuar të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Kompania, sa janë realizuar ato duke i prezantuar përmes tabelave dhe diagrameve si dhe duke dhënë sqarime detale për të gjitha shifrat dhe faktet e prezantuara përmes raporteve teknike, financiare dhe administrative.

Aktiviteti i Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2021 i ka mbajtur 12 Takime të rregullta me përbërje të plotë, 1 mbledhje të jashtëzakonshme dhe mbledhje të përgjithshme me Aksionarin . Në kuadër të Bordit të drejtorëve funksionon edhe autoriteti i zgjedhur nga Qeveria -Komisioni i Auditimit i cili gjithashtu i ka mbajtur gjithsejtë (12 takime).

Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv. Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme. Bordi i Drejtorëve duke mos dalur nga suazat e kompetencave si autoritet i emëruar për përfaqësimin e aksionarit të plotësisht në harmoni me Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe në harmoni me interesat e aksionarit ka marr vendime me të cilat ka aprovuar :

Vendimet dhe Qëndrimet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit të emëruar me dt.

14.01.2021 me nr protokoli 598

Mbledhja e Komisionit të Auditimit Nr. 1 dt. 26.01.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : Plani Strategjik i zyres së Auditimit për periudhën 2021-2023 në KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove ; Aprovohet Plani Vjetor për vitin 2020 i Njesisë së Auditimit në KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove ; Aprovohet te Raportit vjetor NJAB për vitin 2020 dhe të specifikohet me fusnote qdo e gjetur i Njesisë së Auditimit në KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove ; Aprovohet Raporti gjashtemujor I NJAB për aktivitetet e kryera për periudhën Korrik-Dhjetor 2020 në KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove ; Aprovohet Raportit final Auditimit Procesi për Menaxhimin e Marredhenies me Konsumator në KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove

QËNDRIME -u aprovua : Draft Raportit per Menaxhimin e Procedurave te faturimit percillet njesise se faturimit per komente ; Ndryshimi – plotesimi Statutit të KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë percillet per aprovim në mbledhjen e BtD ; Raporti financiar i bashkangjitet Raportit te KE per muajin Nentor-Dhjetor për aprovim në mbledhjen e BTD ; Aprovohet Raportin final per Menaxhimin e Procedurave te faturimit ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë ; Komisioni Auditimit shqyrtoi dhe diskutoi Raportin Vjetor 2020 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste dhe njeherit muar ;Raporti Vjetor 2020 percillet per aprovim mbledhjen e Bordit Derjtoreve.ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë.

Mbledhja Komisionit Auditimit nr 2. e mbajtur me 23.02.2021 u murrën këto:

QËNDRIME -u aprovua : Raporti IV tremujor Tetor-Dhjetor 2020 mbi zhvillimn e aktiviteteve afarsite ne KRU'Gjakova'sh.a-percillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Derjtoreve ; Raporti mujor Janar 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE percillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Kërkesa për shtijen e materialit jashtë përdorimit përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ;

Mbledhja Komisionit Auditimit nr. 3 e mbajtur me 25.03.2021 u murrën këto:

QËNDRIME -u aprovua : Draft Raportit Sistemi per menaxhimin e procedurave te Prokurimit dhjetor 2019-2020 te plotesohet me i detalizuar per mbledhjen e ardhshme te Komisionit Auditimit ; Raporti mujor Shkurt 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE percillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Kërkesa e KE KE për marrjen në shfrytezim ngastrës me nr.4447-1 në ZK Gjakovë, për ndërtimin e objekteve,për nevoja e KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë përcillet për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

Mbledhja e Komisionit Auditimit nr. 4 e mbajtur me 23.04.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovu : Raporti final Sistemi per menaxhimin e procedurave te Prokurimit per periudhen Dhjetor 2019- Dhjetor 2020.

QËNDRIME-u aprovua : Draft Raporti Sistemi për Menaxhimin e Njesisë se Arkives përcillet per komente Dep Administratës; Raporti mujor Mars 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE percillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Draft Rregullorja duhet te korigjohet pjesa teknike pastaj të përcillet në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Kerkesa për qështjen së korigjimit të obligimit të TVSH ne bilancin e gjendjes konti 4620 në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë i përcillet për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

Mbledhja e Komisionit te Auditimit nr 5 mbajtur me 27.05.2021. u murrën këto:

VENDIME -u aprovua : Raporti final Sistemi për Menaxhimin e Njesisë se Arkives përcillet për zbatim Dep Administratës.

QËNDRIME - u aprovua : Raporti mujor Prill 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE percillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Raporti Auditorit Jashtëm dhe Letra Menaxhmentit 2020 KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Raporti tremujor TM1 Janar-Mars 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Draft Rregullorja për administrimin dhe arkivimin e dokumentave zyrtare në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 6 mbajtur me 22.06.2021 u murrën këto :

QËNDRIME - u aprovua : Draft Raporti Sistemi për Menaxhimin e Autoparkut në KRU'Gjakova'SH.A-Gjakove Mars 2020 -Mars 2021 percillet per komente Njesisë së Autoparkut, Të specifikohet se cilat Njesi jane audituar – Njesia e Gjakoves, Rahovecit , Prizrenit., dhe sa mostra jane audituar; Raporti mujor Maj 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE percillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Draft Rregulloren për mbrojtjen dhe sigurinë ne pune te punëtoreve në KRU"Gjakova" SH.A –Gjakovë dhe Rregulloren për provizionimin e llogarive te arkëtueshme KRU"Gjakova" SH.A –Gjakove dhe Raportin e Komisionit për borgje kontestuese të formuar KRU"Gjakova"sh.a, përcillen për shqyrtim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë

Vendimet dhe Qëndrimet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit të emëruar me dt. 16.07.2021 me nr protokolli 668

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr.1mbajtur me dt. 27.07.2021 ,u murrën këto:

VENDIME -u aprovua : Aprovohet Raporti final Sistemi per menaxhimin e Autoparkut në KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove i njeiti percillet per zbatim Njesise se Autoparkut ;Te shpallet konkursi per pozicionin e punës Auditor Brandshëm në KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove duke rrespektuar Rregulloret dhe Ligjet.

QENDRIME -u aprovua : Plotesim Ndryshimi Statutit te nenit 14.2 percillet per aprovim ne mbledhjen e Bordit Drejtoreve; Raporti mujor Qershor 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE përcillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 2 mbajtur me datë 27.08.2021 u murrën këto

QENDRIME -u aprovua : Draft Raporti Sistemi për Menaxhimin e të Hyrave në Arkë dhe në Bankë" për periudhën Gusht 2020 - Korrik 2021 percillet per komente dep financiar ; Raporti TM2 Prill – Qershor 2021 mujor Korrik 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste përcillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Raporti mujor Korrik 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE përcillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.Raportet financiare kur te krahasohen, te krahasohen për secilin muaj. Por te krahasohen edhe me muajt ne vijim dmth muajt e vitin e kaluar me muajt e vitit vijues. Te kemi një pasqyrë te qarte kronologjike për dymbëdhjetë muaj ;Raporti i kontrolles se ATK nuk eshte paraqitur ne mbledhjen e kaluar , ky veprim sjell ne situata që KA nuk ka besim tek dokumentet e paraqitura për vlerësimin e gjendjes financiare të kompanisë.

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 3 të mbajtur me datë 27.09.2021 u murrën këto :

VENDIME -u aprovua : Raporti Sistemi për Menaxhimin e të Hyrave në Arkë dhe në Bankë" për periudhën Gusht 2020 - Korrik 2021.

QENDRIME -u aprovua : Raporti mujor Gusht 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE përcillet per aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.Raportet financiare kur te krahasohen , te krahasohen për secilin muaj. Por te krahasohen edhe me muajt ne vijim dmth muajt dhe vitin e kaluar me muajt e vitit vijues. Te kemi një pasqyrë te qarte kronologjike për dymbëdhjetë muaj.

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 4 të mbajtur me datë 25.10.2021 u murrën këto :

QËNDRIME – u aprovua 1.Të bëhet ndarja e përqindjes së inkasimit ndërmjet muajit aktual dhe mjeteve të inkasuara të periudhave të mëhershme ,**2.** Të bëhet analizë mujore e vjetërsisë së borxheve , **3.** Të zbatohet Udhëzuesi për Menaxhimin e Borxheve në Sektorin Publik dhe të analizohet në baza mujore numri i konsumatorëve për dërgim te përmbaruesi ; Gjithashtu Komisioni auditimit kërkoj qe te vendoset për blerjen e softuerit ne mbledhjen e Bordit. Te shikohen modulet te cilat kane përparësi me te madhe te cilat janë te domosdoshme si psh . matja e ujit e cila regjistrohet manualisht.etj; Raporti mujor Gusht 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

Qëndrimi është marr ne mbledhjet e kaluara te KA :Raportet financiare kur te krahasohen, te krahasohen për secilin muaj. Por te krahasohen edhe me muajt ne vijim dmth muajt dhe vitin e kaluar me muajt e vitit vijues. Te kemi një pasqyrë te qarte kronologjike për dymbëdhjetë muaj .Te paraqiten forme tabelare dhe me grafike ne menyre qe te lexohet me mire

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 5 të mbajtur me datë 24.11.2021 u murrën këto :

VENDIM- u aprovua : Raporti final Sistemi për Menaxhimin e Procedurave Ligjore" për periudhën Gusht 2020 - Gusht 2021.

QËNDRIME -u aprovua : Raporti mujor Tetor 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.Të bëhet shpalosja e zërit të shpenzimeve të reprezentacionit, shpalosja e zërit rregullimet e borgjeve të konsumatorëve,për mbledhjen e Bordit.Humbjet e ujit pse kanë ngritje raport nga dep përgjegjës, faturimi pse ka rënie raport të detajuar në mbledhjen e Bordit.Të paraqiten në formë tabelare dhe me grafike në mënyrë që të lexohet më mirë ; Raporti tremujor TM3 Korrik-Shtator 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; Rregulloret përcillen për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr 6 të mbajtur me datë 21.12.2021 u murrën këto :

QËNDRIM - u aprovua - Raporti përcillet për komente Njesisë së Faturimit, me të gjeturat e mëposhtme ;Raporti mujor Nëntor 2021 i performancës Operative Financiare i bashkangjitur me raportin e KE përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve ; UD KE me nr protokolli 741 për shpërblimin e punëtorëve në K.R.U "Gjakova" sh.a.-Gjakovë Kërkesa e KE përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

Vendimet dhe Qëndrimet nga mbledhjet e Bordit të Drejtoreve të emëruar me dt. 31.12.2020 me nr protokolli 597

Mbledhja Nr: 1 e mbajtur me dt. 28.01.2021

VENDIME - u aprovua : Raporti mujor KE Nëntor -Dhjetor 2020 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në K.R.U "Gjakova" SH.A. –Gjakovë me disa korrigjime ; Aprovohet plotësim ndryshimi Statutit të Kompanisë neni 14 paragrafi 2.1 në KRU 'Gjakova"sh.a-Gjakovë ;Aprovohet unanimisht kërkesa e KE me nr protokolli 602 për plotësim ndryshim te Rregullores për Paga dhe Rregullores mbi Organizim te Brendshëm në KRU 'Gjakova"sh.a-Gjakovë.

Mbledhja Nr: 2 e mbajtur me dt. 26.02.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : Raportit IV-tremujor Tetor –Dhjetor 2020 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove ;Aprovohet unanimsht Raportit Vjetor 2020 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë ;Aprovohet Raporti mujor KE Janar 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në K.R.U "Gjakova" SH.A. –Gjakovë me disa korrigjime ; Aprovohet unanimsht shitja e materialit jashtë përdorimit me plotësimet e fundit te përcjellura përmes emailit dhe te ndiqen procedurat e prokurimit publik

Mbledhja Nr: 3 e mbajtur me dt. 31.03.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : Raporti të Hulumtimit të Kënaqësisë së Konsumatorëve 2020 për KRU"GJAKOVA "sh.a-Gjakovë ; Aprovohet unanimsht Raporti mujor KE Shkurt 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove ; Aprovohet unanimsht qe te lejohet te fillohet me procedurat per marrjen në shfrytëzim ngastrës me nr.4447-1 në ZK Gjakovë, për ndërtimin e objekteve,për nevoja ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë ;Aprovohet unanimsht kërkesa e KE me nr protokolli 619 per dhenien me qera te parcelave me nr 5318-2 dhe 7051-1 ZK Prizren ne pronësi të KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove ne menyre qe te krijohen te hyra për Kompaninë ne afat prej 10 vite.

Mbledhja Nr. 4 e mbajtur me dt. 07.05.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : Rregullorja për Përgjegjësinë Diciplinore në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë; Aprovohet unanimsht kërkesa e menaxhmentit për rregullimin e qështjes së korigjimit të obligimit të TVSH në bilancin e gjendjes konti 4620 në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë.

Mbledhja nr. 5 e mbajtur me dt. 31.05.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : unanimsht Raporti mujor KE Mars -Prill 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove ; Aprovohet unanimsht Rregullorja për administrimin dhe arkivimin e dokumentave zyrtare në KRU"Gjakova" SH.A –Gjakovë ; Aprovohet unanimsht Raporti Auditorit Jashtëm dhe Letra Menaxhmentit 2020 për KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë ; Aprovohet unanimsht Raportit I- tremujor Janar-Mars 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë.

Mbledhja Nr: 6 e mbajtur me dt. 29.06.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : unanimsht Raporti mujor KE Maj 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove ; Aprovohet unanimsht kërkesa e KE me nr protokolli 655 për plotësim ndryshim të Rregullores mbi Organizim të Brendshëm në KRU 'Gjakova"sh.a-Gjakovë, dhe Rregullores për Paga me pozicionet e punës Inxhinier i Proceseve ne ITUN me koeficient 2.92. dhe Shef i Njesise së Arhivës 2.60

Vendimet dhe Qëndrimet nga mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të emëruar me dt. 14.07.2021 me nr protokolli 667

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve Nr: 1 Data: 30.07.2021

VENDIME - u aprovua : Raporti KE Qershor 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakovë ; Aprovohet unanimsht ndryshimi -plotësim Statutit te Kompanise neni 14 paragrafi 2.1 në KRU'Gjakova'sha.-Gjakove.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve Nr: 2 Data: 30.08.2021

VENDIME - u aprovua : Raporti mujor Korrik 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në K.R.U "Gjakova" SH.A. –Gjakovë ;Unanimisht aprovohet Raporti tremujor TM2 Prill- Qershor 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve nr. 3 të mbajtur me datë 30.09.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : Raporti mujor KE Gusht 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve Nr: 4 Data: 28.10.2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : Raporti mujor Shtator 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në K.R.U "Gjakova" SH.A. –Gjakovë ; Ndryshohet Statuti i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Gjakova" SH.A, në Gjakovë . Ky ndryshim bëhet në pajtim me Nenin 197, paragrafi 1, të Ligji Nr. 16/L-016 për Shoqëritë Tregtare. Ndryshimet në Statut janë: Emëri i ish Kryeshef Ekzekutiv z.Ismet Ahmeti me nr personal 1009604690 largohet dhe plotësohet me UD.Kryeshef Ekzekutiv z.Visar Hasi me nr personal 1001447056 (neni 14 paragrafi 2.1); Unanimisht aprovohet Plan Biznesi 2022-2024 në KRU"Gjakova"sh.a-Gjakovë.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve Nr: 5 Data: 30.11. 2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : Raportit mujor Tetor KE 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova'sh.a-Gjakovë ; Aprovohet unanimisht Raportit tremujor TM3 Korrik- Shtator 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova'sh.a-Gjakovë ; Aprovohet unanimisht Rregullorja mbi sigurinë dhe shëndetin në punë KRU'Gjakova'SH.A-Gjakovë ; Aprovohet unanimisht Rregullorja për Menaxhimin e Aseteve në KRU'Gjakovë'SH.A-Gjakovë

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve Nr: 6 Data: 29.12. 2021 u murrën këto :

VENDIME - u aprovua : Raporti mujor Nëntor U.D. KE 2021 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU'Gjakova'sh.a-Gjakovë ;Unanimisht aprovohet kërkesa e U.D.Kryeshef Ekzekutiv me nr protokoli 745 lidhur me shpërbimin e punëtorëve me rastin e festave të fundvitit në vlerë monetare prej 50 Euro.

2.1.2 Pasqyra e performances operative dhe financiare ne krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Bordi në mënyrë të rregullt ka vlerësuar parametrat e performances së Kompanisë. Krahasuar me vitin 2020 dhe Planifikimin e Vitit 2021, Kompania ka arritur që ti realizoi pothuajse të gjitha caqet e objektivave .

Pasqyra e performances operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Treguesit kryesor te performances		Caqet e realizuara 2020	Caqet e realizuara 2021	Ndryshimi	Caqet e planifikuara BP 2021	Caqet e realizuara 2021	Ndryshimi
1.	Uji i prodhuar në m3	15,202,835	15,910,071	+707,236	16,038,873	15,910,071	-128,802
2.	Uji i faturuar në m3	8,856,057	9,167,666	+311,609	9,391,235	9,167,666	-223,569
3.	Konsumatorë të regjistruar	41,851	43,816	+1,965	45,083	43,816	-1,267
4.	Nr. i faturave të lëshuara	41,851	43,816	+1,965	45,083	43,816	-1,267

5.	Nr. i kons. që faturohen sipas lex.ujm	41,713	43,704	+1,991	45,083	43,704	-1,379
6.	Ujii faturuar për kons. me ujmatësa	8,756,726	9,103,113	+346,387	8,733,849	9,103,113	+369,264
7.	Faturimi nga uji në Euro	4,370,218	4,662,378	+292,160	4,695,618	4,662,378	-33,240
8.	Arketimi nga uji në Euro	4,164,967	4,816,922	+651,955	3,756,494	4,816,922	+1,060,428
9.	Te hyrat tjera operative ne Euro	78,385	113,953	+35,568	24,000	113,953	+89,953
10.	Shpenzimet operative	3,744,120	3,685,225	-58,895	3,900,717	3,685,225	-215,492
11.	Shlyerja e borxheve ndaj kons.	0	0	0	0	0	0
12.	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët	0	0	0	0	0	0
13.	Parat e gatshme në bank dhe në arkë	416,808	1,483,039	+1,066,231	336,853	1,483,039	+1,146,186
14.	Stoqet	713,756	662,614	-51,142	800,000	662,614	-137,386
15.	Llogarit e arkëtueshme nga uji	11,129,149	10,024,368	-1,104,781	12,087,290	10,024,368	-2,062,922
16.	Llogarit e pagueshme	17,104,676	16,920,719	-183,957	16,338,791	16,920,719	+581,928
17.	Numri i punetoreve	287	293	+6	307	293	-14
18.	Numri i ankesave	427	324	-103	400	324	-76
19.	Numri total i testeve të	2,618	2,882	-264	3,000	2,882	-118
21.	Matja e treguesve ne %						
22.	Uji i pa faturuar	42%	42%	0	41%	42%	+1
23.	Përqindja e faturimit	100%	100%	0	100%	100%	0
24.	Përqindja e konsumit të matur	99%	99%	0	93%	99%	+6
25.	Proporcioni i kons. Me ujmatësa	100%	100%	0	100%	100%	0
26.	Efikasiteti i stafit	6.86	6.69	-0.17	6.81	6.69	-0.12
27.	Shkalla e inkasimit në % (të)	95%	103%	+8%	80%	103%	+23%
28.	Shkalla e inkasimit në % -	93%	107%	+14%	87%	107%	+20%
29.	Shkalla e inkasimit në % -	93%	101%	+8%	94%	101%	+7%
30.	Shkalla e inkasimit në % -	113%	84%	-29%	75%	84%	+9%
31.	Norma e mbuleses së punes	1.14	1.34	-0.2	0.97	1.34	+0.37
32.	Norma e punes	1.20	1.30	-0.1	1.21	1.30	+0.09
33.	Shpenz.Operative per	7.40	7.01	-0.39	7.21	7.01	-0.2

Prodhimi i ujit në m3 -Prodhimi i ujit në vitin 2021, krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2020 ka rezultuar me një rritje prej 707,236 m³, ndërsa krahasuar me BP ka zvogëlim prej 128,802 m³. Falë kapaciteteve të prodhimit, kemi arritur të sigurojmë 24 orë ujë te pijes për konsumator.

Faturimi ne € -Në vitin 2021 faturimi në Euro është më ilartë se ne vitin 2020 për 292,160 euro ndërsa krahasuar me BP 2021 ka zvogëlim në vlerë prej 33,240 €. Rritje të faturimit gjatë vitit 2021 duke krahasuar me vitin 2020 ka ndodhur pasi në vitin 2020 si pasojë e Pandemis me Covid 19, shumë Institucione kanë qenë të mbyllura.

Arkëtimi në Euro – Në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, vlera e arkëtimit nga uji në Euro ka rritje për 651,955 € me shumë, ndërsa për 1,060,428€ më shumë se BP 2021. Rritja e arkëtimit në vitin 2021 ka ndodhur pasi viti 2020 ka qenë vit pandemit si dhe Biznes Planin 2021 Kompania e ka bërë duke pasur parasysh Pendemin dhe arkëtimi mund të bjerë në vitin 2021 njejt siq ka ndodhur në vitin 2020.

Shpenzimet Operative -Në vitin 2021 kanë qenë për 58,895 € më të ulëta se vitin 2020, kurse për 215,492 € më i ulët se BP 2021, si rezultat i rritjes së aktivitetit të Kompanisë për ngritje te performances me kushte me te mira te punës.

Humbjet e ujit -Në vitin 2020, humbjet e ujit janë 42%, njejt me vitin 2021, kurse për 1% më i lart se BP 2021.

Fitimi operativ – Vitin 2021 e kemi mbyllur me Fitim operativ prej 1,245,650 €. Krahasuar me vitin 2020 fitimi operativ në Euro ka qenë me i lartë për 716,247€ . Fitimi Operativ është më i

lart se viti 2020 si dhe se BP 2021 pasi gjithmonë duhet të kemi parasysh se viti 2020 ka qenë vit pandemik dhe Biznes Planin Kompania e ka bërë duke pasur parasysh Pandemin dhe si pasojë zvogëlohet arkëtimi. Fitimi operativ fitohet kur nga arkëtimi i zbresim shpenzimet operative.

Nr. i punëtorëve- Në vitin 2021 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2020 është më ulët për 14 punëtorë, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ka pas 6 punëtor më shumë . Numri i punëtorëve ka ngritje pasi janë marrë punëtor të rinj në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura.

Nr. i testeve të dështuara - Në vitin 2021, i plotësojnë standardet e kërkuara sipas IKSHP. Numri i tyre gjithmonë tregon treguesin 0%.

Nr. i konsumatorëve- Në vitin 2021 krahasuar me numrin e konsumatorëve ne vitit 2020 ka rezultuar me rritje prej 1,965 ndërsa krahasuar me BP 2021 numri i konsumatorëve ka rënie prej 1,267 konsumator nga mos parashikimi i saktë i tyre.

Parat e gatshme në bankë dhe në arkë- Me 31.12.2021 paraja ka qenë 1,483,039 qe është për 1,066,231€ më shumë se në vitin 2020 dhe për 1,146,186€ më shumë se BP 2021. Paraja përfshin paranë në arkë dhe bank si dhe mjetet vetanake si dhe ato nga donacionet për ITUN.

2.1.3 Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Top çështjet tjera të cilat do mund të përcaktojnë të ardhmen e Kompanisë janë :

- Krijimi në vazhdimësi i kushteve më të volitshme të infrastrukturës ujore dhe të kanalizimit për konsumatorët tonë.
- Funkionimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, e cila do të dutet në funksion në vitin 2022 dhe do të jetë biznes i ri për Kompanin.
- Zgjidhja e çështjes financiare të obligimeve financiare të rregullta mujore ndaj ARRU-se, MMPH etj.
- Arkëtimi i borxheve të vjetra sipas Saldo 31.12.2021, sipas Ligjit në mënyrë të detyrues.
- Realizimin e Marrëveshjeve për borxhet e pa paguara, me konsumatorët borxhli për ri-Programim të borxheve ndaj KRU-së.
- Pajisja me ujëmatës të mençur i të gjithë kategorive të konsumatorëve.
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit të pijes.
- Furnizimi me ujë i fshatrave të Rekes se Keqe.
- Lidhja e Marrëveshjeve të shërbimeve me konsumatorët.
- Përmirësimi i menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë, mbajtja nën kontroll e nivelit të prodhimit i cili nga ana tjetër është i lidhur me koston e prodhimit, në veçanti shpenzimet e energjisë elektrike të cilat shpenzime janë të lidhura direkt me nivelin e prodhimit, ulja e nivelit të prodhimit ndikon edhe në uljen e koston së këtyre shpenzimeve.
- Angazhimi maksimal i Sektorit të Planifikimit e Zhvillimit në hartimin e Projekteve investive kapitale, për aplikimin tek aksionari Qeveria e Kosovës, Donatorët, Bankat, etj.
- Realizimi me kohë i Projekteve
- Zhvillimi i raporteve të vazhdueshme me Institucionet vendore dhe donatorët ndërkombëtar.
- Rritjen e investimeve kapitale nga mjetet vetanake.
- Gatishmëria teknike dhe furnizimi i duhur me makineri të rëndë për nivelin e duhur të operativës.

2.1.4 Pasqyrë e të pritave për vitin e ardhshëm

Kompania do të vazhdojë punën në vitin e ardhshëm në mirëmbajtjen dhe aktivitetin e avancimit të funksioneve të operimit si dhe do të realizojë treguesit operativ dhe financiar sipas objektivave të përcaktuara në Plan Biznes 2021:

- Menaxhimi i prodhimit të planifikuar në 16,433,975 m³,
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë për-1.0 %
- Rritjen e sasisë së ujit të shitur, të faturuar për + 6.37%
- Rritja e arkëtimit të faturuar në 93%
- Rritja e arkëtimit të borxheve në masën prej +5%
- Rritjen e shpenzimeve jo operative për+ 12.34%
- Investime vetanake kapitale 2,562,073 euro dhe nga donacionet 5,394,683 euro hyjnë edhe investimet në Impiantin e ujërave të zeza.

Në aspektin e aktiviteteve thelbësore të biznesit edhe në vitin 2022 do të vazhdojë me veprimet e duhura të punëve operative në terren ;

Furnizimi i konsumatorëve me ujë cilësor, - mirëmbajtja e funksionalitetit të mbarë infrastrukturës, investime të planifikuara dhe aty ku mundë të shfaqen, e ku do të vlerësohet se mundë të vihet në rrezik biznesi jonë.

Reduktimi në masë të madhe i rrezikut nga përmbajtjet nga kanalizimi fekal gjatë periudhave me të reshura me intensitet dhe kohë të tej zgjatur. Me qëllim të sigurimit të cilësisë më të mirë të shërbimeve për klient, KRU-ja do të veprojë në favor të ndërmarrjes së masave të shpejta dhe efikase ndaj kërkesave të arsyeshme dhe nevojave tjera të klientëve .

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për konsumatorët është një ndër detyrat kryesore të kompanisë. Në këtë drejtim angazhimi profesional nga ana e punëtorëve në një anë dhe investimet në rritjen e kapaciteteve të prodhimit, leximit-faturimit dhe inkasimit -arkëtimit në anën tjetër, do të ndikoi në rritjen e besueshmërisë së KRU"Gjakova"Sh.A. tek konsumatorët ,e që janë në pajtueshmëri të plotë me misionin dhe vizionin e Kompanisë .

Të arrijmë të përmbushim kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve në afatin minimal të mundshëm .

Të mbulojmë të gjitha kostot operative të Ndërmarrjes me përjashtim të amortizimit, me të ardhura nga parat e gatshme.

Do të bëjmë zvogëlimin e shpenzimeve të planifikuara për energji dhe karburante, si dhe do të bëjmë planifikimin e investimeve vetanake si dhe të aplikojmë për grante në Qeverinë e Republikës së Kosovës me projekte sipas planifikimit nga Sektori për Planifikim dhe Zhvillim.

Ngritja e të hyrave në periudhën vijuese mbledhja e borxheve nga vitet paraprake, do të mbetet një ndër prioritet më të larta të menaxhmentit. KRU-ja ka dy prioritet kryesore për të ngritur inkasimit – arkëtimin ; **Përmes Marrëveshjeve për Ri-programimin e borxheve** në mes të KRU-së dhe konsumatorëve borxhli që të paguajnë borxhet e vjetra sipas Saldo 31.12.2021 dhe faturat mujore të vitit 2021, e në rast dështimi opsion i fundit do jetë zgjidhja e kësaj çështjeje përmes; **Arkëtimit të detyruar** përmes çkyçjes duke bere çkyçjen nga rrjeti dhe, **kërkesa për përmbarimin e borxheve përmes Përmbaruesit Privat**. Planifikohen që për vitin e fundit sipas LMD të përcillen të gjithë konsumatorët borxhli të cilët nuk kanë paguar borxhet , tek përmbaruesit privat.

Riorganizimi dhe ristrukturimi i punëve dhe detyrave të punës sipas organizimit dhe sistematizimit të ri të hartuar nga Këshilli Ndërmnistror për Ujra gjegjësisht propozimit të hartuar nga Këshilltarët pranë këtij autoriteti .

Zhvillimin profesional të punëtorëve sipas Sektorëve të caktuar dhe të motivoi në arritjen e performances së standardeve më të larta si dhe të krijojë një ambient të sigurt pune.

Do të vazhdojë me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në radhë të parë me aksionarin tonë Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe me palët e interesit posaçërisht me ARRU, MZHE, MMPH, Kuvendet Komunale, Donatoret, etj.

2.2. Informacione ne lidhje me kapitalin dhe dividenden

Rivlerësimi i aseteve në KRU "Gjakova" Sh.A.-Gjakovë, e kemi kryer gjatë vitit 2020. Në pajtim me ligjet e aplikueshme, ky proces është kryer përmes një kompanie të licencuar për vlerësim dhe atë në bazë të Ligjit të prokurimit Publik. Vlera e aseteve pas rivlerësimit ka pasur ngritje, nga vlera neto e tyre në kontabilitet 31,811,412 në 43,068,810 dhe diferenca prej 11,257,399 i është shtuar kapitalit të Kompanisë si rezervë nga rivlerësimet, kurse vlera prej 215,270 euro janë zbrit rezervat e rivlerësimit duke rritur fitimet e mbajtura. Kapitali themelor i Ndërmarrjes në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 € aksione me vlerë nominale prej 1 € secili. Aksionar i vetëm i K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Gjakovë është - Qeveria e Republikës së Kosovës.

Të gjitha ndryshimet e kapitalit themelor, bëhen sipas përcaktimit në Ligjin Nr.02/L123 "Për Shoqëritë Tregtare" ku përfshihet shuma-parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksionit, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themelor, riblerja ose revokimi i aksionit.

Struktura e Kapitalit	Kapitali Aksionar në Euro
Kapitali aksionar në para	25,000
Rezervat e rivlerësimit	42,550,457
Humbjet e bartura	-1,055,768
Fitimit/Humbja financiare e vitit 2021	-58,397
Total ekuiteti dhe kapitali	41,461,291
Bilanci deri me 31.12.2021	41,461,291

2.2.1 Kredit e rëndësishme të nënshkruara apo të paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2021 nuk kemi hyrë në marrëdhënie kreditore.

2.2.2 Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2021

KRU "Gjakova" Sh.A. gjatë vitit 2021, ka bërë investime të shumta bazuar në planin e tij zhvillimor. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2021 janë realizuar me rregull dhe sipas afateve siç janë përcaktuar në Planin e Biznesit dhe në planin individual të Sektorit për Zhvillim dhe Projekte investive. Më poshtë janë përmendur projektet investive dhe burimet e financimit të projekteve në mënyrë të përgjithësuar, ndërsa statusi i tyre dhe detajet janë pjesë e këtij raporti. Gjatë vitit 2021 Kompania ka investuar në projektet e paraqitura në vijim nga mjetet e realizuara nga; donatorët, mjetet vetanake, dhe nga donacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KRU Gjakova, në muajin Gusht të vitit 2021, ka bërë instalimin e ujësjellësit për fshatrat e Hasit të Prizrenit.

Një tjetër projekt i rëndësishëm që ka filluar gjatë vitit 2021 është edhe ndërrimi i gypit nga AC më PE për fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol, i cili është financuar nga ME.

Gjithashtu vlen të theksohet se është punuar me intensitet të lartë për investimin shumë të rëndësishëm: Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Gjakovë, i cili pritet të përfundojë në gjysmën e parë të vitit 2022.

Investimet nga donacionet e KFW, Qeverisë , Komunave dhe vetanake për vitin 2021

Emri i Projektit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i kontraktuar	Dëshmi mbi punimet e realizuara
Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Hasit të Prizrenit – faza 1	Bashkëfinancim me Komunën e Prizrenit (51 *49%). Vlera financiare: 266,796.70 €	FIDANI-BETON SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K., Arben Qerimaj, Nr 180, Baballog/ Deçan	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 27.08.2021
Mbulimi i gypave DN 250mm që furnizojnë me ujë të pijes 34 fshatrat e Rekës së keqe afër kaptazhës	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 14,493.50 €	"V – SHEHU" SH.P.K., Junik, Junik	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 09.11.2021
Asfaltimi i rrugës nga rruga kryesore deri te rezervuari në Batushë dhe objekti administrativ, L=900m.	Bashkëfinancim me Komunën e Gjakovës (51% *49%) Vlera financiare: 47,981.00 €	"Euroasphalt" SH.P.K., Skënderbeu, Gjakovë	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 28.09.2021
Rrethoja e objekteve (trafos dhe stacionit të pompave) në Sopot	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 16,093.54 €	N.SH.T. VIKTORY COM, Rr. Tirana, Gjakovë	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Rrethoja e parcellës te Diga (në mes të rrugës dhe gjelbërimit) te Liqeni - Ritenderim	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 9,288.00	" Eko Term " SH.P.K., Brigada 123 pn, Suharekë	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit: 350,000.00 €, dhe KRU "Gjakova": 106,397.61 € Vlera totale: 456,397.61€	Lulzim Beqiraj B.I.: FIDANI-BETON SH.P.K., Rr. Arben Qerimaj, Nr 180, Deçan	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Vazhdim nga 2018-2021: WC1:Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, tenderi nr. KFW/BMZ201365501/ Gjakovë PH – III / WC-1" WC2:Impianti dhe dizajni-ndërtimi i ITUN Gjakova bazuar ne Librin e Verdhe të FIDIC-ut (Federata ndërkombëtare e inxhinierëve te Ndërtimtarisë) Nr. Tenderit: KFW (Banka Gjermane për Zhvillim) /BMZ 2013 65-501/Gjakova/PH-II/WC2	Kontrata WC 1 (Work contract - kontratë pune), Kontrata bazë: 3,695,933.26€ Kontrata WC 2 (Work contract - kontratë pune), Kontrata bazë: 7,270,630.51€ Total 1&2 =10,966,563.77 €	WC 1. Kontraktori: Kosova Water & Energy sh.p.k WC 2. Kontraktori: PASSAVANT WC 02	Punët gjinden ne vazhdim e sipër dhe priten të përfundojnë në tremujorin e parë 2022
Gjithsejtë: 11,729,633.12 €, të vete financuara nga KRU Gjakova: 550,248.14 €			

Projektet për: Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, dhe Impianti dhe dizajni-ndërtimi i ITUN Gjakova, përfshin dy kontrata të punëve si në vijim:

Kontrata e punëve WC-01 (Work contract – Kontratë pune):

Gjatë muajit Janar, nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet, ndërsa në muajin Shkurt dhe Mars: është bërë përgatitja e dokumentacionit për pranim teknik dhe Inspektim i përbashkët mes inxhinierëve të KRU Gjakova, Konsulentit dhe Punë kryesit për pranim teknik të punëve të realizuara.

Gjatë muajt Prill 2021, ka vazhduar Inspektim i përbashkët mes inxhinierëve të KRU Gjakova, Konsulentit dhe Punë kryesit për pranim teknik të punëve të realizuara. Gjatë muajt Maj 2021, Përgatitja e punëve riparuese për pranim teknik, përgatitja e punimeve riparuese të asfaltit përgjatë kolektorit 2 në rrugën Nena Tereza, përgatitja finale e dokumenteve për Pranim Teknik. Gjatë muajt Qershor 2021, kanë përfunduar punimet dhe është bërë Lëshimi i Certifikatës për Pranim Teknik. Gjatë muajt Gusht 2021, është pranuar teknikisht kontrata e parë për kolektorët.

Kontrata e punës WC 02: (Work contract – Kontratë pune)

Gjatë muajit Janar - Dhjetor 2021, kanë vazhduar punimet në WC 02- Impianti dhe Dizajni- Punimet e projektimit dhe ndërtimit. Janë bërë gërmime, mbushje, betonime në objektin e planifikuar për elektrik.

Punët ndërtimore:

- Objekti i rrjetave të imëta - Largimi i pahive dhe rregullimi i gabimeve në beton;
- Objekti i rrjetave të trasha - Largimi i pahive dhe rregullimi i gabimeve në beton;
- Objekti për tharjen e lymit - Suvatimi i brendshëm dhe ngjyrosja e mureve të brendshme;
- Objekti i elektrikes - Suvatimi i brendshëm dhe ngjyrosja e mureve të brendshme;
- Ndërtesa e sitave të imëta - Muratimi - Muret me tulla në çati, suvatimi, lysterja;
- Ndërtesa e sitave të trasha - Ndërtimi i kulmit 100%;
- Sedimentuesit final - Përforsimi i pllakës së sipërme dhe murit të rrumbullakët, punime betoni brenda ndërtesës 100%;
- Shtrimi i rrugës - Mbushja e nënshtresës me gurë Fr / 250;
- Punimet e tubave - Instalimi i tubave HDPE 100%;
- Strukturat e Daljes - Përforsimi dhe punimet prej betoni 100%;
- Shtëpia e rojës - Betonimi i pllakave 100%, punime muratimi - mure me tulla 100%;
- Shtretërit e tharjes së llumit - Gërmimi dhe mbushja 100%;
- Asfaltimi i rrugëve të ITUN 100%.

Punët mekanike:

- Objekti i rrjetave të trasha - Instalimet mekanike 100%;
- Objekti i rrjetave të imëta - Instalimet mekanike 100%;
- Objekti për largimin e yndyrës - Instalimet mekanike 100%;
- Objekti për tharjen e lymit - Instalimet mekanike 100%;
- Objekti për dezinfektim Ultra Violet - Instalimi 100%
- Sedimentuesit final - Instalimet 100%

Punët elektrike:

- Objekti për tharjen e lymit - Instalimi i rrugëve për kablllo 100%;
- Objekti i elektrikes - Instalimi i rrugëve për kablllo;
- Objekti për matjen e rrjedhës - Instalimi i rrugëve për kablllo;
- Ndërtesa e sitave të imëta - Panelet e MCC - Instalimi i kablllove;
- Panelet PLC - Instalimi i kablllove;
- Ndërtesa për matjen e rrjedhës Venturi - Punimet e kablllove;
- Ndërtesa Elektrike - Instalimi i kabllit të Panelit MCC; Instalimi i kablllove 100%;

- Instalimi i kablllove të panelit PLC Rezervuari i ajrimit;
- Instalimi i rrugëve për kablo 100%;
- Ndërtesa e tharjes së lymit;
- Instalimi i kablllove të panelit PLC;
- Venturi, Objekti për matjen e rrjedhjes - Rrugët e kablllove 100%;
- Objekti i elektrikes - Instalimi i Paneleve MCC dhe PLC si dhe kablllove 100%;
- Rezervuari i Ajrimit - Instalimi i rrugëve të kablllove ;
- Pompa kthyesë për lym - Instalimi i rrugëve të kablllove 100%;
- Rezervuari i lymit - Instalimi i rrugëve të kablllove 100%;





Foto nga finalizimi i punimeve në ITUN -KRU Gjakova

2.Projekti: Ndërtimin e ujësjellësit për fshatrat e Hasit të Prizrenit –faza 1, për furnizim me ujë nga KRU “Gjakova”, me numër identifikues: KRURGJA-21-904-5-2-1 & KRURGJA-21 005 521

Ka përfunduar projekti i realizuar nga Grupi i Operatori Ekonomik: Fidani-Beton Sh.p.k & Company Murseli Sh.p.k.

Instalimi i ujësjellësit në fshatrat e Hasit të Prizrenit e cila fillon nga Pirana ne drejtim të fshatit Gjonaj me një gjatësi totale $L=5.910$ m. Është ndërtuar ujësjellësi me gypa RC PE DN 315 16 bar, $L=3.960$ m, dhe rrjeta shpërndarëse me gypa PE DN 90 10bar $L=950$ m dhe DN 63 10bar $L=1000$ m. Gjatë ekzekutimit të projektit janë bërë; Punët përgatitore, punët tokësore, punët instaluese, punët e betonit dhe betonarmesë, pune tjera te ndryshme te planifikuara ne paramasë dhe testimi dhe dezinfektimi i gypsjaellësit.

Projekti është pranuar teknikisht dhe ekzekutimi sipas raportit të komisionit ka qenë në rregull dhe në afatin e duhur kohor.

Vlera e projektit: 266,796.70 €. Investimi është realizuar në bashkëfinancim me Komunën e Prizrenit (Komuna 49% - KRU 51%).

3.Projekti: Asfaltimi i rrugës nga rruga kryesore deri te rezervuari në Batushë dhe objekti administrativ, L=900m, me numër identifikues: KRURGJA-21-4181-5-2-1 & KRURGJA-21 021 521

Është në finalizim projekti i realizuar nga Operatori Ekonomik: Euroasphalt SH.P.K

Do ndërtohet rruga me gjerësi $B = 0.5+4.0+0.5\text{m}$ që shkon deri te objekti administrativ dhe rezervuarët, që e lidhe me asfaltin kryesor të rrugës . Rruga do të jetë e gjerë 4.0 m me asfalt dhe $2 \times 0.5\text{m}$ bankina si dhe për skaj të rrugës kanalet për largimin e ujërave sipërfaqësor si dhe ndërtimi i tombinave për largimin e ujit me anë të gypave të betonit, punë tjera të ndryshme të planifikuara në paramasë.

Ka përfunduar projekti i realizuar nga Operatori Ekonomik: Euroasphalt SH.P.K, dhe është pranuar teknikisht me datë: 28.09.2021.

Vlera e projektit: 47, 192.07€. Investimi është realizuar në bashkëfinancim me Komunën e Gjakovës (Komuna 49% - KRU 51%).

4.Projekti: Rrethoja e objekteve (trafos dhe stacionit të pompave) në Sopot, me numër identifikues: KRURGJA-21-2927-5-2-1 & KRURGJA-21 017 521

Është në finalizim projekti i realizuar nga Operatori Ekonomik: N.SH.T. Viktory Com.

Për momentin objekti i stacionit të pompave dhe i trafos në Sopot nuk ka ndonjë sigurim fizik, dhe arsyeja e ndërtimit të rrethojave rreth objektit në fjalë bëhet për të bërë sigurimin e tij fizik nga problemet e ndryshme që mund të hasin. Gjithashtu me këtë projekt do të bëhet rregullimi i drenazhimit të parcelës në fjalë.

Projekti ka përfunduar në muajin Gusht 2021.

Vlera e projektit: 16,093.54€. Investimi është realizuar nga mjetet e KRU Gjakova.

5.Projekti: Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE në fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol me numër identifikues: KRURGJA-21-2065-5-2-1 & KRURGJA 21 014 521. Numri i kontratës: KRURGJA-21-2065-5-2-1/C72

Punimet për realizimin e kontratës kanë filluar me datë 13 shtator 2021, ndërsa në njoftimin për aprovimin e fillimit të punimeve është caktuar data 14.06.2021. Nga data e planifikuar e fillimit të punimeve deri me 13 shtator 2021, janë kryer vetëm punimet e incizimit të terrenit, pastrimit të terrenit dhe eliminimit e disa pengesave natyrore për fillimin e punimeve të gropimit. Gjatësia e trasesë është 12.18 km. Prandaj pasi që është e tërë traseja në afërsi të trupit të Hekurudhës duhet të pastrohet dhe të sigurohet traseja për gropim. Furnizimi me gypa ka pasur pengesa për arsye të kufizimeve në kuadër të mbrojtjes nga Pandemia Covid-19.

Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: Do dislokohen gypat dhe do të vendosen gypat e rinjë me këto dimensione: PE100 RC DN 250 10bar – 5200 m, PE 100 RC DN250 16 bar – 5945, PE100 RC DN 225 16bar – 520.50, PE100 RC DN 160 16bar-360m, PE100 RC DN 110 16bar – 168 m. Gjatë ekzekutimit të projektit do të bëhen: Punët përgatitore, punët tokësore, punët e betonit dhe betonarmesë, punët instaluese, dhe punët tjera të ndryshme të planifikuara në paramasë dhe testimi dhe dezinfektimi i gyp sjellësit.

Gjatë muajit Tetor-Dhjetor 2021, është bërë pastrimi i trasesë nga pengesat eventuale, shkurre, drunjë, etj. Në një gjatësi më të madhe se 130 metra, gjithashtu janë bërë më shumë se 5.500 metra matje gjeodezike si dhe sigurimi fizik i rrjetës të gypsjiellësit.

Është bërë hapja rreth 8.000 metra të kanalit me gjerësi $b=(0.8-2.0)$ ndërsa me thellësi sipas profilit gjatësor mesatarisht 1.40m. Gjithashtu është bërë dhe mbyllja e kanalit me material nga rrëmihi e dheut në një sasi më të madhe se 4.700 m³ dhe është bërë ngjeshja e nevojshme. Në

një sasi më të madhe se 50 m³ është bërë hedhja e rrës së imtë në kanal, në formë të ngjeshur (95% PR), ashtu që planifikimi i niveletës të bëhet në saktësi + ose – 1 cm.

Janë montuar më shumë se 5500 metra gypa PE100 RC DN 250/10 bar dhe më shumë se 300 metra gypa PE RC DN 250/16 bar.

Deri në fillim të muajit Dhjetor, janë kryer punimet në vlerë prej **349,999.24 euro**, ose në përqindje, 76.69% e projektit, ndërsa punimet janë duke vazhduar me një dinamikë të shtuar në mënyrë që projekti të finalizohet në kohë sa më të shpejtë.

Kontraktuesi për realizimin e kësaj kontrate është Grupi i Operatorëve Ekonomik Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K., Rr. Arben Qerimaj, Nr 180, Deçan

Vlera totale e kontratës është: 456,397.61 euro.

6. Projekti: Mbulimi i gypave DN 250mm që furnizojnë me ujë të pijes 34 fshatrat e Rekës së keqe afër kaptazhës me numër identifikues: KRURGJA-21-7879-5-2-5 dhe KRURGJA 21 034 525

Punimet kane filluar me 27.10.2021, dhe kane përfunduar me datën: 02.11.2021. Pasiqe furnizimi me ujë të pijes për fshatrat e Rekës së Keqe bëhet nga kaptazha (vepra marrëse) ku behet grumbullimi i ujit, dhe përmes rrjetit përcjellët deri ne rezervuar afër bjeshkëve te Nemura edhe përcjellët përmes 2 gypave HDPE100 RC DN 250mm, ka pasur rrëshqitje te dheut ne kilometrin e 8-te (tete) dhe gypat kane mbetur të shpluar dhe pa mbështetje. Prandaj është paraqitur nevoja për intervenim emergjent për stabilizimin e terrenit në atë segment të rrugës dhe të bëhet mbulimi i gypave të shpluar nga rrëshqitja e dheut, duke formuar skarpën dhe planifikimin e tij, si dhe është bërë hapja e kanalit kullues për largimin e ujërave atmosferik dhe sipërfaqësor 0.5x0.5x0.5, që mos të vjen deri te ndonjë avari-shpërthim i tyre, i cili do të kishte pasoja dhe dëme të mëdha. Kontraktuesi për realizimin e kësaj kontrate: " V - SHEHU " SH.P.K. Junik. Vlera e përgjithshme e kontratës: 14,493,50 €.

Investimet kapitale për përmirësimet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore te realizuara gjatë vitit 2021 me investime vetanake dhe Grand Qeveritar

Nr.r.	Përmirësimet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore	Te realiz.2021
1.	Objektet ndërtimore	42,663
2.	Rrjeta e ujësjellësit	192,673
3.	Ujëmatësit	17,784
4.	Pajisje elektrike-mekanike	11,568
5.	Pajisjet kompjuterike	37,578
6.	Paisjet për mirëmbajtje	5,733
7.	Pajisjet për zyre	3,745
8.	Investimet në vijim-ITUN-i	465,313
9.	Inv.vijim-Ujesjellesi i fshatrave te Hasit	226,098
10.	Inv.vijim-Ujesjellesi i fshatrave Xerxe, Gexh, Radost, Ratkovc	296,610
11.	Inv.vijim-rrjeti i Ujesjellesit Reka e Keqe	12,282
	GJITHSEJT:	1,312,047

Këtë vit në kontabilitet investimet vlerën më të madhe e ka rrjeta e ujësjellësit, ku hyjnë investimet nëBrekoc-Lagjja Jetishve, fshati Morinë, Cermjan pastaj rrjeti i ujësjellësit në Has dhe në fshatrat e Anadrint si Xërxe, Radost, Ratkovc, Gegje, ndërtimi i Impaintit të Ujërave të Ndotura 1,465,313 €, dhe paisjet kompjuterike.

2.2.3 Dividentet e paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2021 nga KRU "Gjakova", nuk është kërkuar të paguajnë dividend nga Qeveria e Republikës së Kosovës .

2.3 TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO EKZEKUTIV

2.3.1 Emrat e drejtorëve të bordit të drejtorëve gjatë vitit 2021 ,duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes sipas kohës së emrimit : Janar 2021-Qershor 2021

Burim Shala:

Kryesues i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021 neto – 2,308.50 euro.

Mirsad Duraku:

Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe Kryetari i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021 (Janar Qershor 2021) ,neto – 2,205.90 Euro.

Vilson Dura:

Anëtar i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021 (Janar – Qershor 2021) neto -2,052.00 euro.

Gardalin Shtavica:

Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe anëtarë i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021 neto – 2,052.00 euro.

Emrat e drejtorëve të bordit të drejtorëve gjatë vitit 2021,duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes sipas kohës së emrimit : Korrik 2021-Dhjetor 2021

Urim Gashi:

Kryesues i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021 neto – 2,151.10 euro.

Mevlyde Kelemendi Begolli:

Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe Kryetari i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021(Janar Qershor 2021) ,neto – 2,093.98 Euro.

Islam Hasani:

Anëtar i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021 (Janar – Qershor 2021) neto -1,940.08 Euro.

Atdhetare Kelmendi:

Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe anëtarë i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021 neto – 1,940.08 Euro.

2.3.2 Numrin e takimeve të bordit gjatë vitit dhe numrin e pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e bordit

Gjatë vitit 2021 Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Gjakova", Sh.A-Gjakovë ka mbajtur; Mbledhje të rregullta gjithsejtë 12 mbledhje dhe Mbledhja e përgjithshme të Aksionarit 1 mbledhje. Mbledhjet e Bordit janë vijuar në mënyrë të rregullt nga të gjithë Drejtorët jo-ekzekutiv dhe Drejtori Ekzekutiv. Në përgjithësi vijimi i mbledhjeve vlerësohet me pjesëmarrje të rregullt të Bordit të Drejtorëve

2.3.2 Komisioni i Auditimit ,Komitet , përbërja e tyre dhe numrin e takimeve të mbajtura

Komisioni i Auditimit që nga formimi i tij ka qenë mjaft aktiv, konstruktiv dhe frytdhënës, duke shqyrtuar, diskutuar dhe duke marrë vendime shumë të rëndësishme, në aspektin e mbarëvajtjes dhe ngritjes së performancës së përgjithshme të kompanisë.

Komisioni i Auditimit gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsejtë 12 takime të rregullta, ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve. Në vazhdim, paraqesim në mënyrë kronologjike, takimet, aktivitetet, diskutimet, konkluzionet dhe vendimet e Komisionit të Auditimit të cilët kanë diskutuar dhe analizuar; - Raportin financiar, për tremujorin e parë e deri në tremujorin e katërt të vitit 2021; Raporti vjetor i punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2021; - Aprovimi i planit strategjikë 2020-2022 dhe planit vjetor të Auditorit të brendshëm për vitin 2021. Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A:

- Komisioni i Auditimit aprovon raportet financiare të prezantuar nga Zyrtari Kryesor Financiarë të Kompanisë, mujore Tremujore dhe Vjetore, me sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna që i propozohet Bordit, Planin strategjikë të auditorit të brendshëm për vitin 2021, në bazë të propozimit të auditorit të brendshëm sipas nevojës të bëhet ndonjë auditim shtesë, aktiviteteteve të Auditorit të Brendshëm si dhe auditimet lidhur me raportet e tij të realizuara në bazë të Planit të punës së tyre .

3.1 NGJARJET KRYESORE TË VITIT

3.1.1 Arritjet kryesore

Si arritje kryesore vlen të theksohen :

- KRU "Gjakova " Sh.A.- është vlerësuar në Raportin e vlerësimit të treguesve të performancës nga ARRU-ja , si kompania mjaft e suksesshme në arritjen e treguesve operativ dhe financiar të performances .
- Raporti i Vlerësimit të cilësisë së ujit të pijes nga IKSHPK -ja. Cilësia e ujit është vlerësuar e kualitetit të lartë dhe që i plotëson të gjitha kriteret e caktuara me akte nga IKSHPK .
- Vazhdimi i rritjes së numrit të portoarkave në disa lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve si dhe realizimi i Marrëveshjeve për Riprogramim të borxhit ,Kontratave të shërbimit si dhe suksesi i inkasimit të mjeteve përmes Përmbaruesve privat .
- Rritja e numrit të konsumatorëve në vitin 2021 krahasuar me numrin e konsumatorëve në vitin 2020 ka rezultuar me rritje prej 1,965.
- Realizimi në përputhje me kërkesat e konsumatorëve për ujë, eliminimi në tërësi i reduktimeve të ujit, plotësimi i kërkesave për furnizim me ujë, pandërprere për të gjitha zonat furnizuese, më orar të plotë 24 orë.
- Vazhdimi i zbulimit të keqpërdorimeve të mëdha nga konsumatorët e pandërgjegjshëm si dhe përcjellja e lendeve si Kallëzim Penal tek Prokurori i Shtetit për zhvillimin me tutje të procedurës për ngritjen e Aktakuzës. Ky aktivitet është duke ndikuar dhe në masë të madhe në zvogëlimin e numrit të keqpërdoruesve si dhe zvogëlimin e humbjeve të ujit si dhe avancim në këtë drejtim të këtij treguesi të performances ;
- Hartimi dhe aprovimi i Planit të Biznesit 2022-2024
- Menaxhimi i mire dhe me kohë i defekteve në zonën e shërbimit dhe zvogëlimi i humbjeve sipas Strategjisë për Menaxhimin e humbjeve të ujit;
- Furnizimi i gjithë zonës së shërbimit me ujë cilësor 24/7;

- KRU "Gjakova " Sh.A.- është vlerësuar në Raportin e vlerësimit të treguesve të performancës nga ARRU-ja , si kompania mjaft e suksesshme në arritjen e treguesve operativ dhe financiar të performancës .
- Vazhdimi i Projektit- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit Brekoci III (Lagjja e Jetishëve) -punë shtesë, vlera financiare: 2,578.56€;
- Realizimi i Projektit- Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Hasit të Prizrenit –faza 1, vlera financiare: 266,796.70€;
- Realizimi i Projektit- Servisimi i pompave dhe rimbeshellja e motorrëve te KRU Gjakova sh.a., vlera financiare: 3,510.00€;
- Realizimi i Projektit- Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Xërxe,Gexhë, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol, vlera financiare: 456,397.61€;
- Realizimi i Projektit- Asfaltimi i pjesëve ku është dëmtuar asfalti me rastin e defekteve nëpër tërë njësit e kompanisë për KRU Gjakova, vlera financiare: 69,564.00€;
- Realizimi i Projektit: Rrethoja e objekteve (trafos dhe stacionit të pompave) në Sopot, vlera financiare: 16,093.54€;
- Realizimi i Projektit: Furnizim me material elektrik për nevojat e mirëmbajtjes elektrike (ndiqimi për objekte, ormanet elektrik, rele niveli, kablo, ndërprerës automatik)-vlera financiare: 30,649.02€;
- Realizimi i Projektit: Asfaltimi i rrugës nga rruga kryesore deri te rezervuari në Batush dhe objekti administrativ, L=900m, vlera financiare: 47,981.00€;
- Realizimi i Projektit: Rrethoja e parcellës te Diga (në mes të rrugës dhe gjelbërimit) te Liqeni-Ritender, vlera financiare: 9,288.00€;
- Projekti emergjent: Mbulimi i gypave DN 250mm që furnizojn me ujë të pijes 34 fshatrat e Rekes së keqe afër kaptazhës, vlera financiare: 14,493.50€;

3.1.2 Çështjet kyçe që janë paraqitur gjatë vitit

Si çështje kyçe që kanë ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Kompanisë gjatë vitit 2021 vlen të përmendet ;

- Është mbajtur mbledhja e përgjithshme vjetore me aksionarin ku pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit e MZHE –se ,të NJPMNP;
- Meqenëse Fituesi i tenderit Grup i Operatoreve Ekonomik Lorenzo &Co Sh.P.K.;A.L.T.E.A & GEOSTUDIO2000, Janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet në projektin: "Studimi ,Riparimi dhe pajisjet monitoruese të digave ekzistuese të Kosovës". Fituesi i Tenderit për : "Studimi ,Riparimi dhe pajisjet monitoruese të digave ekzistuese të Kosovës "ka shqyrtuar sigurinë e digave me qellim që të vlerësohet se a janë digat në gjendje që të përballojnë të gjitha forcat që mund të priten të veprojnë mbi to gjatë periudhës së shfrytëzimit të tyre ,si dhe që të operohet dhe mirëmbahen në mënyrë të sigurtë.
- Vazhdimi i implementimit të Marrëveshjes për zbatimin e projektit për eliminimin e ujërave të zeza në Komunën e Gjakovës. Aktivitetet në plotësimin e procedurave administrative tek autoritet komunale dhe qeveritare për fillimin e punimeve kanë përfunduar është marrë leja e ndërtimit nga MMPH .
- Vazhdimi i Instalimi i ujëmatësive familjare në qytet dhe fshatra
- Është punuar rreth hartimit të akteve të brendshme të Kompanisë; Struktura e re Organizative e KRU"Gjakova"Sh.A. Rregullorja mbi Organizimin dhe Sistematizimin e Punëve dhe detyrave të punës në KRU"Gjakova"; Rregullorja mbi Shpërblimin e Punëtorëve , Rregullorja mbi Procedurat e Punësimit ; Rregullorja mbi Paradhëniet ; Rregullorja mbi Inicimin e Procedurës Përmbarimore ; Struktura Organizative model unik për të gjitha Ndërmarrjet sipas NJPMNP .

- Vazhdimi i hapjes së pikave të reja të arkëtimit ,në lagjet e qytetit si dhe në zonat rurale në tërë regjionin të cilin e mbulon Kompania .
- Vazhdimi i aktivitetit rreth përmirësimit të menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë ,mbajtja nën kontroll e nivelit të prodhimit i cili nga ana tjetër është i lidhur me koston e prodhimit ,në veçanti shpenzimet e energjisë elektrike të cilat shpenzime janë të lidhura direkt me nivelin e prodhimit, ulja e nivelit të prodhimit ndikon edhe në uljen e koston së këtyre shpenzimeve.
- Hartimi i planeve dhe projekteve për zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit te pijes, Hartimi i Projekteve për aplikimin tek aksionari–Qeveria e Kosovës,
- Takimi me stafin menaxhues të Kompanisë kontrollimi i objekteve ,pastrimi ,renovimi si dhe testimi i tyre, kontraktimi me shfrytëzuesit e shërbimeve tona ,aktivitet në inkasim disiplina dhe përgjegjësit në punë.
- Takimet e rregullta me stafin e kompanisë ne lidhje me gjendjen e infrastrukturës së ujit ,vështirësitë problemet e paraqitura
- Formimi i grupit punues për ndihmë të inkasantëve në teren me qëllim të rritjes së shkalles së inkasimit .
- Përpilimi i shkresave dhe kërkesave për institucione lokale dhe qendrore .
- Dërgimi i shkresave ne MZHE për subvencione ne investime kapitale .
- Takimet me zyrtaret e Komunave me të cilën operon Kompania ;Gjakovë , Rahovec dhe Prizren.
- Përgatitja e materialeve dhe e mbledhjeve të rregullta të BD .Mbajtja e mbledhjes vjetore me aksionarin se bashku me BD, menaxhimi i punëve të përditshmes bashku me menaxhmentin e kompanisë .
- Mbajtja e takimeve të rregullta me përfaqësues të fshatrave me qëllim të sensibilizimi të tyre me qëllim që ti kryejnë obligimet financiare ndaj kompanisë;
- Pjesëmarrje e vazhdueshme dhe e rregullt me SHUKOS dhe ARRU për ; të gjeturat e raportit të inspektimit (eliminimi i faturimit pa matje) ;
- Është bërë aplikimi për grante nga KRU"Gjakova"Sh.A.perme WBIFlidhje me aplikacionet e dërguara dhe vendimin e Komitetit Drejtues te WBIF, jemi njoftuar se aplikacionet për grand te aprovuara janë:
 1. WB24-KOS-ENV-03: Kosovo, Water Supply Improvement and Water Resources Protection for Gjakova Regional Water Company: Feasibility Study, ESIA, Detailed Design, Tender Dossier;
 2. WB-IG05-KOS-ENV-01: Kosovo, Wastewater Treatment Plant and Sewerage Network for Mitrovica;
- Është arritur të nenshkruhen dy Marrëveshjet e Monitorimit me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit për realizimin e projeteve "Ndërtimi i Impiantit të Ujërave të Zeza" dhe "Dislokimi dhe ndërrimi i Gypit nga AC në PE për fsh. Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol".
- Me 31 Mars 2021 nga Departamenti i Punëve Fiskale u organizua punëtori për rreziqet fiskale TW Ndërmarrjet Publike ,ku u shtruan qështjet Me 31 Mars 2021 nga Departamenti i Punëve Fiskale u organizua punëtori për rreziqet fiskale TW Ndërmarrjet Publike ,ku u shtruan qështjet; Cilat janë rreziqet fiskale?Pse të shqetësoheni për rreziqet fiskale nga NP-të?Raportimi dhe zbulimi vjetor dhe vjetor nga NP-të;Raportimi dhe zbulimi nga qeveria për NP-të; Menaxhimi dhe zbutja e rreziqeve fiskaleModel dhe zërat për raportimin e NP-ve; Model për raportimin tremujor; Model për raportimin vjetor; Kërkesat e miratimit; Afatet kohore të raportimit
- Me dt. 27.04.2021 Kompania është vizituar (KRU Gjakova) nga zyrtar për Menaxhimin e Projekteve të Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore(ARPL)/ MMPH në lidhje me projektin "Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në Gjakovë", për punët të cilat janë kryer në bazë te marreveshjes, dt.16.03.2021 ne mes MEA-MMPHI dhe KRU Gjakova.

- Nga ARRU me datë: 23 Prill 2021 është bërë auditimi (verifikimi) vjetor i të dhënave për vitin 2020, të raportuara nga kompania e juaj përmes raportit vjetor ku përfshijnë aspektet financiare, teknike dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve dhe Ekipit të Auditimit i është vënë në dispozicion personat përgjegjës për raportim, modulet softuerike, ditarët e shënimeve, evidencat dhe raportet e ndryshme në të cilat kompania e juaj i mbanë shënimet dhe informacionet e nevojshme.
- Me datën 20.05.2021, kemi marr pjesë në Kuvendin e XX-të të organizuar nga SHUKOS ku u shqyrtuan; Raporti vjetor; Raportimi financiar për vitin 2020 / Raporti i auditorit të jashtëm ; Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Bordit-udhëheqjes së SHUKOS-it dhe zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarit të bordit; Shqyrtimi dhe aprovimi për modifikim-plotësim dhe ndryshimet të Statuti të SHUKOS-it ; Prezantimi i Planit të punës & buxheti për vitin 2021 dhe caktimi i mënyrave të pagesës
- Me Komunen e Gjakoves për vitin 2021 është arritur të nënshkruhen katër marrëveshje bashkëfinancimi për realizimin e Projekteve; Asfaltimi i rrugës Batush; Ndertimi i ujësjellësit Firz; ndertimi i ujësjellësit Zhubë; Ndertimi i pompave shtytese
- Me 01.06.2021 është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëfinancimit të lidhur me Komunën e Rahovecit për projektin “ Hapja e pusit për ujë të pijes në fshatin Senoc”.
- Me 23 .07.2021 nga ARRU na është përcjellë “Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë-2020 “ , KRU “Gjakova” doli si performuesi më i mirë për vitin 2020, në performancën e përgjithshme për sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe shërbimit të ujërave të ndotura
- Me 10.08.2021 me Komunen e Gjakovës është nënshkruar Marrëveshja e bashkëfinancimit në mes palëve për realizimin e Projektit ‘ Ndërrimi i gypit furnizues deri te St. i Pompave ,gypi shtytës dhe furnizues në drejtim të Stacionit të pompave “Dol “ –rezervar “Lipovec” V =200m³ ,sid he ekzekutimi i gypësjellësit për furnizim me ujë të pijes në Gërquinë “ , në Komunen e Gjakovës.
- Me datën 30/08/2021 në ora 14:00 në Ministrinë e Ekonomisë kemi marr pjesë në takimin që u mbajt me Ministren Artane Rizvanolli, Ministrin Liburn Aliu, Ministrin Armend Mehaj, Zëvendësministrin Mentor Arifaj dhe Besim Imeri (Udhëheqës i NJPMNP). Në takim do të diskutohet rreth sigurisë së furnizimit me ujë nga KRU-të, mbulushmërisë së furnizimit me ujë dhe rreth nevojave të reja për furnizim me ujë nga KRU-të.
- Me 09.11.2021 në Kompani për vizitë kanë qenë zyrtarët nga KfW Banka Gjermane Geroge Gruner, Uwe Arras dhe Premtim Islami. Qëllimi i takimit ishte inspektimi i progresit të Arritur për projektin Eliminimi i Ujërave të Ndotura në JugPerendim të Kosovës fazat III, V dhe VI.
- Me 10.12.2021 kamë qenë në Ministrin e Ekonomisë për nënshkrimin e dy Marrëveshjeve të Mirëkuptimit. E para Marrëveshja me numër protokolli 3123 për projektin Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Gexhe, Radost, Ratkovc, Dejnë dhe Dobidol. Vlera e projektit 350,000 euro. Kjo marrëveshje ka kaluar nga Investimet Kapitale në Subvencion dhe Transfere dhe Marrëveshja me numër protokolli 3121 për projektin Trajtimi i ujërave të ndotura në Jug-Perendim të Kosovës, faza III-Gjakova, vlera e projektit 265,312.45 euro.
- Me 22.12.2021 poashtu kamë qenë në Ministrin e Ekonomisë për nënshkrimin e Marrëveshjes së tret në muajin Dhjetorë, marrëveshje me numër protokolli 3243 për projektin Impianti i Ujërave të Zeza me vlerë 604,793 euro.

3.2 PASQYRË E PËRFORMANCES OPERATIVE TEKNIKE DHE INDIKATORET KYÇ TË PERFORMANCES

3.2.1 Niveli i shërbimeve të ndërmarrjes (të saktësohet në vlera volumi i aktivitetit) gjegjësisht indikatorët fizik

Ardhja e ujit në Liqe

Gjatë vitit 2021, mbushja e Liqenit të Radoniqit me ujë nga Lumi i Lumëbardhit të Deçanit, ka ngecur pakëz për shkak të problemeve që i kemi pasur me hedhjen e ujërave të zeza në kanalin derivues në Komunën e Deçanit dhe mos reagimit me kohë nga Komuna, mbushja e kanalit ka filluar më vonë, bazuar nga viti i kaluar ku mbushja e liqenit ka filluar nga data: 01.10.2020.

Në fillim të vitit: 01.01.2021, niveli i liqenit ka qenë në kuotën 455.35 m (n.m.d), ndërsa në fund të vitit me; 31 Dhjetor 2020, niveli i liqenit ka qenë 449.83 m (n.m.d), ndërsa nga kuota maksimale (456 n.m.d) kemi një rënje të nivelit prej: 6.17 m.

Vëllimi i Liqenit në Fillim të muajit Janar 2021, ka qenë 95,861.094 m³, ndërsa në fund të vitit me 31.12.2021 ka qenë: 85,666,406 m³, ku bazuar në shpenzimet vjetore kemi një rënje brenda vitit prej: 10,194.688 m³, ujë.

Të reshurat e matura gjatë muajve Janar-Mars 2021, kanë qenë: 475.3 mm/m², në krahasim me të reshurat gjatë tremujorit Janar-Mars 2020, ku kanë qenë: 176.5 mm/m², kemi një ngritje të të reshurave prej: 298.8 mm/m², krahasuar me vitin e kaluar.

Të reshurat e matura gjatë muajve Prill-Qershor 2021, kanë qenë: 173.9 mm/m², në krahasim me të reshurat gjatë tremujorit Prill-Qershor 2020, ku kanë qenë: 185 mm/m², kemi një ramje të të reshurave prej: 11.1 mm/m², krahasuar me vitin e kaluar.

Të reshurat e matura gjatë muajve Korrik - Shtator 2021, kanë qenë: 87.9 mm/m², në krahasim me të reshurat gjatë tremujorit Korrik - Shtator 2020, ku kanë qenë: 224.3 mm/m² kemi më pak të reshura prej: 136.4 mm/m², krahasuar me vitin e kaluar.

Të reshurat e matura gjatë muajve Tetor - Dhjetor 2021, kanë qenë: 335.9 mm/m², në krahasim me të reshurat gjatë tremujorit Tetor - Dhjetor 2020, ku kanë qenë: 337.6 mm/m² kemi më pak të reshura prej: 1.7 mm/m², krahasuar me vitin e kaluar.

Nga data: 21.04.2020, KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.a, ka filluar të marr ujë të pa përpunuar nga liqeni: dhe në periudhën Prill - Shtator 2021, ka marr ujë: 40.438.614 m³, ndërsa gjatë vitit 2020 ka marrë ujë: 32.756.194 m³, pra kemi një rritje të marrjes së ujit me një ndryshim prej: **7,682.420 m³ me shumë se vitin e kaluar.**

Prodhimi i ujit

Gjatë vitit 2021, prodhimi i ujit është realizuar në përputhje me kërkesat e konsumatorëve për ujë. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur reduktime të rregullta të ujit. Prodhimi i ujit ishte normal dhe i ka plotësuar kërkesat për furnizim me ujë, pandërprerë për të gjitha zonat furnizuese, më orar të plotë 24/7 orë.

Në vitin 2021 është prodhuar 15,910,071 m³, sasi kjo më e lartë për 707,236 m³, në krahasim me vitin 2020, ku prodhimi ka qenë 15,202,835 m³, ku nga kjo sasi e prodhuar janë faturuar gjithsejtë: 9,167,666 m³, ndërsa uji i pa faturuar UPF ka qenë: 6,742,405 m³, apo shprehur në % 42.38, apo rritje nga planifikimi në Biznes Plan për 1%.


Në këtë prodhim të raportuar janë të dhënat edhe për burimet e ujit në: Hoqë të Madhe, Opterushë, Senoc, Drenoc, Damjan, dhe Greqinë dhe Reka e Keqe si zonë e re e furnizimit).

Kërkesën e furnizimit të konsumatorëve me ujë të pijshëm pa ndërprerje për të gjitha zonat 24 orë, në ditë e kemi arritur 100 %.

Duhet theksuar se gjatë muajit Janar - Dhjetor 2021, kemi pasur pastrimin e filtrave në mënyrë kontinuele sipas paraqitjes së nevojave për pastrim, ku kemi shpenzuar; **346.000 m³ uji.**

Tabela - Uji i prodhuar, uji i faturuar, uji i pa faturuar dhe humbjet gjatë vitit 2021, krahasuar me 2020 dhe BP 2021

Treguesit	Viti 2021	Viti 2020	Ndryshimi	%	Viti 2021	BP 2021	Ndryshimi	%
Prodhimi m ³	15,910,071	15,202,835	707,236	4.45%	15,910,071	16,038,873	-128,802	-0.81%
Faturimi m ³	9,167,666	8,856,057	-6,035,169	-65.83%	9,167,666	9,391,235	-223,569	-2.44%
Pa faturuar m ³	6,742,405	6,346,778	-8,460,430	-125.48%	6,742,405	6,647,638	94,767	1.41%
% humbjes	42.38%	41.75%	0.63%		42.38%	41.45%	0.93%	

Diagrami - Uji i prodhuar, uji i faturuar, uji i pa faturuar dhe humbjet gjatë vitit 2021, krahasuar me 2020 dhe BP 2021**Tabela - Uji i prodhuar gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin 2020 dhe BP 2021**

Prodhimi i ujit	Te realizuara 2021	Te realizuara 2020	Ndryshimi 2021 me 2020	Te realizuara 2021	BP 2021 te planifikuara	Ndryshimi 2020 me BP
Janar	1,204,301	1,206,293	(1,992)	1,204,301	1,234,803	30,502
Shkurt	1,224,202	1,223,043	1,159	1,224,202	1,244,004	19,802
Mars	1,240,225	1,233,125	7,100	1,240,225	1,254,431	14,206
Prill	1,222,973	1,225,025	(2,052)	1,222,973	1,222,973	-
Maj	1,238,779	1,251,276	(12,497)	1,238,779	1,238,325	(454)
Qershor	1,271,885	1,263,952	7,933	1,271,885	1,271,689	(196)
Korrik	1,455,819	1,318,952	136,867	1,455,819	1,459,422	3,603
Gusht	1,598,145	1,325,125	273,020	1,598,145	1,522,123	(76,022)
Shtator	1,419,106	1,342,153	76,953	1,419,106	1,419,506	400
Tetor	1,382,619	1,315,935	66,684	1,382,619	1,397,850	15,231
Nëntor	1,318,031	1,268,967	49,064	1,318,031	1,375,252	57,221
Dhjetor	1,333,986	1,228,989	104,997	1,333,986	1,398,495	64,509
Totali:	15,910,071	15,202,835	707,236	15,910,071	16,038,873	128,802

Nga kjo sasi e ujit të prodhuar **15,910,071 m³**, sasia e ujit të faturuar është **9,167,666 m³** kurse humbjet e ujit janë 42.38% apo 1.0% më e larte se një vit më parë, apo BP 2021.

Arsyet kryesore të humbjeve të ujit janë: Rrjeti i amortizuar i gypave, defektet në rrjetin e ujësjellësit, ujëmatësit e vjetruar mbi 10-30 vjeçar, leximi jo i sakte dhe i jo i rregullt i ujëmatësve te

disa konsumatorë, keqpërdorimet në rrjet nga ana e konsumatorëve, kyçje ilegale nga disa konsumator te pandërgjegjshëm, etj.

Kualiteti i ujit-2021

Uji i prodhuar në vazhdim është nën kontroll dhe i plotëson standardet e kërkuara nga Rregullorja për kualitet të ujit nga I.K.SH.P dhe bazuar në numrin e mostrave bakteriologjike dhe mostrave kimike gjatë muajit Janar 2019, uji ka qenë sipas normativës së kërkuar për të gjitha zonat furnizuese të KRU "Gjakova", duke respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu.

Gjatë kësaj periudhe një vjeçare , Janar-Dhjetor 2021, ishim në kontakt me IKSHPK në Prishtinë, por edhe me IKSHP dega në Gjakovë, ku e kemi konfirmimin e analizave të ujit për pije të KRU "Gjakova" që i plotëson kriteret për ujë të pijshëm dhe se analizat Bakteriologjike dhe fiziko-kimike janë NEGATIVE.

Në laboratorin e Stacionit të Filtrimit janë bërë po ashtu analizat interne për kontrollin e kualitetit të ujit. Analizat fiziko kimike bëhen çdo 2 dhe 24 orë pa ndërprerë, ndërsa ato bakteriologjike 1 herë në muaj, si dhe marrja e mostrave në rrjetin furnizues (analizat bakteriologjike dhe fiziko kimike në 12 pikat kryesore, nga pika më e afërt deri te pika e fundit).


Mostrat merren në rrjetin e Qytetit të Gjakovës, Rahovecit, furnizimi i fshatrave në Prizren, dhe burimet tjera si (Damjan, Greqinë, Opterushë, Drenovc, Senoc, Hoqë e Madhe, si dhe mostrat merren e dhe ne NJ.O. Batushë).

Testimet bëhen në: RA 01-: Furnizimi Gjakovë; RA02-Furnizimi Rahovec; ; RA03-:Furnizimi Fshatrat Prizren; RA 04- Furnizimi Demjan; RA 05- Furnizimi Drenovc; RA 06- R07-, Furnizim Hoqë e Madhe Furnizimi, Opterushë; RA 08- Furnizimi Senoc ; RA 10-Furnizimi Greqinë dhe RA-Reka e Keqe.

Tabela - Analizat e Ujit gjatë muajit Janar –Dhjetor 2021, krahasuar me vitin 2020:

Muaj	Analizat Mikrobiologjike 2021	Analizat Fiziko-Kimike 2021	Total 2021	Analizat Mikrobiologjike 2020	Analizat Fiziko-Kimike 2020	Total 2020	Ndryshimi 2021/2020
Janar	82	144	226	139	139	278	-52
Shkurt	72	135	207	139	139	278	-71
Mars	72	142	214	85	141	226	-12
Prill	71	133	204	64	132	196	8
Maj	74	143	217	64	141	205	12
Qershor	96	160	256	77	145	222	34
Korrik	79	132	211	64	126	190	21
Gusht	100	159	259	72	135	207	52
Shtator	92	135	227	60	123	183	44
Tetor	81	153	234	68	132	200	34
Nëntor	105	170	275	80	144	224	51
Dhjetor	104	248	352	77	132	209	143
Totali:	1028	1854	2882	989	1629	2618	264

Grafikoni - Paraqitja grafike e analizave të ujit dhe krahasimi 2021/2020

**Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit**

Gjatë Vitit 2021, ekipi i mirëmbajtjes së rrjetit të ujit të pijes në tërë sistemin që përfshinë qytetin e Gjakovës me Fshatra si dhe Njësinë e Rahovecit, Njësinë e Lumëbardhit dhe NJ.O . Reka e Keqe, me angazhim të plotë dhe përkujdesje e ka bërë mirëmbajtjen e rrjetit dhe eliminimin e defekteve që paraqiten në rrjetë ku kryesisht janë defekte të natyrave të ndryshme dhe dimensioneve të ndryshëm e në rastet më të shpeshta janë defektet në rrjetin nga materiali i Azbest-Cementit. Defektet gjatë këtij viti janë kryer me kohë sidomos është respektuar koha e kryerjes së defekteve që të jetë sa më e shkurtër në mënyrë që të ndikohet në zvogëlimin e humbjeve që janë akoma të larta.

Gjatë vitit 2021, kemi pasur paraqitje të defekteve me shumë të natyrave me të vogla se < 63 mm, por edhe një numër të vogël të defekteve >63 mm, ku fal ekipeve të mirëmbajtjes në teren, defektet janë sanuar në afatin e duhur kohor. Në rastet më të shpeshta janë defekte të rrjetit nga materiali i Azbest-Cementit. Duhet të bëhet ndërrimi i një sasive të rrjetit në mënyrë që të ulen shpenzimet e mirëmbajtjes dhe pjesëve fazonike dimensionet > 1".

Gjatë tremujorit Janar- Mars 2021, kemi bërë instalime të reja të gypave apo ndërrim të gypave në: fshatin Ratkoc: L=15 m, Ø 3/4, fshatin Rakovinë: L=15 m PE DN Ø 3/4. Ndërrim i ujësjellësit në fshatin Doblibare: L=25 m, PEDN Ø63. Ndërrimi i ujësjellësit në fshatin Gexhe: L=15 m PEDN Ø 315. Ndërrim i gypit në fshatin Osek Pashë L=25m PE Ø 63, ndërrimi i gypit në Rr. Bajram Curri L=10m PE Ø ¾. Ndërrim i gypit në lagjen Kolonia Rr. A. Ibra L=250 m, PE Ø63 mm/10 bar. Ndërrim gypit në lagjen Kolonia Rr. A. Ibra L=142 m, PE Ø63 /10 bar,-Investim KRM Çabrati, ndërrim i rrjetit në fshatin Bec, L=90 m, PE Ø3/4, instalim i ri i gypit në fshatin Planqor, L=124m, PEØ1 coll , Instalim i ri i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Brovinë, L=410m PEØ63/10 bar, dhe L=40m Ø1 coll. Në Rahovec si; Ndërrim i rrjetit në Rahovec, Rr. Xhelal Hajda dy segmente L=140 m, PE Ø90/16 bar, me bashkëfinancim dhe L=60m, PE Ø90/16 bar.

Gjatë tremujorit Prill - Qershor 2021, kemi bërë instalime të reja dhe ndërrim të gypave si: Ndërrim i rrjetit në fshatin Ratkoc, L=76 m, PE Ø63 dhe Instalim i ri i gypit në Rr. Sadik Stavileci, L=55m, PE Ø 3/4 coll. Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cermjan, L=400 m PEDN Ø63/10 bar dhe L=70 m PEDN Ø25/10bar, instalim i ri i rrjetit në fshatin Rogovë, L=50m, PEDN Ø63/10bar.

pastaj ndërrim i gypit në fshatin Morinë, L=1000m PEDN Ø 90/16 bar. Instalim i ri i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Madanaj, L=90m PEDN Ø40/10 bar. Instalim i ri i rrjetit të ujësjellësit në xhamin e vjetër në fshatin Smolic, L=43m PEDN Ø40/10 bar. Rahovec; ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në Rr. Ali Hasku, L=450m PEDN Ø63/10bar, dhe Prizren; ndërrim i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Krushë e Madhe, L=30m PEDN Ø25/10 bar. Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Rogovë

L=200m PEDN Ø63/10 bar. Ndërrimi i rrjetit ne fshatin Ujz, L=40m PEDN Ø40/10bar, ndërrimi i rrjetit te rrugën Gjon Nikollë Kazazi, L=118m PEDN Ø250/10bar, Instalim i ri i rrjetit ne fshatin Babaj bokës, te tyrbja e pulave L=600m PEDN Ø32/10 bar. Rahovec; ndërrim i rrjetit të ujësjellësit në rrugën Sadedin Hajda, L=237m PEDN Ø32/10 bar. Instalim i ri i rrjetit ne rrugën Halit Hoxha, L=50m PEDN Ø90/10 bar dhe Prizren; ndërrim i rrjetit në fshatin Fortesë, L=35m PEDN Ø63/10 bar.

Gjatë tremujorit Korrik - Shtator 2021, kemi bërë instalime të reja te gypave, por edhe zëvendësime te gypave me gypa kualitativ si: Instalimi i ri i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cermjan L=110m, PEDN Ø63/10 bar. Në NJ.O. Prizren, ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Piranë L=110m, PEDN Ø40/10 bar. Nj. O. Reka e Keqe si; Instalimi i ujit ne shkollën fillore ne fshatin Sheremet L=20 m, PE Ø32/10 bar. Instalim i ri i ujësjellësit në fshatin Nivokaz, L=144 m, PEØ50/16 bar dhe L=30m, PEØ25/10 bar. Në Nj. O. Prizren; Instalim i ri i ujësjellësit ne fshatin Piranë L=500m, PE Ø63/10 bar. Ndërrimi i rrjetit në fshatin Rogovë L=35m, DNØ32/10 bar, Instalimi i ri i ujësjellësit në fshatin Bishtazhin L=205m, DNØ63/10 bar, Instalim i ri i ujësjellësit ne fshatin Jabllanicë L=600m DN Ø63/10 bar. Nj. O. Reka e Keqe si; Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit ne fshatin Morinë L=147m, DN Ø50/16 bar, Instalim i ri i rrjetit ne fshatin Molliq L=32m, DN Ø50 /16bar, Instalim i ri i rrjetit ne fshatin Molliq L=119.5m, DN Ø50 /16bar, Instalim i ri i rrjetit ne fshatin Brovinë L=135m, DN Ø40 /10bar. NJ.O. Rahovec: Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit ne Rr. Gëzim Hamza, L=127 m, DN Ø250/10bar.

Gjatë tremujorit Tetor - Dhjetor 2021, kemi bërë instalime të reja te gypave, por edhe zëvendësime te gypave me gypa kualitativ si: Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Bardhaniq, L=100m Ø63/10 bar, dhe L=30m Ø40/10 bar. Instalim i ri i rrjetit ne fshatin Qifllak, L=830 m Ø63/10 bar. Ndërrim i rrjetit ne rrugën Fehmi Agani (martiret Dinaj), L=395 m Ø90/10 bar dhe L=600m, Ø63/10 bar. Në NJ.O Prizren: Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit ne fshatin Krushë e Vogël, L=90 m Ø32. Instalim i ri i rrjetit të ujësjellësit në Rr. Dëshmoret e Morinës L=90 m DN Ø40/10 bar. Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit ne fshatin Dobrosh te rezervuari L=160m, DN Ø160/10 bar. Në NJ.O. Rahovec; ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit ne Rr. UÇK L=235m, DN Ø63/10 bar, Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit ne fshatin Malësi e vogël (Radostë) L=400m, DN Ø90/10 bar, dhe NJ.O. Prizren; ndërrimi i rrjetit në fshatin Krushë e vogël L=15 m, DN Ø25/10 bar. Ndërrim i rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Osek Pashë L=85m DNØ63 dhe L=10m, DN Ø50. Instalim i ri i gypit ne rrugën Bujar Roka L= 60 m, DN Ø63/10 bar.

Deri në fund të muajit Dhjetor 2021, gjatësia e rrjetit të ujësjellësit sipas shërbimit gjeodezik në ArcMAP, gjendja e rrjetit në ArcGIS është: 1,213.863 m, apo **1.213 kilometra**.

Gypa qe furnizohen nga liqeni i Radoniqit: 946.138 m, dhe gypat qe furnizohen nga burimet: 267.725 m.

Defektet e poshtëshënuara janë si pasojë e rrjetit të vjetërsuar të ujësjellësit apo edhe instalimeve të gypave jo kualitativ nga Operatorët e ndryshëm ekonomik.

Duke llogaritur në gjatësinë e rrjetit prej: **1,213.000 m**, numri i defektet te paraqitura në një km, është barazi me **1.2 defekte në km/vit**.

Tabela –Totali i Numërit të defekteve sipas Ø /mbi dhe nën 2 coll/

Vitet	2021			2020			
Muajt	Nën 2 coll	Mbi 2 coll	Gjithsejtë 2021	Nën 2 coll	Mbi 2 coll	Gjithsejtë 2020	Ndryshimi
Janar	188	35	223	221	38	259	(36)
Shkurt	209	22	231	174	35	209	22
Mars	267	39	306	202	35	237	69
Prill	256	37	293	211	40	251	42
Maj	282	41	323	180	47	227	96
Qershor	320	42	362	207	40	247	115
Korrik	307	57	364	230	38	268	96
Gusht	320	51	371	277	44	321	50

Shtator	356	34	390	276	46	322	68
Tetor	283	45	328	295	47	342	(14)
Nëntor	258	52	310	252	41	293	17
Dhjetor	227	36	263	218	29	247	16
Totali:	3,273	491	3,764	2,743	480	3,223	541

Numri i defekteve të paraqitura në zonën e shërbimit gjatë vitit 2021

Muaji	Gjakovë Fshatrat		Gjakovë Qyteti		Gjithsejtë NJ.O. Gjakovë		NJ.O. Reka e Keqe		NJ.O. Rahoveci		NJ.O. Prizreni		Gjithsejtë		Totali i defekteve
	nën Ø63	mbi Ø63	nën Ø63	mbi Ø63	nën Ø63	mbi Ø63	nën Ø63	mbi Ø63	nën Ø63	mbi Ø63	nën Ø63	mbi Ø63	nën Ø63	mbi Ø63	Σ
Janar	33	12	40	12	73	24	5	1	92	5	18	5	188	35	223
Shkurt	49	3	40	8	89	11	3	8	86	5	26	3	204	27	231
Mars	61	11	53	11	114	22	14	1	116	3	23	13	267	39	306
Prill	67	12	48	8	115	20	7	2	108	6	26	9	256	37	293
Maj	56	9	53	13	109	22	12	5	136	3	25	11	282	41	323
Qershor	89	5	53	11	142	16	23	10	122	4	33	12	320	42	362
Korrik	66	7	65	10	131	17	17	10	134	19	25	11	307	57	364
Gusht	73	11	49	16	122	27	15	6	131	7	52	11	320	51	371
Shtator	90	11	80	4	170	15	18	1	107	13	61	5	356	34	390
Tetor	71	10	53	22	124	32	17	3	106	5	36	5	283	45	328
Nëntor	61	17	50	13	111	30	14	5	115	9	18	8	258	52	310
Dhjetor	54	12	41	10	95	22	9	1	97	7	26	6	227	36	263
	770	120	625	138	1395	258	154	53	1350	86	369	99	3268	496	3764
Sipas Njësie						1653		207		1436		468			3764

Mirëmbajtja dhe ndërrimi i ujëmatësve 2021,

Gjatë muajit Janar - Dhjetor 2021, kemi pasur më pak defekte në dëmtimin e ujëmatësve për shkak të kushteve atmosferike, por prezantojmë rastet kur punëtorët tonë apo edhe konsumatorët, lajmërojnë rastet e prishjeve, bllokimit të ujëmatësve nga copat e gurit, thyerje të ndonjë dhëmbëzori, bllokimi në zonat e ulëta nga zalli, si dhe ndërrimi i xhamave etj.

Në kemi filluar edhe me ndërrimin e ujëmatësve, të cilat gjinden në defekte apo nuk bëjnë matjen e duhur pas vlerësimit të kontrollës dhe çkyçjes, por edhe instalimin e ujëmatësve të ri në lidhje të reja, ku për herë të parë sipas Rregulloreve të ARRU-së, e blenë vetë konsumatori sipas standardeve të kërkuara, dhe deri në fund të muajit Dhjetor, janë ndërruar/zëvendësuar si më poshtë:

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, është ndërruar dhe riparuar kjo sasi e ujëmatësve, por janë vendosur ujëmatës edhe të konsumatorët të cilët nuk kanë pasur ujëmatës dhe janë faturuar paushall.

Tabela-Ujëmatës të rij dhe të pastruar gjatë vitit 2021, krahasuar me vitin 2020

Vitet	2021			Total	2020			Total
	Ujëmatës të ri	Servisim i ujëmatësve	Ndërrimi i xhamave		Ujëmatës të ri	Servisim i ujëmatësve	Ndërrimi i xhamave	
Janar	48	15	5	68	62	10	2	74
Shkurt	57	13	16	86	47	5	1	53
Mars	59	7	8	74	26	6	2	34
Prill	78	16	-	94	36	5	1	42
Maj	79	35	3	117	47	9	-	56
Qershor	66	10	6	82	81	13	4	98
Korrik	70	8	2	80	76	6	-	82
Gusht	52	2	2	56	73	5	1	79
Shtator	56	42	2	100	101	3	1	105
Tetor	64	11	7	82	68	21	-	89
Nëntor	66	19	10	95	57	5	2	64
Dhjetor	51	29	4	84	68	28	5	101
Totali:	746	207	65	1,018	742	116	19	877


Paraqitje të reja të konsumatorëve gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021

Nga paraqitjet vullnetare të konsumatorëve për legalizimin e lidhjeve të reja, si dhe puna e grupeve të kontrollës në teren me evidentimin e konsumatorëve të cilët mbajnë lidhje jo legale kompania arrin që në vitin 2021, të kemi 2047 konsumator, me kontrata për shërbime të nënshkruara në të tri Njësitë (Gjakovë, Rahovec, Lumbardh dhe Nj. O. Reka e Keqe), apo krahasuar me vitin 2020, kemi një ramje prej -799 konsumator sepse janë regjistruar vitin e kaluar konsumatorët e Rekës së Keqe.

Tabela - Paraqitje të reja të konsumatorëve gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020

Muaji	2021	2020	Ndryshimi
Janar	105	63	42
Shkurt	99	545	-446
Mars	253	138	115
Prill	112	242	-130
Maj	181	382	-201
Qershor	230	186	44
Korrik	201	228	-27
Gusht	196	228	-32
Shtator	215	300	-85
Tetor	219	259	-40
Nëntor	91	157	-66
Dhjetor	145	118	27
Totali:	2047	2846	-799

Grafikoni - Paraqitje të reja të konsumatorëve gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021/2020



Mirëmbajtja e rrjetit të Kanalizimit Fekale dhe Atmosferik Gjakovë, Rahovec

Rrjeti i kanalizimit fekale për Gjakovë dhe Rahovec, përafërsisht është 81 km. Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është përafërsisht 90% për zonën e shërbimeve për ujëra të zeza në zonat urbane të Gjakovës dhe Rahovecit.

Ekipi i mirëmbajtjes së kanalizimit ka bërë mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit fekal dhe Atmosferik të qytetit në Gjakovë dhe në Rahovec.

Këtu përfshihet pastrimi i rrjetit, pusetave dhe ujë mbledhësve në njësit që menaxhohen nga ekipa e mirëmbajtjes së kanalizimit.

Tabela - Intervenimet në rrjetën e Kanalizimit Fekale gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2021

Vitet	2021			2020		
	Pastrimi rrjetit	Pas. Pusetave	Int. me cistern	Pastrimi rrjetit	Pas. Pusetave	Int. me cistern
Muajt						
Janar	8,515	223	87	7,405	158	51
Shkurt	6,460	162	66	5,945	151	43
Mars	6,420	133	71	5,359	160	57
Prill	6,327	167	83	6,305	188	64
Maj	5,370	107	58	5,340	175	73
Qershor	3,895	109	57	6,365	130	65
Korrik	4,745	151	73	6,795	174	63
Gusht	4,890	94	63	6,875	176	74
Shtator	5,926	181	97	5,810	170	75
Tetor	5,221	105	84	5,835	172	71
Nëntor	5,875	111	84	6,364	215	54
Dhjetor	6,450	129	90	7,736	205	96
Totali:	70,094	1,672	913	76,134	2,074	786

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim gjatë vitit 2021, kanë hartuar këtë projekte ideore:

- Është punuar në projekte për ndërrimin e gypave të AC në PE, në qytetin e Gjakovës.
- Kemi kompletuar projektin për ndërrimin e gypave nga AC në PE prej "Gjykatës në Osek-Hyle".
- Kemi bërë përpilimin e projektit për ndërrimin e ujëmatësve me ujëmatësit e mençur, dhe paramasën e pusetave për këto ujëmatësa.
- Kemi finalizuar projektin për të dërguar ujë të pijes në fshatrat, Drenoc, Senoc si dhe Polluzhë.
- Kemi kompletuar pothuajse një projekt mjaft të rëndësishëm, për furnizimin me ujë nga KRU Gjakova, të fshatrave të Rahovecit (Opterushë, Zoqisht, Hoçë e Madhe), projekt ky të cilin e kemi përfunduar paramasën, përkshkrimin teknik, nyjat dhe detalet.
- Është përfunduar Paramasa për mirëmbajtjen e rrugës nga Rezervuari i Batushës deri te Kaptazha, rrugë kjo me gjatësi diku rreth 8000 metra.
- Kemi bërë zgjidhjen për kyçje te Rezervuarit të Brekocit me ujin e Bjeshkës.
- Përpos projekteve, gjithashtu kemi bërë dhe disa takime online me WBIF, për ndërrimin e gypave të Azbestë Çimentos në PE dhe ndërrimin e orëmatësve duke i zëvendësuar me orëmatësit e mençur.
- Kemi përgatitur kërkesën me shkrim në Infra Kos për leje ndërtimore, për rrugën Xërxe, Gexhe dhe Dobidol.
- Kemi përgatitur një projekt ideor për ndërtimin e rrugës nga fshati Shishman deri te Lapidari i 14 dëshmorëve.
- Gjithashtu kemi punuar për të minimizuar humbjet e ujit, kemi bërë leximin e disa ujëmatësve, duke gjetur kështu zgjidhjen për të ulur humbjet e ujit në fshatin Brovinë.
- Gjatë kësaj periudhe, zyra jonë ka përgatitur paramasën, projektin gjithashtu dhe kërkesën për tender për rrethojat në Sopot.
- Janë përgatitur kërkesat për tender për katër projektet tona në të cilat pritet të fillojnë punimet shumë shpejtë.
 - ⇒ Projekti: Asfaltimi i rrugës nga rruga kryesore deri te rezervuari në Batushë dhe objekti Administrativ L=900m''.
 - ⇒ Projekti: Ndërtimi i ujësjellësit në Lagjen e Firzës për 42 shtëpi, L=8268 m''.
 - ⇒ Projekti: Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit nga Fsh. Zhub për Qafë Prushë, Zylfaj dhe Dogane, L=9239 m''.

⇒ Projekti: Ndërtimi i stacionit të pompave shtytëse për fshatin Morinë.

- Është punuar paramasa për ndërrimin e gypit AC Ø200 me gyp PE 100RC TYPE2 DN250. Për shkak të punimit të rreth rrotullimit të rrugës Bujar Roka.
- Është vendosur pjesa fazonike për kyçjen e gypit DN110 për furnizim me shtypje më të mirë të ujit për shtëpitë që ndodhen në zonën e Lug bunarit.
- Janë mbikëqyrur punimet e ndryshme që kanë ndodhur në terren gjithashtu dhe defektet e ndryshme, ku njëri nga ta ka qenë dhe defekti që ka ndodhur në gypin kryesor Ø600 në Xërxe, i cili është riparuar në një kohë rekorde.
- Është kompletuar në tërësi projekti kryesor për ndërtimin e ujësjellësit regjional i Malishevës – Faza e parë.
- Është proceduar kërkesa për tender për 'Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol.
- Është bërë zgjidhja për kyçjen për furnizim me ujë të pijshëm për Fshatin e Gjellbërt.
- Identifikimi i gropave ku do të bëhet dhe mbushja me asfalt me operatorin Berisha Com.
- Janë mbikëqyrur dhe punimet e ndryshme që janë duke u ekzekutuar nëpër terren, dhe kemi përcjell nga afër defekte të ndryshme që kanë ndodhur gjatë këtij muaji.
- Caktimi i zgjidhjes teknike për rrugën Martirët Dinaj, dhe mbikëqyrja gjatë ekzekutimit të punimeve.
- Është përfunduar projekti për ndërrimin e gypave nga AC në PE, për zonën e Rahovecit, ku është përfunduar paramasa për secilën rrugë dhe gjithashtu është bërë dhe situacioni.
- Kemi bërë dy takime me anëtarët e WBIF, për studimin e fizibilitetit për projektin e ndërrimit të gypave nga AC në PE për tërë zonën e shërbimit të K.R.U. Gjakova.
- Është përgatitur dhe paramasa për "Rrethoja e parcelës te diga (në mesë të rrugës dhe gjelbërimit) te liqeni", e cila është dërguar në prokurim për të hyrë në fazën tenderuese.
- Disa vizita në Deçan te Lumi Lumbardh, ku qyteti ka filluar shkarkimin e ujërave të zeza, ndërsa na kemi shprehur shqetësimet tona, për shkak të ndotjes së ujit, i cili furnizon liqenin e Radoniqit. Është bërë ankesa në Komunën e Deçanit nga organet kompetente të KRU Gjakovës, dhe kemi dalë në vendngjarje për verifikimin e gjendjes. Pas ankesës, Operatori Ekonomik i cili kryen punimet, ka ndërtuar një impiant për filtrimin e ujërave të zeza afër lumit te ura, ku bëhet shkarkimi i ujërave të zeza. Ky objekt është momental, derisa të bëhet shkarkimi jashtë pikës ku mbledhet uji për mbushjen e liqenit.
- Përpilimi i projektit për degëzimin nga fshati Rugovë deri te pompat në fshatin Muhader.
- Monitorimi i punimeve të filluara nga Kompania e kontraktuar prej Komunës për zgjerimin e rrugës Skënderbeu.

Shërbimi Gjeodezik Janar-Dhjetor 2021

Shërbimi gjeodezik, ka qenë i angazhuar në inqizimin e havarive, lidhjeve të reja në tri njësite punuese në Gjakovë, Rahovec dhe Lumbardh. veç kësaj ka kryer dhe punë të tjera sipas kërkesave nga udhëheqësit apo departamentet tjera, të cilat po i cekim me poshtë.

Deri në fund të muajit Mars 2021, gjatësia e rrjetit të ujësjellësit sipas shërbimit gjeodezik në ArcMAP, është: 1,157.453 m apo 1.157 kilometra.

Ndërsa deri në fund të muajit Dhjetor 2021, gjatësia e rrjetit të ujësjellësit sipas shërbimit gjeodezik në ArcMAP, gjendja e rrjetit në ArcGIS është: 1,213.863 m, apo 1.213 kilometra.

Gypa që furnizohen nga liqeni i Radoniqit: 946.138 m, dhe gypat që furnizohen nga burimet: 267.725 m.

Tabela –Inqizimi i havarive në teren dhe Inqizimi i dislokimeve dhe instalimeve të reja në teren në ujësjellës dhe kanalizim

Nr. rendor	Lokacioni	Përshkrimi i punës – Numri i inqizimeve 2021	Përshkrimi i punës – Numri i inqizimeve 2020
	Njësia punuese Gjakovë, Rahovec, Lumbardh dhe NJ.O. Batushë	Numri i Inqizimeve të havarive, Inqizimi i dislokimit të gypave dhe instalimi i gypave të rinj nga 1 coll deri Ø 1100 nga implementimi i projekteve	Numri i Inqizimeve të havarive, Inqizimi i dislokimit të gypave dhe instalimi i gypave të rinj nga 1 coll deri Ø 1100 nga implementimi i projekteve
1.	A. Ujësjellësi:	Janar –Dhjetor 2020 Numri i Inqizimeve të havarive: 561 . Numri i inqizimeve të lidhjeve të reja: 144 , Inqizime ne projekte 47 dhe piketime 41	Janar –Dhjetor 2020 Numri i Inqizimeve të havarive: 591 . Numri i inqizimeve të lidhjeve të reja: 220
2.	B. Kanalizimi	Janar –Dhjetor 2020 Numri i Inqizimeve 14	Janar –Dhjetor 2020 Numri i Inqizimeve 12

Aktivitete tjera te realizuara nga Shërbimi gjeodezik:

- E kemi përgatitur listën me faturat e tatimit në pronë për pronat e K.R.U. Gjakova të klasifikuara në bazë të nr. të tatimpaguesit dhe ia kam dërguar K. Zhavelit.
- Jemi marrë me përgatitjen e situacionit me të gjithë stacionet e pompave, si dhe kemi identifikuar distancën në kilometra nga objekti qendror i Kompanisë deri tek secili stacion i Pompave.
- Në ArcGIS e kemi ndarë rrjetin në primar sekondar dhe lidhjet shtëpiake për t'i përgatitur për programin EDAMS.
- Jemi marrë me parcelat rreth liqenit të Radoniqit në të cilat prek rruga e re që do të ndërtohet nga K.K. Gjakovë.
- Në Kadastrën e Gjakovës kemi marrë fletë posedimet për disa parcela tek liqeni.
- I kemi dërguar H. Hulaj (K.K. Deçan) nr. e parcelave në ZK Ratish i ulët për ta verifikuar pronësinë në disa parcela.
- Në Kadastrën e Gjakovës kemi marrë koordinatat e kufijve të parcelave ku ndodhet trafo në Sopot, përkatësisht parcelat 1125-0, 1219-2 (ZK Zhdrellë) të vulosura.
- Bashkë me A. Prruthi, K. Dinarama dhe S. Metbala kemi fillua dhe përfundua me komentimin e termave të referencës për VNMS, St. E Fizibilitetit, DD dhe DT të projektit WBIF.
- K.K. Deçan, kemi dorëzuar kërkesën për bartje pronësie në ZK Ratish i ultë.
- Me M. Zika jemi marrë me kompletimin e dokumentacionit për kërkesën për marrje me qira të parcelës 888-1, ZK. Radoniq.
- Kemi vërtetuar pronësinë e disa parcelave afër liqenit, ZK. Radoniq dhe e kemi përgatitur situacionin.
- 21.07.2021 _ Prishtinë - MBPZHR, Bashkë me M. Zika kemi qenë në Agjensionin Pyjor të Kosovës për çështjen e parcelës 888-1 ZK. Radoniq.
- Kemi pritur kompaninë hungareze për projektin SCADA, ku kemi vizituar Stacionin e Filtrimit në Zhdredhë, Stacioni i pompave në Sopot dhe Rezervuarin në Qerim.
- Bashkë me M. Zika kemi përgatitur një kërkesë/sqarim dhe iu kemi drejtuar KK. Gjakovë, për rrugën tek Liqeni .
- Ja kemi dërguar Arian Shuku (WBIF) shënimet në formatin "shapefile" për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

- Në Kadastrin e Gjakovës kemi marrë fletëposedimin dhe kopjet e planit për parcelat 64-0, 90-0 dhe 92-0, ZK. Batushë.

Raporti për kontratat në të cilat udhëheqësi është i caktuar si menaxher:

- Mirëmbajtja / Servisimi i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a.:
- Furnizim me autogoma dhe bateri për nevojat e KRU Gjakova sh.a.:

Detektimi Akustik i Rrjetit Janar-Dhjetor 2021

Njësia për detektim Akustik është duke u përdorur sipas nevojës në rastet e ndonjë dyshimi eventual për rrjedhje të ujit. Janë bërë detektime sipas kërkesave gjatë paraqitjes në zyrën e Departamentit Teknik, zyrën për marrëdhënie me konsumatorë, apo paraqitjes te zyrat e mirëmbajtjes së rrjetit, si në vijim:

Nr. rendor	Lokacioni	Përshkrimi i punës – Numri i detektimeve me aparat detektues 2021	Përshkrimi i punës – Numri i detektimeve me aparat detektues 2020
	Njësit punuese; Gjakovë, Rahovec, Lumbardh dhe NJ.O. Reka e Keqe	Inqizimi i detektimeve në teren sipas kërkesave nga sektori i mirëmbajtjes	Inqizimi i detektimeve në teren sipas kërkesave nga sektori i mirëmbajtjes
1	Detektimi i realizuar	Janar – Dhjetor 2021, 158 detektime të ndryshme	Janar – Dhjetor 2020, 143 detektime të ndryshme

Spektori për Mirëmbajtje Mekanike dhe Elektrike, Janar -Dhjetor 2021

Spektori për mirëmbajtje mekanike dhe elektrike gjatë vitit 2021, ka realizuar këto aktivitete: Furnizimi me derivate të naftës për automjetet e KRU "Gjakova" Sh.A. në "Petrol Company", Përpilimi dhe dorëzimi i raporteve të menaxhimit dhe pranimi për:

- a) GPS-at e automjeteve të KRU Gjakova 1-12/2021
- b) Furnizim me derivate të naftës 1-12/2021
- c) Furnizim me auto goma dhe bateri 1-12/2021
- d) Servisimi i automjeteve të lehta-renda 1-12/2021
- e) Kontrollimi i faturave të energjisë elektrike të të gjitha objektet e KRU Gjakova të muajit 09-11/2021;

Përpilimi dhe dorëzimi i raportit mbi matjen e shtypjes së ujit në sistemin e furnizimit të KRU GJAKOVA, Janar – Dhjetor 2021, duke llogaritur që matjet bëhen tri herë në muaj.

Kontrollimet dhe intervenimet e përditshme në stacionet e pompave dhe rezervarëve akumulues Janar – Dhjetor 2020.

Gjatë vitit janë realizuar;

Kontrollimet dhe intervenimet e përditshme në 36 stacionet e pompave dhe 40 rezervarëve akumulues si; Stacioni i pompave: Hereq, Cermjan, Pyrgu i liqenit, Sopot, Fierzë, Pataqan 1, Pataqani 2, Berkoc, Damjan 1, Damjani 3, Novo selle, Rezine, Kushavec, Ujzi, Muhader, Karashingjergj, Rahoveci 1, Çabrat, Vrajake, Dedaj, Breg Drini, Reti e epërme-poshtme, Rahoveci 2, Drenoc, Senoc, Bratotin, Opterushe, Lugishtë e Hasit, Hoqe madhe, Palluzhë, Dushkaje, Doli, Lipovec, Kusarë, Pastasel, Palabardh dhe rezervarët në Batushë.

Gjithashtu edhe punë tjera nga sektori i mekanikes dhe elektrikes si:

- Monitorimi dhe Servisimi i të gjitha automjeteve të KRU Gjakova,
- Shikimi teknik dhe Regjistrimi i automjeteve të kompanisë;
- Intervenime në stacionet e pompimit në të gjitha pikat dhe mbajtja nën kontroll të pompave për furnizim 24/7;

- Monitorimi dhe analiza e shpenzimeve të derivateve nga punëtorët e kompanisë,
- Kërkesa - Furnizim me gyp furnizim me gyp fleksibil gome,
- Kërkesa për Furnizim me autogoma dhe bateri për nevojat e KRU Gjakova,
- Kontrollimi dhe instalimi i pompave ne stacionin e pompave ne Pastasel,
- Lëshuarja e autorizimeve te ndryshme për ngasjen e automjeteve te kompanisë
- Hartimi i raporteve ditore dhe mujore

3.3 Ndryshimet që kanë ndodhur në performanc operative në krahasim me vitin e kaluar dhe me caqet e planit të biznesit .Pse këto ndryshime kanë ndodhur

Pasqyra e performances operative në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

		2020	2021	Ndryshimi	BP 2021	2021	Ndryshimi
1	Uji i prodhuar në m ³	15,202,83	15,910,07	+707,236	16,038,87	15,910,071	-128,802
2	Uji i faturuar në m ³	8,856,057	9,167,666	+311,609	9,391,235	9,167,666	-223,569
3	Humbja e ujit në %	42%	42%	0	41%	42%	+1
4	Konsumatorë të regjistruar	41,851	43,816	+1,965	45,083	43,816	-1,267
5	Nr. i konsumatorëve me ujëmatës	41,713	43,704	+1,991	45,083	43,704	-1,379
6	Kualiteti i ujit	100%	100%	0	100%	100%	0
7	Numri i punëtorëve	287	293	+6	307	293	-14

PRODHIMI I UJIT- Prodhimi i ujit në vitin 2021, krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2020 ka rezultuar me një rritje prej 707,236 m³, ndërsa krahasuar me BP ka zvogëlim prej 128,802 m³. Falë kapaciteteve të prodhimit, kemi arritur te sigurojmë 24 orë ujë te pijes për konsumator. Humbjet me vitin 2020 janë të njëjta dhe me 1% më shumë BP 2021, me çka Kompania në vitin 2022 këtij treguesi duhet ti kushtojë rëndësi të madhe me aktivitete në teren dhe me Investime.

FATURIMI m3- Në vitin 2021 faturimi në m3 është për 311,609 më i lart se viti 2020, si dhe për 223,569 m3 më i ulët se BP 2021. Rënia e faturimit m3 me BP 2021 si duket ka rrjedhur nga mos planifikimi i sakt i tij.

NR. I KONSUMATORËVE- Në vitin 2021 krahasuar me numrin e konsumatorëve ne vitit 2019 ka rezultuar me rritje prej 1,965 ndërsa krahasuar me BP 2021 numri i konsumatorëve ka rënie prej 1,267 konsumator, nga mos parashikimi i saktë i tyre me Biznes Plan.

NR. I TESTEVE TE DESHTUARA-Përmirësimi i cilësisë se ujit të pijshëm, ne laboratorët tona, si në atë për analizat fiziko- kimike dhe atë bakteriologjike, nga stafi i Sektorit të prodhimit të ujit në kontinentet është bërë glorifikimi i ujit me sasinë e kërkuar sipas standardit të caktuar nga IKSHP-ja, janë marrë të gjitha aktivitetet që uji nga lumi Bistrica të futet në liqe me sasinë maksimale dhe të ketë kapërderdhës në sasinë e dëshiruar që ka mundur edhe të kemi ujë cilësor të pastër .

NR. I PUNËTORËVE - Në vitin 2021 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2020 është më ulët për 14 punëtorë, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ka pas 6 punëtor më shumë

HUMBJET E UJIT -Në vitin 2021 humbjet e ujit jen 42% krahasuar me vitin 2020 ku humbjet kane genë të njëjta, humbjet e ujit kanë rritje prej 1%, kurse me BP 2021. Menaxhmenti në vitin 2022 ka marre detyre që me aktivitetet e shtuara ne teren nga ane kontrolles dhe ekipit te mirëmbajtjes te ule humbjet sa më shumë.

3.4 PASQYRË E PËRFORMANCES FINANCIARE DHE REZULTATET

3.4.1 Ndryshimet në të hyrat dhe shpenzimet nga viti i kaluar dhe ndryshimet me caqet e Planit të Biznesit dhe Buxhetit

Tab. Ndryshimet në të hyrat dhe shpenzimet nga viti i kaluar dhe ndryshimet nga caqet e BP

Pasqyra e performances financiare në krahasim me vitin Paraparak dhe planin e vitit aktual

		2020	2021	Ndryshimi	BP 2021	2021	Ndryshimi
1	Të hyrat nga shitja e ujit	4,370,218	4,662,378	+292,160	4,695,618	4,662,378	-33,240
2	Të hyrat tjera	730,508	888,370	+157,862	96,000	888,370	+792,370
	TOTALI	5,100,726	5,550,749	+450,023	4,791,618	5,550,749	+759,131
	Shpenzimet operative						
1	Shpenzimet e pagave	2,414,073	2,470,607	+56,534	2,450,121	2,470,607	+2,486
2	Shpenzimet e riparimeve	140,957	158,334	+17,377	124,529	158,334	+33,805
3	Shpenzimet administrative telefonit	25,319	29,200	+3,881	28,000	29,200	+1,200
4	Shpenzimet e rrymës elektrike	278,113	297,419	+19,306	292,500	297,419	+4,919
5	Shpenzimet e derivateve	77,582	89,929	+12,347	95,007	89,929	-5,078
6	Shpenzimet e kemikaleve	24,673	26,936	+2,263	145,712	26,936	-118,776
7	Shpenzimet e marketingut	18,049	16,197	-28,788	16,000	16,197	+197
8	Shpenzimet tjera operative	765,383	600,005	-165,378	748,849	600,005	-148,844
	TOTALI	3,744,149	3,688,627	-55,522	3,900,717	3,688,627	-212,090

TË ARDHURAT - Gjatë vitit 2021 me të ardhurat e realizuara KRU-ja ka mbuluar 100% të kostos së operimit të mirëmbajtjes. Krahasuar me të hyrat nga uji te vitit aktual me vitin paraparak të ardhurat janë për 450,023 € më shumë se viti 2020, ndërsa me BP janë për 759,131€ më shumë. Rritja e të ardhurave ka ndodhur, pasi në vitin 2020 kemi punuar me ndikimin e Pandemis me Covid 19.

SHPENZIMET OPERATIVE- Gjatë vitit 2021 shpenzimet operative janë për 212,090€ më të ulëta se me BP 2021, ndërsa nëse krahasojmë me vitin 2020 shpenzimet operative kanë pësuar rënie prej 55,522 €. Këto shpenzime si të tilla gjatë vitit mundësuan përmbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal te Kompanisë.

3.4.2 Ndryshimet në të ardhura dhe shpenzime –faktorët ndryshues ne këto ndryshime

Faktorët ndikues në rritjen e të ardhurave

KRU "Gjakova" SH.A., gjatë vitit 2021 të ardhurat kanë rritje kur krahasojmë të njëjtën periudhë të vitit 2020. Rritja ka ndodhur nga aktiviteti i shtuar i Kompanis në teren pasi me Pendemin me Covid kemi kaluar më lehtë në teren, pastaj puna në teren e shtuar e departamentit të shitjes, teknikës si dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve duke i furnizuar 24 ore në 7 dit pa ndërprerje.

Faktorët ndikues në rritjen e shpenzimeve

Me mjetet financiare të saja, Kompania ka investuar në ndërtimi me mjete vetanake të infrastrukturës ujore, infrastrukturës rrugore, ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë, sanimet e rrjetit të ujësjellësit, funksionimin e Stacionit të Filtrimit dhe kontrollin e cilësisë së ujit të pijes, kërkesat për realizimin e veprimtarisë administrative në kompani (shpenzimet e personelit për paga dhe mëditjet, shpenzimet e energjisë elektrikes shpenzimet e derivateve, shpenzimet e kemikaleve (përfshin aluminsulfatin, klori i gaztë, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi

dhe sigurimi i automjeteve, taksat për licencim të shërbimeve ARRU, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta), etj.

Shpenzimet e pagave

Në vitin 2021 krahasuar me vitin 2010 shpenzimet kanë pësuar rritje te lehtë prej 56,534 euro , ndërsa me BP 2020 kanë rritje për 20,486€. Në këto shpenzime hyjnë: pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet. Rritja ka ndodhur pasi Kompania ka marrur në punë të punëtorëve për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Zeza.

Shpenzimet riparimeve

Përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj. Ka rritje krahasuar me BP 2021 për 33,805. Shpenzimet e riparimeve për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 kanë rritje për 17,377€.

Shpenzimet administrative

Përfshijnë shpenzimet administrative të gjërave si: Letra, ngjyrë printeri, telefonat, etj. Shpenzimet administrative për vitin 2021 krahasuar me 2020 kanë pas rritje për 3,881€. Shpenzimet administrative për vitin 2021 krahasuar me BP 2020 kanë pasur rritje për 1,200€.

Shpenzimet e rrymës elektrike

Këto shpenzime krahasuar me BP 2021 si dhe shpenzimet e vitit 2020 kanë qenë më të larta. Shpenzimet e rrymës elektrike për vitin 2021 krahasuar me 2021 kanë rritje për 19,306 €. Shpenzimet e rrymës elektrike për vitin 2021 krahasuar me BP 2020 kanë rritje prej 4,919 €.

Shpenzimet e derivateve

Kur krahasojmë me vitin 2020 shpenzime e derivateve janë më të larta për 12,347 euro, kurse kur krahasojmë me BP 2021 janë më të ulëta për 5,078 euro.

Shpenzimet e kemikaljeve

Përfshijnë alumin sulfatin, klori i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv .Krahasuar me vitin 2020 shpenzimet e kemikaleve kanë pas rritje për 2,263€,ndërsa krahasuar me BP 2021 shpenzimet e kemikaleve kanë pese rënie për 118,776 €. Dallimi është i madh me BP 2021, pasi ne BP 2021 Stacioni i Filtrimit e parashikon edhe Karbonin Aktiv i cili blihet vetëm nëse uji ka erë. Në vitin 2021 nuk kemi pasu nevojë të furnizohemi me Karbon Aktiv.

Shpenzimet e marketingut

Përfshijnë shpenzimet për reklama, kontratat me mediat. Shpenzimet e marketingut për vitin 2021 krahasuar me 2020 kanë pas zvogëlim prej 28,788€, ndërsa krahasuar me BP 2021 kanë pas rritje për 197€.

Shpenzimet tjera operative

Përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, taksat për licencim të shërbimeve ARRU-së, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta, faturimet e ujit. Shpenzimet tjera Operative për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 kane pasur zvogëlim prej 165,378 euro, kurse kur krahasojmë me BP 2021 kane pasur zvogëlim prej 148,844 euro. Në zvogëlimin e shpenzimeve tjera për vitin 2021 ka ndikuar zvogëlimi i shpenzimeve vetanake të ujit.

Përkundër shpenzimeve të cekura Kompania gjatë vitit 2021 ka operuar me fitim operativ ku nga total Arkëtimi 4,930,875 euro zbriten Shpenzimet Operative ne shume prej 3,685,225 euro, Fitimi Operativ ka vlerën 1,245,650 Euro.

3.4.3 Komentet mbi ndryshimet ne strukturën e kapitalit ,duke përfshi huat apo ndonjë formë tjetër te financimit

Kompania gjatë vitit 2021 ka pësuar ndryshime në strukturën e kapitalit pasi që Kompania operon me humbje financiar. Humbja financiar për vitin 2021 është 58,397 euro. Humbjen financiare e shkaktojnë shpenzimet e zhvlerësimit të cilat janë në vlerë prej 1,841,272 euro.

3.5 PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT

3.5.1 Pasqyrat e progresit ne implementimin e Planit të Biznesit

Tabela- Pasqyra e performances operative dhe financiare në krahasim me BP

Treguesit kryesor te performances		Caqet e planifikuara BP 2021	Caqet e realizuara 2021	Ndryshimi
1.	Uji i prodhuar në m ³	16,038,873	15,910,071	-128,802
2.	Uji i faturuar në m ³	9,391,235	9,167,666	-223,569
3.	Konsumatorë të regjistruar	45,083	43,816	-1,267
4.	Nr. i faturave të lëshuara	45,083	43,816	-1,267
5.	Nr. i kons. që faturohen sipas leximit të	45,083	43,704	-1,379
6.	Uji faturuar për kons. me ujmatësa	8,733,849	9,103,113	+369,264
7.	Faturimi në €	4,695,618	4,662,378	-33,240
8.	Arketimi në €	3,756,494	4,816,922	+1,060,428
9.	Te hyrat tjera operative ne €	24,000	113,953	+89,953
10.	Shpenzimet operative	3,900,717	3,685,225	-215,492
11.	Shlyerja e borxheve ndaj kons.	0	0	0
12.	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët	0	0	0
13.	Parat e gatshme në bankë dhe në arkë	336,853	1,483,039	+1,146,186
14.	Stoqet	800,000	662,614	-137,386
15.	Llogarit e farkëtueshme €	12,087,290	10,024,368	-2,062,922
16.	Llogarit e pagueshme	16,338,791	16,920,719	+581,928
17.	Numri i punëtoreve	307	293	-14
18.	Numri i ankesave	400	324	-76
19.	Numri total i testeve të realizuara	3,000	2,882	-118
21.	Matja e treguesve ne %			
22.	Uji i pa faturuar	41%	42%	+1
23.	Përqindja e faturimit	100%	100%	0
24.	Përqindja e konsumit të matur	93%	99%	+6
25.	Proporcioni i kons. Me ujëmatëse	100%	100%	0
26.	Efikasiteti i stafit	6.81	6.69	-0.12
27.	Shkalla e inkasimit në % (të tërë)	80%	103%	+23%
28.	Shkalla e inkasimit në % - amvisni	87%	107%	+20%
29.	Shkalla e inkasimit në % - biznese	94%	101%	+7%
30.	Shkalla e inkasimit në % - industri	75%	84%	+9%
31.	Norma e mbulesës së punës	0.97	1.34	+0.37
32.	Norma e punës	1.21	1.30	+0.09
33.	Shpenzimet Operative për konsumator	7.21	7.01	-0.2

Uji i prodhuar në m³- Prodhimi i ujit në vitin 2021, krahasuar me prodhimin e ujit me BP 2021 ka rënie prej 128,802 euro.

Uji i faturuar në m³- Në vitin 2021 kur krahasojmë me BP 2021 ka zvogëlim në vlerë prej 223,569 m³. Zvogëlimi i faturimit ka rrjedhur si pasoje e zvogëlimit të prodhimit të ujit.

Numri i ankesave- Kur krahasojmë vitin 2021 me BP e vitit 2021 numri i ankesave ka zvogëlim për 76.

Numrin e konsumatorëve – Krahasuar me BP e vitit 2020 numri total i konsumatorëve ka zvogëlim prej 1,267 konsumatorësh, nga mos planifikimi i sakt i tyre

Arkëtimi - në Euro në vitin 2021 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2021 arkëtimi nga uji ka rritje prej 1,060,428 euro kurse nga arkëtimet tjera ka rritje prej 86,563 euro, ne total arkëtimi ka rritje prej 1,146,991 euro. Përveç në euro edhe në % ka rritje të faturimit. Rritja është r madhe kur krahasojm me BP 2021, pasi BP 2021 bëhet gjatë muajit Tetor 2020 dhe atëbotë BP e kemi bërë duke pasur parasysh Pandemin me Covid 19 dhe kemi planifikuar rënien e tij, por realiteti del ndryshe, pandemia nuk ka ndikuar shumë në arkëtim.

Humbjet e ujit - në përqindje në vitin 2021 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2021 është e më i lart për 1%.

Shlyerja e obligimeve nga kreditorët –Kompania në përgjithësi e ka arritur planin e shlyerjes së obligimeve ndaj furnitorëve si rezultat i rritjes se të hyrave të realizueshme gjatë vitit 2020, edhe pse në disa muaj kemi pasur problem me arkëtim shkaku i Pandemis me Covid 19. Kompania i ka paguar rregullisht furnitorët e saj, punëtorët dhe obligimet tatimore.

Parat e gatshme në bankë dhe në arkë - Kompania gjatë vitit 2021 e ka mbyllur me 1,483,039 euro. Mjetet financiare janë parat në bankë venake dhe ato nga donacionet për ITUN.

Shpenzimet operative - Gjatë vitit 2021 shpenzimet operative janë për 215,492 euro më të ulëta se me BP 2020. Këto shpenzime si të tilla gjatë vitit mundësuan përmbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal të Kompanisë.

Në avancimin kryerja e obligimeve me kohë ndaj konsumatorëve

Falë angazhimit profesional Kompania ka vazhduar të dëshmoi përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta profesionale në raport me konsumatorin .Ka vazhduar të modifikohet hapësira për ofrimin e shërbimeve për konsumator, me standarde të mjaftueshme që konsumatorëve të ju mundësohet qasje e lehtë në realizimin e kërkesave të tyre, dhe kryerjen e obligimeve ndaj Kompanisë. Këtë drejtim është realizuar projekti mbi Ndërrimin e ujëmatësve kryesor dhe individual, Kontrollimit, identifikimit dhe evitimit/pengimit të parregullsive/ keqpërdorimeve në shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza. Ndërtimi i rezervarëve dhe rrjetit të ujësjellësit për furnizimin me ujë të pijes ,hapja e numrit të madh të portoarkave ku me këtë planifikim po ju mundësohet konsumatorëve një shërbim më i afërt dhe cilësor i pagesave si dhe për kompaninë po arrihet heqja e keshit nga inkasatet .

Përkujdesja për sigurimin e punëtorëve dhe objekteve

Në harmoni me objektivin e përgjegjshmërisë në aspektin social Kompania ka ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë për punëtorët e saj ,duke i siguruar kushtet e mira të punës në bazë standardeve më të larta .Po përmendim këtu; Realizimi i Programit të sigurimit të veshmbathjeve të punëtorëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Edhe për vitin 2021 është planifikuar që punëtorët të furnizohen me të gjitha mjetet e mbrojtjes në punë si dhe është realizuar në tërësi procedura e prokurimit për sigurimin me kohë të tyre .

Kompania ka investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve në realizimin e trajnimeve ,pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese. Janë realizuar blerje të pajisje kompjuterike për zyrë dhe punë në teren .

3.5.2 Përmbledhje e progresit të objektivave kryesore dhe strategjike

Nga treguesit e arritur të performancës të vitit 2021, konkludojmë se kompania gjatë vitit 2021 ka arritur që të ketë performancë pozitive krahasuar me vitin paraprak 2020 pothuajse në të gjithë treguesit e performancës .

Realizimi i parametrave oscilon 98% e që kjo ka ndodh që mos të realizojmë 100% të treguesve vetëm për shkak se në një masë të vogël ka ardh deri te rritja e shpenzimeve për arsyet e domosdoshme të realizimit të objektivit për implementimin e projekteve që do mundësojnë mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit dhe shtrirjen e rrjetave të reja, si dhe përmirësimin e mirëqenies së punëtorëve dhe infrastrukturës ujore në Kompani.

Treguesit	2020	2021	Ndryshimet	BP 2021	2021	Ndryshimet
Prodhimi m ³	15,202,835	15,910,071	+707,236	16,038,873	15,910,071	-128,802
Faturimi m ³	8,856,057	9,167,666	+311,609	9,391,235	9,167,666	-223,569
Humbja ujit %	42%	42%	0	41%	42%	+1

Faturimi €	4,370,218	4,662,378	+292,160	4,695,618	4,662,378	-33,240
Arkëtimi €	4,164,967	4,816,922	+651,955	3,756,494	4,816,922	+1,060,428
Arkëtimet tjera €	78,385	113,953	+35,568	24,000	113,953	+89,953
% Arkëtimit	95%	103%	+8%	80%	103%	+23%
Shpenzimet €	3,744,120	3,685,225	-58,895	3,900,717	3,685,225	-215,492
Fitimi Operativ	499,232	1,245,650	+746,418	-120,225	1,245,650	

Prodhimi i ujit në m3 - Prodhimi i ujit në vitin 2021, krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2020 ka rezultuar me rritje prej 770,236 m³, ndërsa krahasuar me BP ka gjithashtu një zvogëlim prej 128,802 m³. Falë kapaciteteve të prodhimit, kemi arritur të sigurojmë 24 orë ujë të pijes për konsumator.

Faturimi në € - Në vitin 2021 faturimi në Euro është më i lartë se në vitin 2020 për 292,160 euro ndërsa krahasuar me BP 2021 ka zvogëlim në vlerë prej 33,240 €. Rritje të faturimit gjatë vitit 2021 duke krahasuar me vitin 2020 ka ndodhur pasi në vitin 2020 si pasojë e Pandemis me Covid 19, shumë Institucione kanë qenë të mbyllura.

Arkëtimi në Euro – Në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, vlera e arkëtimit nga uji në Euro ka rritje për 651,955 € me shumë, ndërsa për 1,060,428€ më shumë se BP 2021. Rritja e arkëtimit në vitin 2021 ka ndodhur pasi viti 2020 ka qenë vit pandemit si dhe Biznes Planin 2021 Kompania e ka bërë duke pasur parasysh Pandemin dhe arkëtimi mund të bjerë në vitin 2021 njejt siq ka ndodhur në vitin 2020.

Shpenzimet Operative - Në vitin 2021 kanë qenë për 58,895 € më të ulëta se vitin 2020, kurse për 215,492 € më i ulët se BP 2021, si rezultat i rritjes së aktivitetit të Kompanisë për ngritje të performances me kushte me të mira të punës.

Humbjet e ujit - Në vitin 2021, humbjet e ujit janë 42%, njejt me vitin 2020 ,dhe për 1% më i lart se BP 2021, e cila duhet të jetë edhe preokupimi kryesorë i Menaxhmentit të Kompanisë, e cila me aktivitetet në teren dhe me Investimet Kapitale të ndikojë në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Fitimi operativ – Vitin 2021 e kemi mbyllur me Fitim operativ prej 1,245,650 euro. Krahasuar me vitin 2020 fitimi operativ në Euro ka qenë më i madhë për 746,418 euro, kurse në BP 2021 Kompania e ka planifikuar se do të ndikojë Pandemia me Covid 19 dhe do të bjerë arkëtimi. BP për vitin 2021 bëhet në Tetor 2020.

Nr. i punëtorëve- Në vitin 2021 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2020 është më ulët për 14 punëtorë, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ka pas 6 punëtor më shumë .

Nr. i testeve të dështuara - Në vitin 2021, i plotësojnë standardet e kërkuara sipas IKSH. Numri i tyre gjithmonë tregon treguesin 0%.

Nr. i konsumatorëve- Në vitin 2021 krahasuar me numrin e konsumatorëve në vitin 2020 ka rezultuar me rritje prej 1,965 ndërsa krahasuar me BP 2021 numri i konsumatorëve ka rënë prej 1,267 konsumator nga mos parashikimi i saktë i tyre.

Parat e gatshme në bankë dhe në arkë- Me 31.12.2021 paraja ka qenë 1,483,039 euro. Kategoria e parasë janë mjetet vetanake dhe ato nga donatorët për Impiantin e Ujërave të Zeza.

3.5.3 Çfarë ndryshime janë paraqitur gjatë aktiviteteve, operimeve dhe ambientit të cilën e rrethon ndërmarrjen që nga përgatitja e planit të biznesit. Si do të ndikojnë këto ndryshime (nëse ka) në arritjen e objektivave të planit të biznesit

Gjatë aktiviteteve, operimeve menaxhmenti i Kompanisë synon të realizon objektivat e Planit të Biznesit si dhe të përmirësoi edhe më tej performancën e Kompanisë në rritjen e të hyrave të Kompanisë si bazë themelore e krijimit të mundësive financiare të vetë ekzistimit dhe të investimeve kapitale përmes mjeteve vetanake. Në këtë rrugëtim gjatë aktiviteteve drejt realizimit të PB janë paraqitur disa ndryshime, si ; Është paraqitur nevoja që përsëri të vazhdojë me hapjen e portoarkave në disa lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve; Funksionimin e detektorëve si dhe trajnimi i stafit në këtë drejtim për aftësimin e tyre në përdorimin e aparaturës (detektorëve) si dhe përdorimi i të njëjtave në teren; Matjet komerciale përmes leximit të dhënave komulative të ujëmatësve kryesor dhe shtëpiak në mënyrën elektronike përmes datalogerëve ; Përmes organizimit të ekipeve shpesh është arritur të bëhet identifikimi i humbjeve administrative dhe komerciale të ujit; si dhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë dhe permanent i institucioneve të pushtetit lokal të Komunave të cilat operon Kompania .

Me këto aktivitete është arritur që Kompania me mjete vetanake të siguroi që të ketë ndryshime në realizimin e Planit të Biznesit në ambientin që rrethon Kompaninë edhe në përmirësimin e kushteve të punës për punëtorët në kompani. Është arritur plotësimi i kushteve të punëtorëve realizuar një hapësirë më e madhe e punës një pastërti dhe komoditet në është arritur një efikasitet më i madh i punës si në aspektin kualitativ dhe kuantitativ si dhe kushte më të mira të punës realizimin e një hapësire më të madhe të punës për punëtorët si dhe është ofruar një përkujdesje dhe ndihmë në drejtim të realizimit të sigurimit shëndetësor.

3.6. SHPENZIMET KAPITALE DHE TË PROJEKTEVE

Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2021

KRU "Gjakova" Sh.A. gjatë vitit 2021, ka bërë investime të shumta bazuar në planin e tij zhvillimor. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2021, janë realizuar me rregull dhe sipas afateve siç janë përcaktuar në Planin e Biznesit dhe në planin individual të Sektorit për Zhvillim dhe Projekte investive. Më poshtë janë përmendur projektet investive dhe burimet e financimit të projekteve në mënyrë të përgjithësuar, ndërsa statusi i tyre dhe detajet janë pjesë e këtij raporti. Gjatë vitit 2021 Kompania ka investuar në projektet e paraqitura në vijim nga mjetet e realizuara nga; donatorët, mjetet vetanake, dhe nga donacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KRU Gjakova, në muajin Gusht të vitit 2021, ka bërë instalimin e ujësjellësit për fshatrat e Hasit të Prizrenit.

Një tjetër projekt i rëndësishëm që ka filluar gjatë vitit 2021 është edhe ndërrimi i gypit nga AC më PE për fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol, i cili është financuar nga ME.

Gjithashtu vlen të theksohet se është punuar me intensitet të lartë për investimin shumë të rëndësishëm: Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Gjakovë, i cili pritet të përfundojë në gjysmën e parë të vitit 2022.

Investimet nga donacionet e KFW, Qeverisë , Komunave dhe vetanake për vitin 2021

Emri i Projektit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i kontraktuar	Dëshmi mbi punimet e realizuara
Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Hasit të Prizrenit – faza 1	Bashkëfinancim me Komunën e Prizrenit (51 %*49%). Vlera financiare: 266,796.70 €	FIDANI-BETON SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K., Arben Qerimaj, Nr 180, Baballoq/ Deçan	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 27.08.2021
Mbulimi i gypave DN 250mm që furnizojnë me ujë të pijes 34 fshatrat e Rekës së keqe afër kaptazhës	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 14,493.50 €	"V – SHEHU" SH.P.K., Junik, Junik	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 09.11.2021
Asfaltimi i rrugës nga rruga kryesore deri te rezervuari në Batushë dhe objekti administrativ, L=900m.	Bashkëfinancim me Komunën e Gjakovës (51% *49%) Vlera financiare: 47,981.00 €	"Euroasphalt" SH.P.K., Skënderbeu, Gjakovë	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 28.09.2021
Rrethoja e objekteve (trafos dhe stacionit të pompave) në Sopot	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 16,093.54 €	N.SH.T. VIKTORY COM, Rr. Tirana, Gjakovë	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Rrethoja e parcellës te Diga (në mes të rrugës dhe gjelbërimit) te Liqeni - Ritenderim	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 9,288.00 €	"Eko Term " SH.P.K., Brigada 123 pn, Suharekë	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit: 350,000.00 €, dhe KRU "Gjakova": 106,397.61 € Vlera totale: 456,397.61€	Lulzim Beqiraj B.I.: FIDANI-BETON SH.P.K., Rr. Arben Qerimaj, Nr 180, Deçan	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Vazhdim nga 2018-2021: WC1:Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, tenderi nr. KFW/BMZ201365501/ Gjakovë PH – III / WC-1" WC2:Impianti dhe dizajni-ndërtimi i ITUN Gjakova bazuar ne Librin e Verdhe të FIDIC-ut (Federata ndërkombëtare e inxhinierëve te Ndërtimtarisë) Nr. Tenderit: KFW (Banka Gjermane për Zhvillim) /BMZ 2013 65-501/Gjakova/PH-II/WC2	Kontrata WC 1 (Work contract -kontrat pune), Kontrata bazë: 3,695,933.26€ Kontrata WC 2 (Work contract -kontrat pune), Kontrata bazë: 7,270,630.51€ Total 1&2 =10,966,563.77 €	WC 1. Kontraktori: Kosova Water & Energy sh.p.k WC 2. Kontraktori: PASSAVANT WC 02	Punët gjinden ne vazhdim e sipër dhe priten të përfundojnë në tremujorin e parë 2022
Gjithsejtë: 11,729,633.12 €, të vete financuara nga KRU Gjakova: 550,248.14 €			

Të gjitha projektet janë kryer brenda afatit optimal, kurse Komisioni i BtD për projekte kapitale ka përcjell statusin e projekteve gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2021.

Lista e investimeve kapitale

Gjatë vitit 2021 në KRU "Gjakova" janë bërë investime të konsiderueshme në rrjetin e ujësjellësit në Gjakovë dhe dy Njësit tjera në Rahovec dhe Prizren, si nga ana e Kompanisë ashtu edhe nga ana e Komunave. Në kuadër të përmirësimit të furnizimit të qytetarëve me ujë ,rritjes së konsumatorëve ,zhvillimit të infrastrukturës ujore ,kanalizimit ,te infrastrukturës së objekteve ,mirëqenies së punëtorëve etj. Kompania ka bërë disa investime në rrjetin e ujësjellësit sidomos në zgjerimin e zonës së shërbimit dhe në rritjen e presionit në rrjetin e ujësjellësit . Në vazhdim po paraqesim investimet e realizuara nga ana e Kompanisë që kanë të bëjnë me implementimin e projekteve :

Tabela - Lista e investimeve kapitale -2021

Objektet ndërtimore	Euro
Lista – OBJEKTET NDERTIMORE	
Asfaliti në objektin e ri administrativ në Rekë të Keqe	39,993
Investime te ndryshme ne Objekte Administrative	2,670
TOTALI OBJEKTET NDERTIMORE	42,663
Lista – RRJETI I UJËSJELLËSIT	
Investime ne Rrjetin e Ujësllësit-Brekoci, lagjja e Jetishëve	35,925
Investime ne Rrjetin e Ujësllësit-fshati Morinë	8,329
Investime ne Rrjetin e Ujësllësit-fshati Cermjan	1,261
Investime ne Rrjetin e Ujësllësit-fshati Zhdrell	3,745
Investimet tjera ne ujësllës sipas nevojave në teren	143,413
TOTALI I RRJETIT TE UJSJELLESIT	192,673
Lista – UJMATESIT	
Instalimi i ujëmatësve tek konsumatorët e ndryshëm	17,784
TOTALI UJMATESIT	17,784
Pajisje elektro mekanike-inv. në stacionet e pompave	11,568
TOTALI PAISJET ELEKTRO MEKANIKE	11,568
Furnizim me paisje kompjuterike për nevojat e Kompanisë	37,578
TOTALI I PAISJEVE IT	37,578
Lista - MOBILJE DHE PAISJE PËR ZYRE	
Pajisje për zyre	3,745
TOTALI I MOBILJEVE DHE PAISJEVE PËR ZYRE	3,745
Investimet ne vijim-ITUN	0
Investimet ne vijim-Donacion për Impiantin e Ujerave te Zeza	465,313
Investimet ne Vijim-Ujesjellesi i fshtarave të Hasit	226,098
Investimet ne Vijim-Ujësllësi i fshtatrave në Xërxe, Gexhe, Radost	296,610
Investimet ne Vijim-Ujësllësi i Rekes së Keqe	12,282
TOTALI I INVESTIMEVE 2021	1,312,047

3.6.1 Komentet në progresin e projekteve kapitale të ndërmarrjes ,duke përfshi; Komente dhe vonesa administrative ,vonesa në prokurim, apo ndonjë ndryshim i kostove ne implementimin e projekteve .

Në realizimin e projekteve kapitale gjatë vitit 2021 Ndërmarrja ka treguar një progres të dukshëm. Projektet e planifikuara për vitin 2021 themi se pothuajse në tërësi janë realizuar ku në këtë realizim ka ndikuar rritja e të hyrave si rezultat i rritjes së arkëtimit si dhe të hyrave tjera . Projektet

kapitale janë implementuar një pjesë nga mjetet tona vetanake, Grandet e aksionarit –Qeverisë së Kosovës, CDI, si dhe komunat e Regjionit që furnizon Kompania. Sa i përket procedurës së implementimit (vonesa administrative, vonesa në prokurim apo ndonjë ndryshim tjetër i kostove gjatë vitit 2021 mund të themi se të gjitha projektet janë realizuar pa ndonjë ngecje të qenësishme që do të pengonte realizimin e këtyre projekteve kapitale.

Projektet e investuara nga mjetet donacionet e Qeverisë së Kosovës – mund të themi se procedurat administrative dhe të prokurimit si dhe kostove të shpenzimeve janë realizuar në tërësi. Falënderuar stafit të prokurimit KRU-ja ka arritur që për vitin 2021 ti realizoi 100% të mjeteve nga donacionet e ndara për Kompaninë.

3.7 PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHEM

3.7.1 Te paraqitet një skicë gjithëpërfshirëse e planit të biznesit për vitin e ardhshëm dhe të identifikohen objektivat kryesore;

Plani i Biznesit 2022-2024 definon çart orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe definon çartë objektivat dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake. Plani është përgatitur duke pasqyruar gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendet e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë për të adaptuar praktikën më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë.

Por gjithashtu është marrë për bazë edhe ambienti ekonomik dhe social në regjionin tonë.

Plani i Biznesit 2022-2024, definon rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojnë me një arritje të vet qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë. Parametrat operativ dhe financiar janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme duke lënë mundësinë e tejkalimit të tyre –uljen e tyre pa e dëmtuar funksionimin dhe ofrimin sa më cilësor të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të jenë sa më lartë realitetit dhe parametrave të arritshëm.

Plani është i orientuar fuqishëm në drejtim të mundësive vetanake financiare dhe të donatorëve ku realizim i këtij plani e sidomos planit të investimeve është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga donatorët, institucionet qendrore dhe lokale.

Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky plan, në mënyrë që Kompania të arrijë një qëndrueshmëri financiare që të ofrojë shërbime cilësore për konsumatorët. Në vazhdim po i paraqesim në formë tabelore treguesit kryesor operativ dhe financiar të performancës.

Treguesit kryesor të performancës		Caqet e realizuara 2020	Caqet e realizuara 2021	Caqet e planifikuara BP 2022
	Uji i prodhuar në m3	15,202,835	15,910,071	16,433,975
	Uji i faturuar në m3	8,856,057	9,167,666	9,868,620
	Konsumatorë të regjistruar	41,851	43,816	45,620
	Nr. i faturave të lëshuara	41,851	43,816	45,620
	Nr. i kons. që faturohen sipas leximit të Ujm.	41,713	43,704	45,164
	Uji i faturuar për kons. me ujëmatës	8,756,726	9,103,113	9,769,934
	Faturimi në Euro	4,370,218	4,662,378	5,039,213
	Arketimi në Euro	4,164,967	4,816,922	4,686,468

Te hyrat tjera operative ne Euro	78,385	113,953	75,911
Shpenzimet operative	3,744,120	3,685,225	4,727,875
Shlyerja e borxheve ndaj kons.	0	0	0
Shlyerja e obligimeve nga kreditorët	0	0	0
Parat e gatshme në bankë dhe në arkë	416,808	1,483,039	681,240
Stoqet	713,756	662,614	705,185
Llogarit e arketueshme Euro	11,129,149	10,024,368	10,892,839
Llogarit e pagueshme	17,104,676	16,920,719	16,184,274
Numri i punëtoreve	287	293	310
Numri i ankesave	427	324	310
Numri total i testeve të realizuara	2,618	2,882	4,210
Matja e treguesve ne %			
Uji i pa faturuar	42%	42%	41%
Përqindja e faturimit	100%	100%	100%
Përqindja e konsumit të matur	99%	99%	99%
Proporcioni i kons. Me ujëmatës	100%	100%	99%
Efikasiteti i stafit	6.86	6.69	6.80
Shkalla e inkasimit në % (të tërë)	95%	103%	93%
Shkalla e inkasimit në % - amvisni	93%	107%	97%
Shkalla e inkasimit në % - biznese	93%	101%	94%
Shkalla e inkasimit në % - industri	113%	84%	87%
Norma e mbulesës së punës	1.14	1.34	1.01
Norma e punës	1.20	1.30	1.08
Shpenzimet Operative për konsumator	7.40	7.01	8.64

Uji i faturuar për konsumatorët me ujëmatës në vitin 2022 planifikohet të jetë 99 % e ujit total të faturuar.

Faturimi në € - për vitin 2022 planifikohet të jetë 5,069,213 € në vlerë totale. Pjesa më e madhe i faturimit Amvisërisë si kategori më e madhe e konsumatorëve pastaj Biznesi i Madh dhe i Vogël dhe Institucionet.

Arkëtimi i tërë dhe për kategori të konsumatorëve në Euro ,%, m3 - Prioritet i lartë dhe objektiv i parë strategjik i Kompanisë do të jetë rritja e Shkalles së Arkëtimit. Në vitin 2022 shkalla e Arkëtimit në vlerë totale do të jetë 4,686,468€, 93 % e vlerës së faturuar. Biznesi i vitit 2022 është më ilet se viti 2021, pasi në vitin 2021 kemi arkëtuar borxhe të vjetra të vitit pandemik 2020. Shkallët e tjera të arkëtimit për vitin 2022 janë këto: amvisësia 97%, bizneset 94% dhe institucionet 87%.

Shpenzimet e përgjithshme operative dhe të mirëmbajtjes në vitin 2022 do të orientohen në funksionimin normal të Kompanisë dhe të gjitha njësive për qëllim të arritjes së synimeve dhe objektivave të përcaktuara si prioritete. Këto shpenzime si të tilla mundësojnë përmbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal të Kompanisë. Në vitet 2022 Shpenzimet Operative planifikohen të jenë në vlerë të prej 4,727,875 €, për 1,042,650€ më të larta se viti 2021.

Parashikimi i kërkesës për ujë Parashikimet e kërkesave për ujë për vitet e planifikuara do të jetë i bazuar në rritje në numrit të konsumatorëve ,në zvogëlimin e humbjeve si dhe në zgjerimin e rrjetave sipas planifikimit afatmesëm për investimet e projekteve kapitale. Parashikimet mujore të prodhimit do të bazohen në prodhimin e vitit 2021.

Investimet kapitale nga Grandet Qeveritare dhe mjetet e KRU-së për vitin 2021

Në bazë të projekteve të mëhershme dhe të projekteve aktuale ideore, si të domosdoshme për përmbushjen e nevojave, blerjen e pajisjeve/mekanismave dhe ndërtimin e objekteve të nevojshme ndërtimore, në vazhdim po i paraqesim projektet domosdoshme të cilat nevojiten për realizimin e planit afatmesëm të investimeve, dhe të cilat njëherit nga pamundësia financiare

ne presim që ndonjëra të mund të financohet nga jashtë ose në formë donacioni.

Po bëjmë ndarjen e Investimeve totale 2021 sipas kërkesës së ARRU-s në infrastrukture dhe jo infrastrukture, si më poshtë:

<i>Investimet kapitale për përmirësime infrastrukture dhe jo infrastrukture - 2021:</i>		
1.	Investimet jo infrastrukture	584,384
2.	Investimet infrastrukture	727,663
	TOTALI	1,312,047

Objektivat kryesore

Plani i Biznesit përfshinë synimet afariste të Kompanisë gjatë periudhës 2022-2024 dhe përveç tjerash vlerësohet se do të përmirësoj kontrollin menaxherial mbi Kompaninë dhe shmangien ndaj gabimeve që mund të sjellin atë në dështim të përmbushjes së standardeve të shërbimeve. Plani i Biznesit do ti nënshtrohet rishikimit dhe freskimit në baza vjetore.

KRU "Gjakova" SH.A furnizon me ujë të pijes 43,816 konsumatorë. Synohet që gjer në mbarim të vitit 2022 KRU-ja të zgjeron zonën e shërbimit dhe të rris numrin e konsumatorëve në 45,620.

Gjatë kësaj periudhe KRU "Gjakova" do vazhdoj të furnizoi konsumatorët e vet me ujë 24 orë .

Krahas përmirësimit të shërbimeve të ofruara Kompania synon që gjatë kësaj periudhe të përmirësoi afarizmin ekonomik dhe atë : Duke shtuar përpjekjet në ngritjen e shkallës së arkëtimit në 93% në vitin 2022 . Të shtoi masat e kontrollit të ujit të prodhuar i cili iu shpërndahet konsumatorëve dhe me këtë të ndikoi në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit ,gjegjësisht të ujit që nuk faturohet dhe Kompanisë nuk i sjellë të ardhura .Uji i pa faturuar në 2022 pritët të ulet në 41 %

Realizimi i këtyre të synimeve do ti mundëson Kompanisë gjenerimin e të ardhurave të mjaftueshme për të qenë vetë financues i qëndrueshëm dhe do ti rrisë aftësitë financiare të Kompanisë për mbulimin e pjesërishëm të investimeve të parapara në periudhën planifikuese.

Kontrolli dhe evitimi i humbjeve teknike dhe komerciale si dhe me mbikqyerjen e shpenzimeve të përgjithshme të Kompanisë, planifikohet një zvogëlim i shpenzimeve operative .

Krahas ngritjes së kapaciteteve teknike të Kompanisë, rëndësi e veçante do ti kushtohet ngritjes së aftësive profesionale të stafit, dhe për këtë menaxhmenti do identifikoi lëmit adekuate për trajnim të stafit .

Për realizimin e qëllimeve kryesore strategjike, deri në fund të vitin 2022 Kompania ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike si vijon:

Për realizimin e qëllimeve kryesore strategjike, deri në fund të vitin 2022 Kompania ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike si vijon:

- 1. Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë ;** Këto aktivitete do të përfshijnë identifikimin e humbjeve teknike dhe administrative të sasisë së ujit të prodhuar, gjegjësisht të ujit i cili nuk faturohet dhe nuk i sjell Kompanisë të ardhura. Uji i pa faturuar planifikohet të ulet në 40% deri në fund të vitit 2022.
- 2. Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime;** janë pjesë e planit të biznesit e të cilat planifikohen që të realizohen me mjete vetanake të Ndërmarrjes si dhe me mjete nga donacionet nga Qeveria e Kosovës .
- 3. Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit –** profili i të cilëve ka qenë i pamjaftueshëm për nevojat e konsumatorëve, të cilat janë punuar nga materiale jo adekuate ose në ato gypa janë defektet e përsëritshme (sidomos gypat AC);
- 4. Përmirësimi i funksionimit të sistemit;** Ngritja e nivelit të sigurisë punuese të sistemit të

furnizimit me ujë, domosdoshmëria e pajisjeve të reja elektrike, mjetet e reja pune etj.

5. **Projektet e planifikuara që të realizohen gjatë vitit 2022**, me ndihmën e donatorëve, bashkëfinancim nga Komuna dhe vetë financim nga KRU Gjakova

Investimet planifikohen të realizohen nga investimet vetanake, bashkëfinancim nga komunat dhe donatorët.

Investimet e planifikuara në sistemin e furnizimit me ujë janë ndarë në 4 nënkategori:

- (i) investimet në burimet e reja të ujit,
- (ii) investimet në zgjerimin e sistemit të ujësjellësit,
- (iii) investimet në rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit dhe
- (iv) investimet në matje dhe automatizim.

Investimet e planifikuara në sistemin e kanalizimit janë ndarë në 3 nënkategori:

- (i) mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit,
- (ii) investimet në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit dhe
- (iii) investimet në trajtimin e ujërave të ndotura të kanalizimit.

Sigurisht që parametri kryesor që influencon planifikimin e investimeve është shtimi i kërkesës për ujë që vjen si rezultat i dy elementëve: (i) shtimit natyror të popullsisë dhe (ii) rritjes së shkallës së mbulueshmërisë me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, me qëllim të shtrirjes së shërbimeve në tërë zonën e shërbimit.

Realizimi i Investimeve të poshtëshënuara, do të varet nga gadishmëria e Komunave dhe Donatorëve për Investime.

Ne vazhdim po paraqesim projektet të cilat planifikojmë ti realizojmë gjatë vitit 2022 në ujësjellës:

Nr.	Përmirësime infrastrukturore /ujë	2022			
		KRU Gjakova	Buxheti i Komunës	Qeveria dhe Grantet e donatorëve	Totali nga KRU dhe grantet
1	Furnizimi -Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijes për të gjitha njësitë me pjesë më të mëdha se 2"(coll) dhe më të vogla se 2"(coll). Këtu hyjnë edhe Ujëmatësit e dimensioneve të mëdha dhe gypat për ndërrimin e rrjetit nëpër rrugët të cilat do të asfaltohen.	300,000.00			300,000.00
2	Ndërrimi i gypit në fshatin Ramajë L=1700m, gypa nga Ø63 -110 /10 bar.	15,300.00	14,700.00		30,000.00
3	Ndërrimi i gypit furnizues deri te St. Pompave, gypi shtytës dhe furnizues në drejtim të Stacioni i pompave "Dol" – Rezervuar "Lipovec" V=200m ³ , si dhe ekzekutimi i gypsjeve për furnizimin me ujë të pijes në lagjet e poshtme dhe lagja e epërme në Gërquinë /2 lote/	318,982.00	306472		625,454.00

4	Ndërrimi i gypit te qelikt nga dalja e tunelit deri te stacioni i filtrave L=770m Ø 1100 mm dhe gypi nga tuneli L=860m, për filtra DN α 700-1100mm			633,376.84	633,376.84
5	Ndërtimi i Stacionit të pompave shtytëse për fshatin Morinë			20,197.33	20,197.33
6	Renovimi i Objektit te pompave te Zhdrellës dhe furnizimi me pompa dhe pajisje përcjellëse			444,326.40	444,326.40
7	Ndërtimi i rezervarit komplet V=600m ³ , me gyp furnizues ne Rahovec dhe ndërrimi i gypit shtytës dhe shpërndarës dhe rehabilitimi i ujësjellësit ekzistues për Hoqe te Madhe si dhe furnizimi I fshatit Opterushë, Zoqisht dhe zona Industriale e Rahovecit /2 lote/			1,274,518.34	1,274,518.34
8	Ndërtimi i ujësjellësit ne lagjen e Firzës për 42 shtëpi	35,700.00	34,300.00		70,000.00
9	Ndërrimi i rrjetës shpërndarëse në fshatin Krusha e Madhe ne drejtim te Drini i Bardhë L= 900m, gypa nga Ø63 -75 /16 bar.	7,650.00	7,350.00		15,000.00
10	Instalime te rrjetit sekondar ne zonën e shërbimit me rastin e investimeve te reja	25,500.00	24,500.00		50,000.00
11	Rehabilitimi i furnizimit me ujë i fshatit Bratotin	5,100.00	4,900.00		10,000.00
12	Ndërrimi i gypit në Rahovec Rr,Tafil Zyberaj L=800 m Ø90	6,120.00	5,880.00		12,000.00
13	Ndërrimi i Gypit ne Rahovec Rr. Bekim Isma L= 300m Ø100	5,100.00	4,900.00		10,000.00
14	Ndërrimi i gypit në Rahovec Rr. Ali Sokoli L=365 m Ø160 dhe 90	9,180.00	8,820.00		18,000.00
15	Ndërrimi i gypit AC ne Rr. Mizaim Isma L=300m Ø300	15,300.00	14,700.00		30,000.00
16	Ndërrimi i rrjetit sekondar ne fshatin Morinë	20,000.00			20,000.00
17	Ndërtimi i gypsllësit Gjakova III nga fshati Lugbunar deri Osek Hile L=4450 m DN 400/10 bar			612,676.14	612,676.14
	Gjithsejtë:	763,932.00	426,522.00	2,985,095.05	4,175,549.05

Në fillim të vitit 2022, planifikohet fillimi i projektit: “Furnizim dhe montim me panele solare në rezervuarët në zonën e shërbimit dhe kartelave GSM” në vlerë 40,000.00€.

Ne vazhdim po paraqesim projektet te cilat planifikojmë ti realizojmë gjatë vitit 2022 në kanalizim:

Nr.	Përmirësime infrastrukture /Ujëra të ndotura/	2022			
		KRU Gjakova	Buxheti i Komunës	Qeveria dhe Grantet e donatorëve	Totali nga KRU dhe grantet
1	Montimi dhe sigurimi i kapakëve për puseta te kanalizimit fekal	40,000.00			40,000.00
2	Riparimi i kanalizimit fekal	15,000.00			15,000.00
3	Rivendosja e gypave të kanalizimit-Gjakovë	10,000.00			10,000.00
4	Rivendosja e gypave të kanalizimit – Rahovec	10,000.00			10,000.00
5	Blerja e pajisjeve për operim dhe mirëmbajtje për dy Njësit	15,000.00			15,000.00
6	Furnizimi me pjesët rezervë (harxhuese) për dy cisternat e kanalizimit	10,000.00			10,000.00
7	Furnizim me mjete pune për mirëmbajtjen e kanalizimit sipas standardeve	10,000.00			10,000.00
8	Furnizim me cisterne për kanalizim me sistem thithës dhe debllokus te kanalizimit me pajisje përcjellëse dhe rezervë			130,000.00	130,000.00
9	Rregullimi i kanalizimit në S.F	1,000.00			1,000.00
	Gjithsejtë:	111,000.00	0.00	130,000.00	241,000.00

3.7.2 Përmbledhje e arsytive për ndryshime te mundshme ne planin e biznesit nga viti paraprak .Çka duhet të jetë më ndryshe se Plani i Biznesit 2022

Ndryshimet e parashikuara nga Plani i Biznesit nga viti paraprak, arsyet për këto ndryshime i prezantojmë për secilin tregues kryesor si më poshtë;

Faturimi në euro- BP 2022 në krahasim me vitin 2021 planifikohet të jetë 5,039,213 €, për 376,835 € më i lart. Konsiderojmë se do arrihet rritja e këtij treguesi i cili është baza e zvogëlimit të humbjeve të ujit ,eliminimin e lidhjeve ilegale, paushallit si dhe rritjes së numrit të konsumatorëve .Këtë tregues Kompania do ta arrij ta realizoi sipas BP të planifikuar përmes stafit të organizuar të shitjes, grupeve të caktuara sipas 5 zonave , si dhe ndihmesës së institucioneve lokale të Komunave dhe autoriteteve Qendrore .

Uji i faturuar për konsumatorët me ujëmatës planifikohet të jetë 99% e ujit total të faturuar. Kompania përmes angazhimit të stafit të operatives do të arrij qe të bej vendosjen e ujëmatësve për konsumatorët e të gjithë kategorive .Këtë ndryshim të mundshëm nga BP i vitit paraprak kompania e mbështet në arsyetimin se është një ndër objektivat dhe synimet kryesore që të

eliminohen faturimi i konsumatorëve përmes paushallit ,sepse është e njohur se me këtë veprim zvogëlohen humbjet e ujit tek Kompania ndërsa te konsumatori bëhet një vlerësim real i shpenzimit të shërbimit të ujit.

Arkëtimi i tërë në Euro dhe % – Bazuar në BP që në vitin 2022 Arkëtimi në vlerë totale do të jetë 4,686,468€ , 93 % e vlerës së faturuar. Bazohet në arsyetimin se Kompania si Ndërmarrje vetë financuese ku të ardhurat i siguron vetëm nga arkëtimi do të gjej metodat, programet më të avancuara që maksimalisht të arrij shkallen më të lartë të mundshme të arkëtimit përmes : Organizimit të Grupeve të Kontrolles dhe shkyçjes, përcaktimin e grupeve sipas 5 zonave, rritjen e numrit të pikave të shitjes në tërë regjionin që operon Kompania, zonave për arkëtim dhe humbje të ujit, eliminimit të keqpërdorimit të ujit, ri programimet e borxheve me te gjitha kategoritë e konsumatorëve, eliminimit të humbjeve teknike, bashkëpunimit me palët e treta , Policinë, Inspektorët Komunal si dhe autoritet gjyqësore. Këtë shkallë të arkëtimit menaxhmenti do ta rishikoj BP 2021 në Korrik, nëse do të ketë ndikim Pandemia me Covid 19.

Shpenzimet Operative – Shpenzimet operative për vitin 2022 sipas BP do të jenë 4,727,875 euro për 1,042,650 € më të larta se viti 2021. Shkaku i këtij ndryshimi në planifikimin e BP është se Kompania po përballlet me dukurit ; bashkëfinancimi nga buxheti i Kompanisë ne realizimin e Projekteve të mëdha, ndërtimi me mjete vetanake të infrastrukturës ujore , infrastrukturës rrugore , ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë, Rritjen e inflacionit, rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike, kemikaleve, karburanteve te naftës, mirëmbajtja e pajisjeve dhe rrjetës. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përfshijnë shpenzimet e personelit (përfshin pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet), shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve (përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj.), shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e derivateve (përfshin naftën dhe benzinës për Kompaninë), shpenzimet e kemikaleve (përfshin alumin sulfatin, klor i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, taksat për licencim të shërbimeve ARRU, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta).

Gjatë vitit 2022 Kompania parasheh ti paguajë të gjitha shpenzimet operative për zhvillimin normal të veprimtarisë së vet normale.

Shpezimet të cilat kanë ngritje janë: kemikalet për 178,350 €, pagat per punëtorët e ri te ITUN-it 182,233€, rryma elektrike 17,736€ dhe shpenzimet tjera 663,513€.

Nr. i Konsumatorëve- për vitin 2022 janë parashikuar të rriten 1,804 konsumatorë duke u bazuar nga rritjet e viteve të Kaluara. Kompania do të bëjë evidentimin në sistem të konsumatorëve të cilët furnizohen në mënyrë të pa legalizuar, do ekzekutoj dënime administrative si dhe gjoba për konsumatorët e pa ndërgjegjshëm që keqpërdorin ujin. Ndërtimi i Fabrikës së dytë të ujit të pijes do të mundësohet që të rritet numri i konsumatorëve në masë të madhe sepse Kompania do të ketë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e shërbimeve të veta .

Prodhimi i ujit të pijes - Prodhimi i ujit për vitin 2022 është planifikuar të jetë 16,433,975 m³, për 523,904 m³ më shumë i vitit 2021 si nevojë dhe mundësi e rritjes se numrit të konsumatorëve për shkak të rritjeve të kapacitetit të ujit për shkak të ndërtimit të Fabrikës së dytë me kapacitet shtesë 500 m³.

Programet e testimit të ujit të pijshëm- Përmirësimi i cilësisë së ujittë pijshëm, ne laboratorët tona, si në atë për analizat fiziko- kimike dhe atë bakteriologjike, të përdorim disa programe të testimit të cilësisë së ujit, si p.sh. Programi i analizës volume tri kë pH-metrisë, konduktometrisë, fotometrisë etj.

Ristrukturimi organizativ – Radhitja e personelit për mes departamenteve në favor të produktivitetit të përgjithshëm, duke ngritur ato në vazhdimësi për mes përgatitjes dhe të përshtatjes profesionale; Pozicionimin dhe vërtetimin e pozitave të pa sistematizuara deri më tani dhe, sipas nevojës për pozitë e punëve të domosdoshme; Te bëhet planifikimi i mundësisë së kualifikimit të vazhdueshëm të personelit përmes shkollimit.

Zbatimi i kompjuterizimit të gjerë të kompanisë; Blerja e kompjuterëve në mënyrë të njëtrajtshme ,ku me këtë do të ruhej uniformi teti performancës së tërë sistemit dhe do të ulëshin shpenzimet e mirëmbajtjes ,implementimi I Intranetit të kompanisë I cili do te rrit efikasitetin e administratës, do të zvogëlonte shpenzimet administrative si dhe do të mundtë kontrollohej performanca e shërbyesve administrativ të kompanisë duke përcjellë azhuriteti ne administratës.

Sistemet të reja të menaxhimit të informacionit dhe të raporteve-Monitorimi i dhënie-marrjes së informatave mbi performancën e sistemit dhe verifikimin e furnizimit të konsumatorëve me ujë cilësor. Këto përfshijnë testimin e monitorimit analitik dhe vëzhgimor sikurse që janë inspektimet si dhe testimin Mbi Kënaqësinë e konsumatorit .

Programe të zhvillimit të burimeve njerëzore-Trajnimi i Resurseve që aktiviteti i tyre në kompanitë bëhet komfor konkurrencës së tregut, e që do ti shërbejë veprimtarisë kryesore të punëve tona shërbyese, për kualitetin dhe distribuimin e ujit të pijes dhe që me këtë të arrihet përmbushja e kërkesave dhe nevojave ndaj konsumatorëve tanë;

Marrëdhëniet ndërmjet konsumatorit dhe Kompanisë sonë –Obligimin dhe angazhimi ne mirëmbajtjes sipas standardeve minimale të shërbimit; Nevoja për vlerësime dhe reagime të përgjegjshme ndaj nevojave të konsumatorëve Përgjegjësi dhe në përputhje me rregullat në fuqi; Përdorimet i ligjeve aktuale në fuqi dhe kompetencave në furnizim me shërbime; dhe obligimetnëpërkrahjetëarritjevetekniko-teknologjikenëaplikiminepraktikavetëkohës

Informimi i konsumatorëve-Planifikimi afatgjatë i programeve komunikuese sistematike. Kjo do të siguronte të gjithë ata konsumatorë të cilët kanë qasje në informacione nga keqinterpretuesit e zëshëm.

3.8. RREZIQET E TË ARDHMES SË KORPORATES

Rreziqet kryesore qe ndërmarrja do te ballafaqohet gjatë dy viteve të ardhshme

Meqë ndikimet që vijnë nga jashtë ,respektivisht nga rrethina afariste ,janë implikimet e tij në veprimtarinë e Kompanisë, janë analizuar dhe identifikuar disa nga rreziqet e mundshme që janë dhënë në vazhdim;

- Rritja e çmimeve të të gjitha furnizimeve sikur rryma, klori, derivatet, materiali i rrjetit etj
- Rritja e nivelit te furnizimit të rajoneve me pompa
- Ndryshimet e mundshme klimatike siç është ngrohja globale që po ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e resurseve ujore në përgjithësi .
- Rritja e keqpërdorimeve të konsumit të ujit të pijes
- Avarit në pajisjet dhe stabilimentet e rëndësishë së lartë dhe dëmtimet mekanike, ndërprerjet etej zgjatura të furnizimit me shërbime s pasojë e fuqisë mbi natyrore;
- Ndikimet ekstreme të motit dhe katastrofave natyrore (erërat,zjarri,vërshimet,tërmetet,
- Vandalizmat dhe sabotimet;
- Si dhe Ndikimi i ndotjeve të papritura (hedhjet e kimikaleve mbi dhe në kaptash ose në resurset ujore, neglizhenca në proceset e përpunimit të ujit,etj.)

Komentoni ne secilin rrezik qe mund te paraqitet gjatë operimit te ndërmarrjes

- Kërcënimet financiare, paraqesin rrezik të veçantë dhe reflektojnë në shkaktimin e vështirësive të hyrave të pamjaftueshme të cilat pamundësojnë investimet kapitale .
- Një rrezik që duhet pasur parasysh me të cilën po ballafaqohet një pjesë e madhe e botës është edhe kriza globale , që ndikojnë në kapacitet financiar të partnereve afarist si dhe përkeqësimin e gjendjes ekonomike të konsumatorëve që reflekton në zvogëlimin e mundësisë së tyre për pagesën e faturave të shërbimeve për shkaqe të gjendjes së tyre ekonomike .
- Moslejimi i ngritjes së tarifave në përputhje me shpenzimet për zhvillimin e veprimtarisë së Kompanisë është faktor ndikues gjegjësisht që paraqet rrezik potencial për të hyrat e kompanisë.
- Kërcënim të veçante paraqesin edhe ndryshimet e mundshme klimatike siç është ngrohja globale që po ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e resurseve ujore në përgjithësi .
- Rritja e keqpërdorimeve të konsumit të ujit të pijes si pasojë e mos funksionimit në masë të duhur të organeve të rendit dhe Gjykatave
- Avarit në pajisjet dhe stabilimentet e rëndësishme të lartë dhe dëmtimet mekanike, Ndërprerjet etj. zgjatur atë furnizimit me shërbime si pasojë e fuqisë mbinatyrore
- Ndikimi i ndotjeve të papritura(hedhjet e kimikaleve mbi dhe në kaptash ose në resurset ujore, neglizhenca në proceset e përpunimit të ujit,etj.)
- Ndikimet ekstreme të motit dhe katastrofave natyrore (erërat,zjarri,vërshimet, tërmetet,Vandalizmat dhe sabotimet;
- Rritja e kostos së jetesës së konsumatorëve ,si shkak i rritjes së çmimeve –inflacionit ,për këtë do të kemi vështirësi në arkëtimin e borxheve të konsumatorëve të cilëve do ju rriten shpenzimet jetësore , e që do të ndikoi në pa mundësin e tyre në kryerjen e detyrimeve të ndaj Kompanisë për shërbimet e pranuar;
- Furnizimi me klor të gazët, ku çmimet për momentin janë të pa përballueshme për kompaninë.

3.8.2 Çfarë duhet të behet për të ulur ndikimin e secilit rrezik.

Që të ulim ndikimin e secilit rrezik që na përcillet ne veprimtarinë tonë , kërkohet që të ndërmerren veprimet ;

Vazhdimi i aktivitetit rreth evitimit të pengesave gjatë zhvillimit të aktiviteteve në Kompani ;

Thellimin i dijeve përbrenda kompanisë mbi procedurat e veprimeve operative; Ngritje në cilësi të shërbimeve tona, dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe standardin e punëtorëve tanë; Nevojën e implementimit të Programit për zvogëlimin e humbjeve dhe keqpërdorimeve të ujit, si njëra nga projektet zhvillimore për ndonjë donacion i mundshëm; Nevojat për rregulloret në pajtueshmëri të plotë me kërkesat legjislative; Vlerësimin e aktiviteteve afariste për KRU "Gjakova"ti planifikojmë në drejtim të lëvizjeve më pozitive ;Të rishikohen rregullisht për arritjet e praktikave më të mira të përvetësuar; Mënyrat më të mundshme të marrëveshjeve për furnizimin; Diskutimet paraprake mbi vendimet për zgjerimin e shërbimeve; Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit; Pajtueshmërinë e plotë ndaj kërkesave legjislative dhe rregullatorit Intervenime në defektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve;

Marrja e masave operative dhe juridike për eliminimin e rreziqeve të arkëtimit të hyrave –

Kosto ekonomike të furnizimit dhe shërbimeve; Caktimi i tarifave mbi shërbimet dhe mbi pagesat tjera; faturimi i obligimeve të konsumatorit për pagesën e shërbimeve ;Informimi i konsumatorëve; Shqyrtimi i ankesave ndaj shërbimeve; Diskutimet paraprake mbi vendimet për zgjerimin e shërbimeve ;Nevojat për rregulloret në pajtueshmëri të plotë me kërkesat legjislative; Rritjen e të hyrave dhe zvogëlimin e shpenzimeve ;Zvogëlimin e humbjeve të ujit në rrjetë, investime të

nevojshme e të ri kthyeshme (të sh pagueshme) ;Zvogëlimin e prodhimit të ujit pa dëmtuar konsumatorin ; Arritjen e objektivave operative me një çmim kushtues sa më të vogël; Furnizim për mirëmbajtje me një çmim sa më të arsyeshëm, me ujëmatës; Rritjen e sasisë së ujit të shitur, të faturuar ; Mbështetja në funksion të sektorit të shërbimeve për intervenime në defekte si dhe të mjeteve të punës .

Avancimi i operimit të rrjetit të ujit dhe të kanalizimit-Realizimi I projekteve përmes thithjes së donacioneve apo me mjete të Kompanisë për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit si dhe rrjetat e reja të kyçjes së Konsumatorëve të rij të një komuniteti ,nevojën për prodhim të ujit sa më cilësorë sipas kapaciteteve të instaluara, pajtueshmëri të plotë të resurseve në proceset e prodhimit me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të ujit ,ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza etj.

Implementimi eficient i investimeve kapitale të KRU-ve-Angazhimi maksimal I Sektorit për Planifikim dhe Zhvillim në hartimin e projekteve të planifikuara si dhe implementimi eficient i investimeve kapitale me theks të veçante nga mjetet donacionet e Qeverisë ;Angazhimi maksimal i Zyrës së Prokurimit në realizimin me kohë të procedurave për realizimin e tenderëve që me kohën optimal të arrihen të realizohen mjetet nga ekzekutimi I kontratave me operatorët ekonomik që mjetet të dhuruara nga Qeveria e Kosovës të mos kthehen në Buxhetin e Kosovës

Seanca takimesh dhe mbledhjesh më të shpeshta të menaxhmentit në KRU "Gjakova", Raportimet e rregullta për realizimin e Planeve dhe Programeve për masat dhe veprimet që duhet të merren nga çdo Menaxher në veprimtarinë e Departamentit që i përket për uljen e rreziqeve të mundshme që paraqiten gjatë ushtrimit të veprimtarisë në sferën e ; Përmirësimit dhe ngritjes së nivelit në përmbushjen e obligimeve ndaj konsumatorëve ;Informimi i konsumatorëve, shqyrtimi i ankesave ndaj shërbimeve ,prodhimit ,inkasimit, humbjeve të ujit ;Mirëmbajtjes së objekteve ,intervenimet emergjente në sanimin sa më të shpejt të avarive ,te shqyrtohen planet e intervenimeve emergjente në rastet e mundshme të fatkeqësive natyrore ,shkatërrimit të objekteve.

Përgjigje më kreative në rastet e reagimeve emergjente ;Të përpilohen Planet dhe programet në çdo fushë të veprimtarisë për intervenime emergjente komfor legjisllacionit në fuqi në Kosovë si dhe akteve të brendshme në Kompani ; Të bëhet informimi i saktë dhe i shpejt i popullatës për çdo reagim emergjent në të gjitha fushat e veprimtarisë , intervenime për shkyçje si rezultat i veprimeve të natyrave të ndryshme defekte ,avari të mundshme ,diversione ,sabotime ,kushte atmosferike ,shkyçje kolektive etj.

Përmirësimet në menaxhimin e aseteve; Të vazhdohet me procedura e legalizimit të gjitha aseteve të Kompanisë në emër të kompanisë si dhe vlerësimi i tyre në kontinuitet me rregullat financiare nga zyrtari i vlerësimit të aseteve ;Të bëhet inkorporimi në sistem i të gjitha aseteve si dhe arkivimi i dokumentacionit për asete .

RAPORTI I AUDITORIT TË BRENDSDHEM

Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon duke u mbështetur në kornizën ligjore dhe profesionale, në vlerat kryesore në përputhshmëri me ligjin dhe parimet e etikës profesionale: integritetin, objektivitetin, kujdesin e duhur profesional, konfidencialitetin dhe pavarësinë.

Aktivitetet e planifikuara dhe finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm kanë qenë në përputhje me qëllimet e ndërmarrjes, dhe kanë synuar lehtësimin e arritjes së këtyre qëllimeve nëpërmjet shërbimeve të sigurisë dhe shërbimeve konsultuese, duke ofruar siguri të arsyeshme ndaj menaxhmentit të lartë dhe Komitetit të Auditimit që kontrollet financiare dhe operacionale

të ndërmarrjes operojnë në mënyrë eficiente, efektive, ekonomike dhe etike; si dhe duke ofruar siguri të arsyeshme që sistemi i kontrollit të brendshëm është duke funksionuar siç pritet për zbulimin dhe korrigjimin me kohë të gabimeve për arritjen e objektivave.

Njësia për Auditim të Brendshëm në mënyrë sistematike ka vlerësuar shkallën deri në të cilën proceset / sistemet e ndërmarrjes për përkufizimin e qëllimeve, menaxhimin e rrezikut dhe kontrollit janë efektive, ka kryer analizimin dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së proceseve të ndërmarrjes me legjislacionin përkatës, verifikimin e afateve kohore dhe saktësinë e raporteve financiare, raporteve të tjera të punës, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre të cilat e ndihmojnë menaxhmentin për të kuptuar rreziqet e funksionimit të ndërmarrjes, si dhe të përmirësojnë procedurat e kontrollit dhe proceset në kuadër të ndërmarrjes. Duke ofruar siguri në lidhje me efektivitetin e ambientit të brendshëm të ndërmarrjes, si dhe duke propozuar mundësi të reja për përmirësimin e performancës së ndërmarrjes, Njësia për Auditim të Brendshëm ka dhënë një kontribut të vlefshëm në arritjen e objektivave të ndërmarrjes dhe në menaxhimin e rreziqeve. Zbatimi i rekomandimeve të cilat ipen nga Njësia e Auditimit të Brendshëm përgjatë një cikli të auditimit, si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Menaxhmentit të lartë dhe punonjësve në varësi të tyre mundëson që kontrolli i brendshëm dhe menaxhimi financiar të jenë në nivelin i cili siguron zbatimin e procedurave në përputhje me ligjet në fuqi, ndikon që niveli i performancës të ngritet në nivelin e kërkuar, paraja publike dhe pasuria publike të menaxhohet në mënyrë efikase dhe ekonomike; sigurimin e transparencës së plotë lidhur me të gjitha aktivitetet e kryera nga ndërmarrja, si dhe të ketë regjistrim dhe raportim të drejtë për të gjitha aktivitetet e zhvilluara në ndërmarrje.

Raporti Përmbledhës Vjetor i Njesisë për Auditim të Brendshëm paraqet aktivitetet e kryera përgjatë Vitit 2021 në lidhje me progresin e implementimit të strategjisë së auditimit, si dhe shkallën e realizimit të Planit Vjetor sipas shkallës së pajtueshmërisë me standardet profesionale, për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin legjislativ të parashikuar e me Standardet Ndërkombëtare të pranuar. Procesi i Auditimit të Brendshëm është kryer për çdo sistem të identifikuar për t'u audituar sipas përcaktimeve në Planin Strategjik dhe Planin Vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe Kryeshefi Ekzekutiv për vitin 2021. Në vitin 2021 kemi përmbyshur në tërësi Planin Vjetor të punës duke përfunduar:

➤ 7 Raporte lidhur me auditimet e kryera, i fundit është finalizuar në vitin 2022:

- Sistemi për Menaxhimin e Procedurave të Prokurimit
- Sistemi për Menaxhimin e Njesisë së Arkivës
- Sistemi për Menaxhimin e Autoparkut
- Sistemi për Menaxhimin e të Hyrave në Arkë dhe në Bankë
- Sistemi për Menaxhimin e Procedurave Ligjore
- Sistemi për Menaxhimin e Procedurave të Faturimit
- Sistemi për Menaxhimin e Mjeteve Themelore dhe Gjendjen e Stoqueve në Depo

➤ Raporti i - I – gjashtëmujor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën Janar deri Qershor 2021

- Planin Strategjik 2022 – 2024
- Planin Vjetor 2022
- Raportin Vjetor mbi Realizimin e Planit Vjetor për Vitin 2021.

Gjatë gjashtëmujorit të -I- dhe gjashtëmujorit -II- të vitit 2021, përveç angazhimeve në kuadër të realizimit në tërësi të aktiviteteve të Njesisë për Auditim të Brendshëm janë kryer punë dhe angazhime tjera më kërkesën e menaxhmentit dhe Komitetit të Auditimit për monitorimin e aktiviteteve dhe proceseve në kuadër të ndërmarrjes dhe konsulencë të ndryshme sipas nevojave ditore për të cilat nuk kemi lëshuar raporte. Në kuadër të aktiviteteve tjera të kryera nga Njësia për Auditim të Brendshëm, përfshihen:

- Hartimi i Raportit të Gjashtëmujorit të II lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën prej Korrik deri Dhjetor 2020;
- Hartimi i Raportit Vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për Vitin 2020;
- Vazhdimi i auditimit lidhur me “Sistemin për Menaxhimin e Procedurave të Faturimit”, deri në gjysmën e muajit Janar 2021
- Hartimi i Raportit mbi Auditimin e Jashtëzakonshëm - Analizimi i veprimeve që kanë shkaktuar dëmin financiar nga mos aplikimi i ngarkesës së kundërt për furnizimet e shërbimeve në lëmin e ndërtimit për periudhën Janar 2016 - Dhjetor 2017;
- Hartimi i pesë Raporteve nga NJAB për MEA për mbështetjen financiare të projektit kapital “Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Gexhë, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol”;
- Hartimi i Raportit nga NJAB për ME për mbështetjen financiare të projektit kapital “Trajtimi i ujërave të ndotura në Jug – Perëndim të Kosovës – Faza III, Gjakovë”;
- Dhënia e këshillave të shumta në formë verbale për të cilat shënimet janë mbajtur në fletore;
- Kontrollimi i faturave në baza javore;
- Hartimi i Raporteve Mujore lidhur me barazimin e arkave dhe bankave me regjistrimet në kontabilitet, që nga Shtatori i 2021-ës deri në Dhjetor të 2021-ës, si dhe kryerja e punëve tjera operative.

Rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm të pasqyruara tek të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna të raportuara përgjatë vitit në raportet finale të auditimit janë detajuar e analizuar përgjatë zhvillimit të auditimit dhe diskutimit të tyre me zyrtarët përgjegjës, menaxhmentin e lartë të ndërmarrjes dhe Komitetin e Auditimit. Dhënia e rekomandimeve të zbatueshme dhe që i shtojnë vlerë subjektit të audituar është pjesë shumë e rëndësishme e funksionit të auditimit të brendshëm, çka është dhe misioni i këtij funksioni. Arritja e këtij objekti përcaktohet, në një masë të madhe, nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve të prezantuara në Raportet Gjashtëmujore, por tregon gjithashtu përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit të ndërmarrjes mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve. Bashkëpunimi i mirëfilltë në mes menaxhmentit të ndërmarrjes dhe Njesisë për Auditim të Brendshëm ndikon që niveli i performancës të ngritet në nivelin e kërkuar, si dhe mundëson që të gjitha aktivitetet dhe proceset të zhvillohen në përputhshmëri të plotë me Kornizën Ligjore.

Aneksi 1.

1. SPONZORIMET DHE DONACIONET

Investimet kapitale gjatë vitit 2021 janë realizuar nga: Qeveria e Kosovës, Komunave: Gjakovë, Rahovec dhe Prizren si dhe mbi 306,809.28 €, nga mjetet vetanake të Kompanisë (kryesisht investime në rrjetin e Rekes së Keqe). Këto investime kanë qenë të planifikuara me Biznes Planin e vitit 2021.

Emri i Projektit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i kontraktuar	Dëshmi mbi punimet e realizuara
Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Hasit të Prizrenit – faza 1	Bashkëfinancim me Komunën e Prizrenit (51 %49%). Vlera financiare: 266,796.70 €	FIDANI-BETON SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K., Arben Qerimaj, Nr 180, Baballoq/ Deçan	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 27.08.2021
Mbulimi i gypave DN 250mm që furnizojnë me ujë të pijes 34 fshatrat e Rekës së keqe afër kaptazhës	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 14,493.50 €	"V – SHEHU" SH.P.K., Junik, Junik	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 09.11.2021
Asfaltimi i rrugës nga rruga kryesore deri te rezervuari në Batushë dhe objekti administrativ, L=900m.	Bashkëfinancim me Komunën e Gjakovës (51% *49%) Vlera financiare: 47,981.00 €	"Euroasphalt" SH.P.K., Skënderbeu, Gjakovë	Ekziston raporti i pranimit teknik Datë: 28.09.2021
Rrethoja e objekteve (trafos dhe stacionit të pompave) në Sopot	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 16,093.54 €	N.SH.T. VIKTORY COM, Rr. Tirana, Gjakovë	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Rrethoja e parcellës të Diga (në mes të rrugës dhe gjelbërimit) të Liqeni - Ritenderim	KRU "Gjakova" Vlera financiare: 9,288.00 €	"Eko Term " SH.P.K., Brigada 123 pn, Suharekë	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit: 350,000.00 €, dhe KRU "Gjakova": 106,397.61 € Vlera totale: 456,397.61€	Lulzim Beqiraj B.I.: FIDANI-BETON SH.P.K., Rr. Arben Qerimaj, Nr 180, Deçan	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe nuk është bërë pranimi teknik
Vazhdim nga 2018-2021: WC1:Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, tenderi nr. KFW/BMZ201365501/ Gjakovë PH – III / WC-1" WC2:Impianti dhe dizajni-ndërtimi i ITUN Gjakova bazuar në Librin e Verdhe të FIDIC-ut (Federata ndërkombëtare e inxhinierëve të Ndërtimtarisë) Nr. Tenderit: KFW (Banka Gjermane për Zhvillim) /BMZ	Kontrata WC 1 (Work contract -kontrat pune), Kontrata bazë: 3,695,933.26€ Kontrata WC 2 (Work contract -kontrat pune), Kontrata bazë: 7,270,630.51€ Total 1&2 =10,966,563.77 €	WC 1. Kontraktori: Kosova Water & Energy sh.p.k WC 2. Kontraktori: PASSAVANT WC 02	Punët gjinden në vazhdim e sipër dhe priten të përfundojnë në tremujorin e parë 2022

2013 65-501/Gjakova/PH-II/WC2			
Gjithsejtë: 11,729,633.12 €, të vete financuara nga KRU Gjakova: 550,248.14 €			

1. RAPORTIMET SIPAS LIGJIT MBI NDERMARRJET PUBLIKE

a.) STRUKTUARA ORGANIZATIVE AKTUALE E KRU"GJAKOVA "Sh.A.-GJAKOVË,DUKE PËRFSHIR TË GJITHA NDRYSHIMET E KONSIDERUESHME QË JANË BËRË GJATË VITIT PËRKATËS

Makro struktura e aprovuar me këto ndryshime ka ardhur si rezultat i kërkesave ligjore nga ligji mbi Ndërmarrjet Publike ,Ligji i Punesë , Ligji i Prokurimit Publik si dhe ligjet tjera në fuqi në Kosovë .Duke u bazuar në këtë ,ndryshimet do të ndikojnë në ngritjen e efikasitetit dhe performances së kompanisë në përgjithësi por edhe në performancën e individëve të caktuar në arritjen e objektivave të përcaktuara .Struktura organizative K.R.U."Gjakova" Sh.A.-Gjakovë e përbërë nga;

Bordi i Drejtorëve

Organ më i lartë për shkak të dorëheqjes së dy drejtorëve jo ekzekutiv përbëhet prej 6 drejtorë jo ekzekutiv dhe një drejtori ekzekutiv , si dhe Sekretarin e Bordit të Drejtorëve i cili ka pozitën e vëzhguesit pa të drejtë vendimmarrje.

Struktura Menaxhuese brenda në kompanis

Afarizmi i Kompanisë zhvillohet nga 3 Departamente .Në strukturën Organizative janë përfshirë edhe pozita e KE ,Zëvendës i KE Sekretari i Kompanisë ,Zyrtarit Kryesor Financiar si dhe zyrtarit për Auditim të brendshëm. Organizimi K.R.U. "Gjakova" Sh.A.-Gjakovë është i bazuar në afarizmin tekniko –operativ ku mbulohet me Departamentin Teknik Operativ. Afarizmi tjetër ka karakter; Projektues ,komercial, ligjor ,mardh me Kons. Personelit . Në përgjithësi veprimtaria e Kompanisë mbulohet nga ; Departamenti Financiar ,Departamenti i Shitjes ,Departamenti I Administratës së përgjithshme ,Departamenti i Personelit , Departamenti i IT –së , Departamenti I Operatives Teknike dhe i Prokurimit .

b.) SHQYRTIMI I PERFORMANCES AFARISTE FINANCIARE GJATË MUAJVE JANAR – DHJETORË 2021

Në vazhdim po paraqesim Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për periudhën Janar- Dhjetor 2021 të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë.

Pasqyra e Pozicionit Financiarë

Me 31 dhjetor		2021	2020
	<i>Shënime</i>		
PASURIA			
Pasuria Jo-qarkulluese			
Toka, Ndërtesa, Automjetet dhe Paisjet	8	42,165,877	43,685,995
Investimet në vijim	8	7,169,336	6,181,316
Total pasuria jo qarkulluse (I)		49,335,213	49,867,310
Pasuria qarkulluese			
Të arkëtushmet tregtare dhe tjera	9	6,333,117	7,083,487
Stoqet	10	662,929	714,479
Paraja dhe ekuivalentët e saj	11	1,483,119	416,808
Total pasuria qarkulluese (II)		8,479,166	8,214,774
Total Pasuria (I+II)		57,814,378	58,082,084
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali Aksionar	12	25,000	25,000
Fitimi (humbja) e mbajtur		(167,791)	(540,779)
Rezerva e Rivlerësimit		41,604,082	42,553,327
Total kapitali (III)		41,461,291	42,037,548
Detyrimet afatgjata			
Kreditë afatgjata		-	-
Total detyrimet afatgjata (IV)		-	-
Detyrimet afatshkurta			
Kreditë afatshkurta		-	-
Llogaritë e Pagueshme tregtare dhe tjera	13	306,960	1,107,812
Detyrime ndaj punëtorëve dhe tatime	14	62,715	36,511
Të hyrat e shtyra	15	15,983,412	14,900,213
Total detyrimet afatshkurta (V)		16,353,087	16,044,536
Total Detyrimet dhe Kapitali (III+IV+V)		57,814,378	58,082,084

Pasqyra e Fitimit dhe Humbjes			
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2021	2020
	<i>Shënime</i>		
Të hyrat			
Të hyrat	16	5,550,749	5,140,670
Gjithsej të hyrat		5,550,749	5,140,670
Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	17	(2,470,607)	(2,414,073)
Shpenzimet operative dhe administrative	18	(1,297,267)	(1,361,819)
Shpenzimet e Zhvlerësimit	8	(1,841,272)	(1,857,365)
Gjithsej shpenzimet		(5,609,146)	(5,633,257)
Fitimi (humbja) nga aktivitetet operative		(58,397)	(492,586)
Fitimi (humbja) financiare			
Shpenzimet Financiare		-	-
Gjithsej fitimi (humbja) financiare		-	-
Fitimi (humbja) para tatimit		(58,397)	(492,586)
Tatimi në fitim		-	-
Fitimi (humbja) neto e vitit		(58,397)	(492,586)
		(58,397.07)	(492,586.14)

Pasqyra e Ndrimeve në Ekuitet				
	Kapitali investus	Fitimi (humbja) e mbajtur	Rezerva të Rivleresimit	Gjithsej
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	25,000	(121,988)	31,573,655	31,476,667
Shtim	-	-	-	-
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	-	-	-
Fitimi (humbja) e vitit	-	140,493	-	140,493
Gjendja me 31 Dhjetor 2018	25,000	18,505	31,573,655	31,617,159
Shtim	-	-	-	-
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	(163,531)	180	(163,351)
Fitimi (humbja) e vitit	-	112,602	-	112,602
Gjendja me 31 Dhjetor 2019	25,000	(32,424)	31,573,835	31,566,411
Shtim	-	-	10,979,493	10,979,493
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	(15,769)	-	(15,769)
Fitimi (humbja) e vitit	-	(492,586)	-	(492,586)
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	25,000	(540,779)	42,553,327	42,037,548
Shtim	-	-	(2,871)	(2,871)
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	431,386	(946,375)	(514,989)
Fitimi (humbja) e vitit	-	(58,397)	-	(58,397)
Gjendja me 31 Dhjetor 2021	25,000	(167,791)	41,604,082	41,461,291

Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	2021	2020
--------------------------------------	------	------

I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative

Fitimi (humbja) e vitit	(58,397)	(492,586)
-------------------------	----------	-----------

Të korigjuara për:

Zhvierësimi	1,841,272	1,857,365
-------------	-----------	-----------

Provizionet e borxheve të keqja	79,247	31,743
---------------------------------	--------	--------

Rregullime në fitime të mbajtura	(514,989)	-
----------------------------------	-----------	---

(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	671,123	468,336
--	---------	---------

Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	(800,852)	(403,386)
--	-----------	-----------

Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet ndaj punëtorëve dhe tatimeve	26,204	(86,179)
--	--------	----------

Rritja/(zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	1,083,200	906,309
---	-----------	---------

(Rritja)/zvogëlimi në parapagime	-	-
----------------------------------	---	---

(Rritja)/zvogëlimi në stoke	51,550	(50,163)
-----------------------------	--------	----------

Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	2,378,357	2,231,438
---	------------------	------------------

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)	2,378,357	2,231,438
--	------------------	------------------

II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese

Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	(1,312,046)	(2,271,707)
--	-------------	-------------

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)	(1,312,046)	(2,271,707)
--	--------------------	--------------------

III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese

Huamarrjet	-	-
------------	---	---

Arkëtimet nga donacione	-	-
-------------------------	---	---

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)	-	-
---	----------	----------

IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)	1,066,311	(40,268)
---	------------------	-----------------

V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës	416,808	457,076
---	---------	---------

VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës (IV + V)	1,483,119	416,808
--	------------------	----------------

Shpalosjet e Pasqyrave Financiare

	Toka	Ndërtesa	Pajisjet dhe Inventari	Investimet në vijim	Gjithsej
<i>Kosto Historike</i>					
Me 31 dhjetor 2018	9,897,509	13,701,386	28,299,649	948,844	52,847,388
Blerjet	-	806	531,644	6,134,676	6,667,126
Rregullimet	-	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2019	9,897,509	13,702,192	28,831,293	7,083,520	59,514,514
Blerjet	-	1,418	331,982	1,275,033	1,608,433
Me 31 gusht 2020	9,897,509	13,703,609	29,163,275	8,358,553	61,122,947
Blerjet	-	179,499	2,297,320	-	2,476,819
Heqjet	-	-	-	(2,177,238)	(2,177,238)
Shuma e rivlerësuar me 31 gusht 2020	2,082,191	5,316,083	3,855,815	-	11,254,089
Me 31 dhjetor 2020	11,979,700	19,199,191	35,316,411	6,181,316	72,676,617
Blerjet	-	42,663	281,363	988,020	1,312,046
Rregullimet	-	-	(2,871)	-	(2,871)
Heqjet	-	-	-	-	0
Me 31 dhjetor 2021	11,979,700	19,241,853	35,594,903	7,169,336	73,985,792
<i>Zhvlerësimi i Akumuluar</i>					
Me 31 Dhjetor 2019	-	(7,124,812)	(13,827,130)	-	(20,951,942)
Zhvlerësimi I vitit	-	(351,764)	(1,505,601)	-	(1,857,365)
Me 31 dhjetor 2020	-	(7,476,576)	(15,332,731)	-	(22,809,307)
Zhvlerësimi I vitit	-	(351,923)	(1,489,350)	-	(1,841,272)
Me 31 dhjetor 2021	-	(7,828,498)	(16,822,081)	-	(24,650,579)
<i>VNL</i>					
Me 31 dhjetor 2019	9,897,509	6,577,380	15,004,163	7,083,520	38,562,572
Me 31 dhjetor 2020	11,979,700	11,722,615	19,983,679	6,181,316	49,867,310
Me 31 dhjetor 2021	11,979,700	11,413,355	18,772,821	7,169,336	49,335,213

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera

Më 31 dhjetor	2021	2020
Të arkëtueshmet tregtare rezidenciale	7,381,919	7,690,095
Të arkëtueshmet - komerciale	2,642,369	2,895,237
Të arkëtueshme tjera dhe parapagime	123,480	177,689
Parapagimet ndaj furnitoreve	-	41,585
Tatimi i parapaguar	73,868	88,153
Gjithsej	10,221,636	10,892,759
Provizonet	(3,888,518)	(3,809,272)
Gjithsej neto	6,333,117	7,083,487

Lëvizja në llogarinë e provizioneve

	2021	2020
Me 1 janar	3,809,272	3,777,529
Ngarkesa për vitin	79,247	31,743
Heqja për vitin/e njohur në të ardhura	-	-
Me 31 dhjetor	3,888,518	3,809,272

Stoqet

Më 31 dhjetor	2021	2020
Kemikalet	16,164	12,695
Materiali për gypsjellesa	484,400	509,392
Ujmatesit	70,760	86,313
Material vegla harxhues	18,739	21,588
Material vegla pune	10,093	10,678
Material mbrojtja në punë	2,390	1,546
Material elektrik	53,842	64,806
Material administrativ	3,942	5,875
Material për pastrim	1,686	1,062
Vajrat	84	85
Material për automjete	829	437
Gjithsej	662,929	714,479

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Më 31 dhjetor	2021	2020
Paraja në arkë	-	-
ProCredit Banka	14,360	5,426
ProCredit Banka-Donacionet	859,673	9,944
Banka Ekonomike	18,666	10,766
NLB Banka	353,984	22,953
Raiffeisen Banka	3,408	8,008
TEB Banka	19,096	7,325
TEB POS	3,186	7,682
Banka Kombetare Tregtare-Rrjedhese	36,183	26,770
Banka Kombetare Tregtare-Giro	1,532	1,957
Banka Kombetare Tregtare-Donacionet	1,035	1,047
Banka për Biznes	171,997	314,929
Gjithsej	1,483,119	416,808

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera

Më 31 dhjetor	2021	2020
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	286,958	714,347
Të pagueshme TVSH	20,002	35,243
Te shtyra nga konsumatorët	-	358,222
Gjithsej	306,960	1,107,812

Më 31 dhjetor	2021	2020
Të pagueshmet ndaj punonjësve	1,208	2,671
Tatimi në burim i pagueshëm	13,470	12,765
Kontributi pensional i pagueshëm	21,218	20,447
Të pagueshme për detyrimet tatimor	299	417
Detyrime ndaj tatimit në fitim	26,520	-
Shpenzimet akruale	-	212
Gjithsej	62,715	36,511

Më 31 dhjetor	2021	2020
Të hyrat e shtyra	15,983,412	14,900,213
Gjithsej	15,983,412	14,900,213

Lëvizja e të hyrave të shtyra

	2021	2020
Me 1 janar	14,900,721	13,993,904
Të shtyra gjatë vitit	1,688,487	1,466,710
Të njohura në pasqyrën e të ardhurave	(597,478)	(559,893)
Me 31 dhjetor	15,991,730	14,900,721

Veprimat e zhvilluar nga Departamenti Administrativ gjat vitit 2021

Puna e Sekretarit të Kompanisë - gjat vitit 2021 ne detyrat e bazuar ne Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike, Kodin Etikes,dhe Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare janë kryer punët si me poshtë;

Raportin vjetor mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste 2021,Qeverisja Korporatave e Kompanisë për vitin 2021, Vetëvlerësimi Bordit te Drejtoreve për vitin 2021; Vlerësimi zyrtareve te larte për vitin 2021 ;Përgatitja e formularëve për deklarim te pasurisë për Drejtoret e Bordit te Drejtoreve dhe zyrtaret e Kompanisë ne AKK;Përcjellja e raporteve tremujore mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ;Plan Biznesit 2022/2024 ;Raporti hulumtimi Kënaqësisë se Konsumatorëve për vitin 2021; përgatitja e kërkesave te dalluara nga BtD ;Mbledhja përgjithshme vjetore me Aksionarin.


Te dhënat për NJPMNP/MZHE, Bordit Drejtoreve është bere vlerësim nga një Kompani konsulentë e kontraktuar nga NJPMNP për punën e vitit 2021 ku janë përgatitë te gjitha materialet e kërkuara te skanuara dhe te përmbledhura ne CD, te dhënat për web faqe te NJPMNP, te dhëna për qasje ne dokumente zyrtare. Për Njësine për Politika dhe Monitorim vazhdimisht janë përcjell te dhëna për kërkesa te ndryshme sa i përket departamenteve.

Punët e kryera nga Sekretari të Kompanisë për periudhën vjetore 2021 për Bordin e Drejtoreve, Komisionit te Auditimit dhe Komitetit Financiar ; Janë mbajtur mbledhjet , Mbledhja e Komisionit Auditimit, Mbledhja e Bordit te Drejtoreve. Caktimi mbledhjeve nga Kryesuesi i BtD , dhe Kryesuesi i KA, përpilim i Agjendës se mbledhjeve, njoftimi aksionarit për datën dhe kohen e takimeve. Janë përpiluar Draft procesverbalet e mbledhjeve dhe janë përcjell tek drejtoret e bordit dhe aksionari ne afatin ligjor prej 7 ditësh. Procesverbalet finale janë plotësuar me përmirësime teknike nga ana e drejtoreve te Bordit te protokolluara dhe nënshkruara dhe skanuara për cillen tek aksionari. Përgatitja e materialeve për mbledhje, kompletimi i te gjithë raporteve për Departamentin Financiar, Teknik dhe Administrativ dhe dorëzimi ne kopje fizike tek Drejtoret e Bordit si dhe është përpiluar raporti i Komisionit te Auditimit për mbledhjen e Bordit te drejtoreve.

Tabelari - Mbledhjet e Bordit te Drejtoreve, Komisionit Audiitmit, Komitetit Financiar gjate periudhes Janar - Dhjetor 2021

<i>Janar -Dhjetor 2021</i>	<i>Bordi Drjetoreve</i>	<i>Komisioni Auditimit</i>	<i>Mbledhja pergjithshme vjetore /Aksionari</i>
Mbledhjet	12	12	1
Agjendat	12	12	1
Draft procesverbalet	12	12	1
Procesverbalet finale	12	12	1

Diagrami - Mbledhjet e Bordit te Drejtoreve, Komisionit Auditmit, Komitetit Financiar gjate periudhës Janar -Dhjetor 2021



Janë përpiluar Draft procesverbalet e mbledhjeve dhe janë përcëlluar tek drejtoret e bordit dhe aksionari ne afatin ligjor prej 7 ditësh. Procesverbalet finale janë plotësuar me përmirësime teknike nga ana e drejtoreve te Bordit te protokolluara dhe nënshkruara dhe skanuara përcillen tek aksionari.

Mbrojtja në punë e punëtorëve dhe objekteve (Janar - Dhjetor 2021)

Mirëmbajtja e objekteve

Në Dep. Administrativ – Njësia Mbrojtja në Punë e Punëtorëve dhe Sigurimi i Objekteve ,në kontinuitet janë realizuar të gjitha aktivitetet e nevojshme nga marrëdhënia e mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe sigurimi e objekteve, në përputhje me kërkesat e stafit të kompanisë dhe dispozitave të aplikueshme ligjore. Inspektimet te cilat janë bërë gjatë kësaj periudhe në objekte nga kjo Njësi mund të cekim si më poshtë;

Drejtorja Gjakovë - Gjatë vitit 2021 kemi bere mirëmbajtjen e vazhdueshme te objektit (drejtorisë) te oborrit, parkingut dhe hapësirave gjelbëruese;

Pas shumë problemeve me parkingun e drejtorisë qe gjendet mbrapa objektit, ku ishim te detyruar te angazhojmë një punëtor te sigurimit për sistemimin e automjeteve te kompanisë për arsye se qytetaret shfrytëzonin hapësirat e parkingut për nevojat e tyre, dhe ne çdo dite kishim probleme me këtë dukuri, kemi bere një kërkesë për montimin e një Barriere apo Rampe automatike e cila dot shfrytëzohej vetëm për nevojat e automjeteve tona, menagjmenti ka aprovuar sugjerimet tona dhe është siguruar kjo rampe ku I kemi pajisur te gjitha automjetet me telekomandat përkatëse për shfrytëzimin e kësaj rampe dhe tani është rregulluar kjo problematik është bere montimi i rampës automatike dhe sistemimi i parkingut me vendet e caktuara dhe është bere ne vazhdimësi pastrimi dhe kontrollimi, po ashtu është bere shenhezimi i rampës.

Gjate ditës për pastrimin dhe mirëmbajtje është kujdesur stafi qe punon ne drejtori, kemi te angazhuar edhe 2 persona kujdestar te cilët mbajnë rregullin e sigurisë, drejtojnë konsumatorët dhe mysafiret ne sektorët përkatës dhe kujdesen qe çdo kërkesë si nga konsumatorët apo stafi te realizohet ne mënyrën sa me te mirë te mundshme.

Ne vazhdimësi janë kontrolluar dhe mirëmbajtur kamerat e sigurisë janë mbushur dezinfektuesit dhe janë kontrolluar punëtorët dhe konsumatorët a janë duke i mbajtur maskat dhe a janë duke respektuar rregullat Anti Covid ne hapësirat e drejtorisë.

Ne oraret e pasdites pas orës 16:00 rojtaret kanë kontrolluar autoparkun nëse ndonjë nga punëtorët ka harruar diçka pa vendosur ne vendin e duhur apo mos kanë lan ndonjë automjet jo ne rregull, kanë kontrolluar pajisjet e punës dhe njëherit stafi i Rojtareve qe janë pasdite dhe gjatë Vikendeve janë kujdesur edhe për pastrimin e oborrit. Është mbajtur evidencë gjate gjithë kohës për lajmërimin e defekteve te cilat lajmërohen pas orës 16:00, dhe te njëjtat defekte apo kërkesa janë dorëzuar te nesërmen te secilës dite tek sektorët përkatës.

Kemi pasur disa probleme me kulmin ku disa here me ekipet tona kemi intervenuar ne sanimin e pjesëve te dëmtuara te kulmit, mirëpo për tu evituar ky problem ka nevojë për ndërrimin e komplet kulmit ku edhe ne si njësi kemi bere sugjerimet tona për te angazhuar një kompani te jashtme qe te ndërrohet komplet kulmi qe te evitohet një herë e mirë ky problem.

Po ashtu disa here është pastruar komplet objekti nga brenda dhe jashtë nga kompania e pastrimit e cila ka qen e kontraktuar nga kompania.

Edhe gjatë festive te fund vitit e kemi bere zbulimin e objektit dhe hapësirave te jashtme, ku ne si njësi kemi bere mbikëqyrjen e vazhdueshme te gjitha punimeve ku punëtorët tanë kane asistuar kompaninë fituese te tenderit gjate punimeve duke ju treguar burimet e energjisë ku mund te kyçen dhe kanë bere transportimin e strukturës se metalit për vendosjen e dritave.

Po ashtu rojtaret çdo here kur ka pasur nevojë kanë bere kositjen e barit dhe kanë bere pastrimin e hapësirave tjera pas orarit te rregullt te stafit te rregullt te kompanisë.

Drejtoria Rahovec - Gjate vitit 2021, është mirëmbajtur objekti si nga brenda edhe nga jashtë është mirëmbajtur oborri nga ana e rojtareve pas orarit te rregullt te stafit te kësaj drejtorie, ne vazhdimësi janë mbikëqyr dhe mirëmbajt kamerat e sigurisë dhe është mbajtur koordinim me te gjitha njësit qe operojnë ne atë zone për lajmërimet e te gjitha kërkesave qe vijnë edhe pas orarit te rregullt te punës, kemi bere edhe pastrimin e sistemit e pjesës se autoparkut qe gjendet jashtë rrethojave te objektit administrativ, ku te gjitha pjesët e panevojshme dhe te vjetruara i kemi dërguar ne magazinën e Xerxes dhe i kemi shitur ne Ankand. Rojtaret ne vazhdimësi janë duke kujdesur edhe për ndezjen e kontrollimin e kaldajave ne mënyrë qe ne mëngjes te gjejnë te gatshme kur te vine administrata. Është bere edhe furnizimi i ekipeve te mirëmbajtjes me tabelat shenjuese qe gjatë eliminimit te defekteve te përdoren këto tabela-shenja qe qytetaret te jen me te sigurt gjate lëvizjes se tyre kur ekipet tona punojnë. Po ashtu është bere dezinfektimi i vazhdueshëm i kësaj njësie për marrjen e masave Anti Covid.

Drejtoria Prizren - Ne Objektin e kësaj drejtorie nga aspekti i sigurisë dhe mirëmbajtjes kujdeset stafi i kompanisë Hidroregjioni Jugor te cilët janë ne te njëjtin objekt me neve, ndërsa stafi jone ka bere mirëmbajtjen e hapësirave qe kontrollojmë ne edhe janë mbikëqyr dhe mirëmbajt kamerat e sigurisë qe kemi ne dispozicion ne atë zonë. Po ashtu parkingu ku kemi automjetet tona dhe është një koordinim i mirë mes stafit te dy kompanive. Kemi bere vizita te ndryshme edhe ne këtë objekt. Dhe janë bere punime ne parkun(oborrin) e kësaj njësie për përgatitjen e sezonës se dimrit. Po ashtu është biseduar me stafin e kësaj njësie qe te respektojnë masat e sigurisë dhe shëndetit ne pune dhe te përdorin te gjitha pajisjet për pune dhe te përdorin tabelat sinjalizuese gjate punimeve ne teren.

Njësia Operative Reka e Keqe - Ne këtë njësi është bere mirëmbajtja e vazhdueshme e objektit, dhe oborrit. Rrethoja është e mirë kamerat janë duke punuar dhe janë kontrolluar ne vazhdimësi, ne kamera kemi nevojë te ndërhyrë për te bere ri pozicionimin e disa prej tyre ne pozicione ma te nevojshme dhe na duhet te vendoset një monitor ne zyrën e rojtareve qe te kenë edhe ata një vizion me te mirë te asaj se çfarë ndodh ne pjesën e jashtme, kamerën e jashtme tek hyrja kemi arrit ta pozicionojmë ne vendin e duhur tani presim edhe te tjerat. Edhe ndriçimi ka nevojë te rregullohet se janë djegur shumë poqa te rrymës, dhe duhet vendosur disa reflektor ne hapësirat jashtë objektit. Rojtaret ne përjashtim detyrës se tyre ata kujdesen edhe për Stacionin e Filtrimit qe gjendet ne këtë njësi edhe ne këtë periudhe sikurse ne periudhat tjera ata kanë kontrolluar e kanë mirëmbajt dhe kanë pastruar filtrat dhe për çdo problem apo nevojë shtesë kanë kontaktuar dhe kanë bashkëpunuar me menaxhmentin e kësaj njësie. Po ashtu rojtaret e kësaj njësie kanë asistuar dhe ndihmuar ne vazhdimësi ekipet për te shkuar ne bjeshkë tek burimi i ujit sa here qe ka pas nevojë duke marr parasysh problemet e shumta qe janë ne arritjen e këti lokacioni. Edhe sistemi i kalldajes duhet shikuar mundësia për ndërrimin e saj dhe te behet me rrym sepse kalldaja aktuale është duke sjellur problem sepse është me pellet dhe nuk është ne gjendje te mirë. Ka

pasur disa here probleme edhe me rrymën elektrike mirëpo tani ky problem është zgjidhur dhe është siguruar agregati qe sa here ka ndërprerje te rrymës tani nuk do ketë asnjë pengës ne mbarëvajtjen e punës.

Stacioni i Filtrimit - Ne stacionin e filtrimit janë kryer punime te ndryshme gjate vitit 2021:

Është bere pastrimi i objektit dhe filtrave dhe është bere dezinfektimi i te gjitha hapësirave.

Është bere pastrimi i rezervuarëve kryesor te stacionit te filtrimit dhe janë bere dezinfektimet dhe sërvisimi i te gjitha pjesëve dhe njësie perçjellese.

Është bere pastrimi i te gjitha hapësirave te depove dhe oborrit nga materialet e vjetruara dhe jashtë përdorimit te cilat materiale kanë qene te mbledhura nder vite, ku për te gjitha këto pune është krijuar një komision i cili ka bere raportet e nevojshme dhe ne si njësi kemi bere pastrimin e këtyre materialeve dhe te njëjtat i kemi dërguar ne magazinën ne Xerxe dhe pastaj ato qe kanë qen jashtë përdorimit janë shitur ne ankand.

Është mirëmbajtja e vazhdueshme e parkut te kësaj njësie ku siç dihet është një hapësirë e madhe dhe janë ujitur dhe kositur ne vazhdimësi pjesa e barit dhe janë mirëmbajt pemët dhe te gjitha hapësirat tjera dekorues.

Edhe ky objekt është gjithmonë i vëzhguar nga kamerat e sigurisë ne këtë objekt punohet 24 ore me ndërrime, rojtaret ne përjashtim te detyrave te tyre për çështjen e sigurisë ata ndihmojnë edhe ekipet tjera qe punojnë ne ketë njësi. Edhe ne ketë njësi është punuar ne hapësirat e oborrit ku është bere përgatitja e hapësirave gjelbëruese për sezonin e dimrit.

Rezervari Qerim - Ky është një objekt me rendësi te veçante, është i vëzhguar nga kamerat e sigurisë dhe nga rojtaret 24 ore. Ne këtë objekt rojtaret ne përjashtim detyrës se tyre për siguri ata kujdesen edhe për manipulimin e valvuleve te gypave sipas nevojës se shpenzimit te ujit nga konsumatorët pasi qe nga aty kontrollohet niveli i rezervarëve dhe ne baze te këtij niveli dirigjohet edhe prodhimi i ujit ne stacionin e filtrimit se sa ka nevojë te prodhojnë ujë dhe ne anën tjetër sigurohet qe mos te ketë derdhje nga rezervarët nëse nuk ka shpenzim te madhe.

Edhe nga ana e mirëmbajtjes se objektit gjithmonë kujdesen rojtaret dhe kohe pas kohe edhe ekipet e mirëmbajtjes vizitojnë dhe shikojnë punët mekanike te pjesëve fazonike qe gjinden ne këtë objekt.

Gjate vitit 2021 vlen te cekem këto punime me rendësi:

Sistemimi i kanalizimit dhe drenazhe se keti objekti i cili ka qen ne gjendje shumë te keqe dhe sa here binte shi përmyteshin te gjitha pjesët fazonike ku rrezikoheshin te ndryshken nga uji i tepërt ne te, po ashtu ne kishim shpenzime enorme duke angazhuar ekiye 24 ore me pompa thithëse me rryme dhe benzinë për thithjen e ujit nga këto hapësira. Mirëpo fale angazhimit tone duke vendosur ne funksion ekipet e kanalizimit dhe mirëmbajtjes kemi arrit te zgjedhim ketë problem dhe tani është një gjendje shumë e mirë dhe skemi pasur me telashe te kësaj natyre.

Është bere pastrimi i dy rezervarëve kryesor qe gjenden ne ketë lokacion dhe niherit edhe dezinfektimi i këtyre rezervarëve ku është bere një pune shumë e madhe fale angazhimit te njësit sonë duke angazhuar departamentin teknik dhe njësit tjera relevante.

Është bere sistemimi i dyerve te rezervarit i kapakëve te rezervarëve i grilave për çështje sigurie, ndërrimi i bravave dhe përforcimi i tyre është bere pastrimi i komplet hapësirave, dhe është bere lysterja e te gjitha këtyre punimeve me ngjyrat adekuate qe mos te vije deri te kontaminimi i këtyre lokacioneve me rendësi te veçante.

Është bere sistemi i rrugës dhe mirëmbajtja e vazhdueshme duke pasur parasysh relievin e kësaj rruge dhe frekuentimin nga makineri te renda bujqësore qe e shfrytëzon ketë rruge. Shpresojmë qe ne te ardhmen te mund te sistemohet edhe me asfaltim kjo rruge deri tek rezervari.

Po ashtu është bere pastrimi i hapësirave te jashtme te keti lokacioni ku janë prere pemët te cilat pengonin apo rrezikonin rezervarët.

Shtëpiza e rojtareve ka nevojë te ndërhyhet për një renovim nga brenda sepse nga lagështia e madhe qe është ne këtë lokacion është dëmtuar shumë dhe është e nevojshme edhe ne rrethimin

e oborrit te ndërhyhet me një projekt nga ndonjë kompani e jashtme sepse rrethimi është dëmtuar ne te gjitha anët. Kohe pas kohe kemi pasur probleme edhe me sistemin e kamerave dhe rrjetit te internetit mirëpo kemi intervenuar dhe kemi eliminuar menjëherë problemet duke bashkëpunuar me operatorin qe na furnizon me rrjet.


Rezervaret e Fshatrave - Siç dihet ne përjashtim te rezervarit kryesor në Qerim, ne kemi edhe rezervarët neper fshatra ne te katër njësit punuese, ku një pjesë e tyre vizitohen çdo dit ndërsa disa prej tyre me rrallë vetëm kur ka nevojë për ndonjë intervenim apo kur behet pastrimi i tyre ne kohe pas kohe bëjmë pastrimin e tyre si brenda edhe te hapësirave për rreth, gjatë vitit 2021 kemi intervenuar ne te gjithë rezervarët duke bere pastrimin e tyre nga shkurret dhe barishtat e këqija qe gjinden ne oborret e tyre, kemi bere edhe pastrimin e rezervarëve nga brenda për një cilësi ma te mirë te ujit, po ashtu kemi intervenuar ne rregullimin e disa rrugëve qe te dërgon te këta rezervar. Ne disa lokacione kemi pasur telashe me dëmtimin e dyerve nga persona te pa përgjegjshëm mirëpo fale angazhimit tone kemi arritur ti sistemojmë dhe riparojmë dyert dhe te gjitha asetët e nevojshme qe kanë qen te dëmtuara si nga faktori njeri po ashtu nga natyra tjera. Nga ana e sigurisë kemi intervenuar ne rezervarët e Dushkajes dhe Cermjanit ku kemi bere blerjen dhe montimin e dyerve te dy rezervarëve pasi qe na ishin thyer dhe vjedhur shumë here tani me këtë sistem te ri te dyerve nuk kemi pasur me probleme. Po ashtu ne fshatin Dedaj kemi intervenuar ne dyert e keti rezervari.

Trafo Sopot. _Ne këtë objekt janë duke u kryer punimet e rrethimit, mirëpo akoma nuk kanë mundur te përfundohen për shkake te procedurave gjyqësore qe jemi duke ndjekur me pronaret fqinje. Edhe ky objekt ka kamerat e sigurisë te cilat mirëmbahen dhe kontrollohen ne vazhdimësi. Gjate vitit 2021 kemi bere disa punime ne mirëmbajtje te hapësirave rreth trafo. Gjate kësaj periudhe kemi bere edhe pastrimin e trasesë se tensionit te larte ne te dy segmentet nga Gjakova ne Trafo Sopot dhe nga Trafo Sopot tek stacioni I filtrimit. Edhe ne kete stacion gjindet nje rezervar te cilin e kemi pastruar dhe dezinfektuar.

Tabela 2 – Rezervarët ne KRU "Gjakova" Sh.A. gjatë vitit 2021

Rezervarët e Gjakove	Rahovec	Prizren	Njesia Reka e Keqe
1.Rezervaret Qerim (Rojtaret)	Rahovec 1 (Rojtaret)	Reti e Ulet-Eperme	Rezervari N.1
2.Rezervari Palabardh	Rahovec 2 (Rojtaret)	Breg Drini	Rezervari N.2
3. Rezervari Cermjan	Rahovec 3	Zym	Dobrosh
4.Rezervari Çabrat	Rahovec 4	Dedaj	
5.Rezervari Brekoc	Pataqan 1	Lugisht e Hasit	
6.Rezervari Vrajak	Pataqan 2	Krajk	
7.Rezervari Dol	Drenoc		
8.Rezervari Lipovec	Senoc		
9.Rezervari Demjan 1	Bratatin		
10.Rezervari Demjan 3	Opterush		
11.Rezervari Kusar	Hoqe e Madhe		
12.Rezervari Hereq	Guri i Kuq		
13.Rezervari i Dushkajes	Pastasel		

Diagrami 1 - Rezervarët ne KRU"Gjakova" Sh.A. gjatë vitit 2021



Stacionet e pompave fshatra - Stacionet e pompave vizitohen me shpesh nga ekipet tona sidomos nga ekipi e kontrollë edhe këtë periudhë është bere mirëmbajtja e shumicës prej tyre ku kemi intervenuar sipas nevojë ne sistemimin e pompave dhe hapësirave përcjellëse, nga ana e sigurisë qëndrojnë mirë, ne tre stacione ku kemi edhe kamerat dhe rojtaret, kamerat mirëmbahen dhe kontrollohen. Tani ka probleme shpesh me furnizimin e rrymës shkak i sezonës se dimrit KEDS po ndërprejnë rrymën dhe po çrregullohet furnizimi i rezervarëve që furnizohen nga këto stacione të pompave.

Stacionet e pompave 1-2 Rahovec - Ne këto dy stacione është bere mirëmbajtja e objekteve, janë rregulluar rrethojat aty ku kanë qenë të dëmtuara, këto stacione janë të monitoruara nga kamerat e sigurisë dhe rojtaret 24 ore pa ndërprerë. Ne stacionin 1 ka nevojë që të rregullohen hapësirat ku qëndron dhe punojnë manipulueset e pompave të riparohet objekte dhe nyjet sanitare. Po ashtu në këtë lokacion gjendet edhe rezervari kryesor i njësit të Rahovecit ku edhe në këtë rezervar kemi bere pastrimin e rezervarit dhe dezinfektimin e tij, ndërsa në stacionin 2 kemi bere montimin e një pompe thithëse në këtë njësi për të shpëtuar pompat që gjenden në këtë lokacion nga vërshimet e ujit gjatë reshjeve.

Po ashtu edhe në stacionin 2 është bere pastrimi i rezervarit 2 dhe sistemimi i rrethojës dhe pastrimi i hapësirës së jashtme.


Depoja Xërxe- në këtë objekt gjatë ditës punohet nga ana e magazinierëve të cilët mbajnë evidencat e hyrje daljeve të materialit të kompanisë sonë, ndërsa pas orës 16 dhe vikendeve janë rojtaret të cilët merren me çështjen e sigurisë dhe bëjnë mirëmbajtjen e këtyre magazinave kur ka nevojë. Në gjatë vitit 2021 kemi bere shumë punime në këtë njësi, kemi bere një rrethim të përkohshëm të oborrit të objektit kemi pastruar të gjitha hapësirat rreth objektit kemi bere sistemimin e materialeve që gjenden në oborr kemi bere pastrimin e materialeve të pa përdorshme duke liruar hapësira tjera për nevojat e kompanisë, mirëpo tani na kanë mbetur për të rregulluar nyjet sanitare sepse nuk kemi fare në këtë njësi. Kemi bere disa here kërkesa që të rregullohen këto banje mirëpo akoma nuk është bere ndonjë lëvizje nga ana e menagjmentit. Objekti është i vëzhguar edhe nga kamerat e sigurisë dhe në të ardhmen është mirë të mendohet edhe për një rrethim cilësor të oborrit sepse në kemi bere një rrethim provizor me mundësit tona dhe me angazhimin e ekipeve tona.

Tabela 3- Stacionet e pompave ne KRU"Gjakova" Sh.A. gjat vitit 2021

Stacionet e Pompave Gjakove	Rahovec	Prizren
1.Stacioni i pompave Sopot. (Rojtaret)	Rahovec1(Rojtaret)	Reti e Ulet – Eperme
2.Stacioni i pompave Cermjan (Filtra)	Rahovec2(Rojtaret)	Breg Drini
3.Stacioni i pompave Çabrat	Pataqani 1	Dedaj
4.Stacioni i pompave Brekoc	Pataqani 2	Lugizhde e Hasit/ Kabash

5.Stacioni i pompave Vrajak	Drenoc	Karashingjergj
6.Stacioni i pompave Dol/Lipovec	Senoc	Reti e Ulet – Eperme
7.Stacioni i pompave Demjan 1 dhe 3	Bratatin	
8.Stacioni i Pompave Kusar	Opterush	
9.Stacioni i pompave Kushavec	Hoqe e Madhe	
10.Stacioni i pompave Firze	Polluzh	
11.Stacioni i pompave Muhader	Pastasel	
12.Stacioni i pompave Rezin		
13.Stacioni i pompave Novosell		
14.Stacioni i pompave Dushkaj(Filtra)		
15.Stacioni i pompave Hereq		
16.Stacioni i pompave Ujz		
17.Stacioni i pompave emergjente Zhdrell		

Diagrami 2- Stacionet e pompave ne KRU"Gjakova" Sh.A. gjatë VITIT 2021



Diga dhe Liqeni - Ne dige kemi 4 rojtare te cilët ndërrohen me ndërrime ne objektin e digës, komplet diga me pjesët percjellese është e monitoruar nga kamerat.

Gjate vitit 2021 ne vazhdimësi janë kontrolluar këto hapësira janë pastruar diga dhe brigjet e liqenit nga mbeturinat, është sistemuar rruga nga liqeni deri tek stacioni i filtrave ku janë sanuar gropat ne rruge, është bere pastrimi i therrave dhe shkurreve ne pjesën e digës nga ana e Liqenit. Është kontrolluar ne vazhdimësi liqeni për ndalimin e prerjeve te pyjeve dhe peshkimin ilegal, janë bllokuar shumë rruge me ekskavator për parandalimin e dukurive te lartcekura, me ane te anijes është monitoruar komplet liqeni gjate ditës dhe natës. Kemi bere patrullime te përbashkëta me njësit Policore dhe me inspektoret e ndryshëm ne ruajtjen e liqenit.

Është bere montimi i rampës apo barrierës automatike ku tani është një siguri me e larte, është punuar ne sigurinë e digës dhe liqenit duke respektuar rekomandimet dhe udhëzimet administrative te ministrisë se ambientit, është bere komplet shenhezimi i hapësirave rreth Digës dhe Liqenit me shenjat përkatëse me ndalesat ne fuqi.

Pas rekomandimeve te Ministrisë se Ambientit dhe Bordit te Drejtoreve ne këtë lokacion gjate kësaj periudhe kane filluar punimet për rrethimin e pjesës nga Rampa deri tek kanali kullues qe gjendet tek hapësira poshtë restorantit qe përdorej si kalim këmbësorësh nga banoret e fshatit Zhdrell. Tani pas aprovimit te kërkesës te Peshkatarëve nga ana e Ministrisë se Ambientit për lejimin e peshkatarëve qe te kenë qasje te liqeni për peshkim ka filluar ndotja me e madhe e brigjeve ku ata peshkojnë po ashtu kanë filluar dëmtimin e pyjeve rreth liqenit duke ndezur zjarre për ngrohje dhe për përgatitje te ushqimit sa ata qëndroin aty. Andaj kisha kërkuar edhe një here nga menagjmenti te rishikojnë vendimin e ministrisë duke kërkuar interpretime ligjore ne ministrit përkatëse.


Edhe ne ndriçimin e digës ka nevojë te intervenohet sepse shumica e poçeve elektrik janë te djegur mirëpo për këtë problem dot ishte mirë te behet një projekt për ndërrimin e komplet këtyre

llampave sepse janë shumë te vjetër dhe ne vazhdimësi po digjen poçet dhe po kemi telashe te mëdha ne ndriçim. Edhe te shikohet mundësia e ndërrimit te kamerave sepse nga lagështia e tepërt qe ka ne këtë zone kanë filluar te dëmtohen dhe te humbin kualitetin e tyre.

Tabela 4.- Aparatet e zjarrfikës ne KRU"Gjakova" Sh.A. gjatë vitit 2021

Aparatet e zjarrfikës	Nr. i Aparateve të zjarrfikës
Aparat zjarrfikës P – 6	26
Aparat zjarrfikës P – 9	26
Aparat zjarrfikës P – 50	1
Aparat zjarrfikës CO2- 5	8
Aparat zjarrfikës CO2- 30	2
Aparat zjarrfikës me pluhur 1 kg	17
Aparat zjarrfikës me pluhur 2 kg	9
Aparat zjarrfikës me pluhur 9 kg	8
Shqyrtim hidrostatik i rrjetit te Hidranteve	5

Diagrami 3.- Aparatet e zjarrfikës ne KRU"Gjakova" Sh.A. gjatë vitit 2021



Tabelori – Numri i të gjitha objekteve në katër Njësit Operative te KRU"Gjakova"Sh.A.

Nr. i objekteve te K.R.U Gjakova dhe Punëtoret e Sigurimit me mirmbajtësa	Gjakove	Rahovec	Prizren	Njesia e Rekes se Keqe
Depo	1			
Rezervar	13	13	6	3
Stacione te pompave	17	11	5	
Objekte Administrative	2	1	1	1
Vizitat e dhe kontrollet e realizuara gjatë Vitit 2021	147	73	56	58

Diagrami – Numri i të gjitha objekteve në Katër Njësiti Operative të KRU "Gjakova" SH.A.



Mbrojtja në punë e punëtorëve - Kryen detyra dhe punë në fushë të sigurisë dhe mbrojtjes dhe kujdesit ndaj personelit. Dezinfektimi dhe inspektimi i objekteve nga lëmia e sig. në punë, janë kryer punë për mbrojtjen dhe mirëqenien e punëtorëve, vlerësimi teknik i rrobave dhe pajisjeve mbrojtëse, janë këshilluar edhe udhëheqësit e njësive punuese që të kontrollojnë në vazhdimësi punëtorët që të mbajnë uniformat dhe pajisjet përcjellëse dhe të respektojnë normat e sigurisë, është bërë kontrollimi dhe shqyrtimi i hidrantëve kundër zjarrit. Po ashtu është bërë dy herë rimbushja dhe kontrollimi i aparateve kundër zjarrit në të gjitha njësit dhe janë pajisur edhe njësit që nuk kanë poseduar aparate kundër zjarrit me këto aparate. Pasi kemi përfunduar trajnimin e stafit të sigurimit për përdorimin e aparateve kundër zjarrit, tani kemi bërë kërkesën edhe për trajnime në fushën e sigurisë dhe në fushën e mbrojtjes në punë të punëtorëve ku janë kontaktuar kompanitë që merren me këtë fushë të trajnimeve dhe në bashkëpunim me menaxhmentin i kemi futur në plan biznes edhe këto trajnime të nevojshme.

Kemi pajisur njësit punuese të terrenit me tabela shenjzimi që duhen të përdoren gjatë punës në eliminimin e defekteve dhe punëve tjera në teren që këto tabela ndihmojnë shumë si në sigurinë e punëtorëve po ashtu edhe në sigurinë e qytetareve të cilët lëvizin në këto hapësira ku kryhen punimet nga ekipet tona.

Po ashtu janë pajisur ekipet e mirëmbajtjes me mjete personale të punës, me makineri adekuate që janë brenda normave të shëndetit dhe sigurisë në punë ku në vazhdimësi është duke u punuar në eliminim të mjeteve të punës të cilat kanë burim potencial të rrezikut në punë dhe të njëjtat të zëvendësohen me mjete të sigurta të punës. Po ashtu edhe të gjithë punëtorët e terrenit janë pajisur me rroba të punës, të të dyja stinëve.

Trajnimet;

Gjatë vitit 2021, në si njësi kemi bërë trajnimin e të gjithë pjesëtarëve të sigurimit të objekteve për përdorimin e aparateve kundër zjarrit, po ashtu kemi bërë edhe trajnime në fushën e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë duke ndjekur trajnime Ndërkombëtare në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës. Dhe janë bërë hulumtime se ku ka nevojë të bëhen trajnime për ne të ardhmen ku në si njësi kemi bërë plan programe për të bërë trajnime në fushën e sigurisë për mbrojtjen e objekteve dhe hapësirave me rendësi të veçante. Po ashtu kemi kërkuar të behet Vlerësimi i Rrezikut për kompaninë tone dhe trajnimi stafit për siguri dhe shëndet në punë.

Po ashtu kemi përpiluar një dokument duke propozuar dhe rekomanduar njësit punuese të kompanisë sonë për procedurat që duhet ndjekur gjatë punimeve.

Masat AntiCovid – Gjatë gjithë vitit jemi përballur edhe me gjendjen Anti Covid ku Qeveria ka vazhduar masat në lidhje me Covid-19, ku në vazhdimësi kemi kontrolluar a janë duke u zbatuar edhe masat Anti Covid ku kemi arritur që të sigurojmë edhe dëshmitë e marrjes së vaksinës të mbi 90 % të stafit tonë. Janë mbajtur në evidencë të gjitha rastet pozitive dhe janë kontrolluar nëse kanë respektuar afatet kohore për paraqitjen e tyre në punë pasi kanë prezantuar dokumentet e nevojshme me rezultatin negativ që e kanë kaluar Covidin. Në vazhdimësi janë siguruar maskat dhe

dezinfektuesit e nevojshëm ne te gjitha hapësirat ne mënyrë qe te ndihen sa me mirë dhe sigurt edhe stafi jonë por edhe konsumatorët apo vizitorët qe kanë frekuentuar hapësirat tona.

Janë kontrolluar njësit e mirëmbajtjes dhe kanalizimit ne te katër njësit punuese nëse janë duke respektuar masat dhe procedurat e sigurisë ne pune.

Pas kryerjes së vizitave janë bërë Procesverbale për secilën Njësi Punuese veç e veç lidhur me gjendjen në të cilën ndodhen dhe si dhe mangësitë të cilat janë vërejtur ku edhe janë dhënë propozime për mënjanimin e mangësive ekzistuese.

Tabelari - i të gjitha Njësive Operative te KRU"Gjakova"Sh.A.

LISTA E OBJEKTEVE K.R.U "GJAKOVA" SHA	Gjakove	Rahovec	Prizren	Reka e Keqe	Magazina Xerxe	Stacioni Filtrimit	Stacione e Pom. Fshatra & TS
Aparat zjarrfikës	7	3	4	4	4	17	Fshatra 14 Sopot 8
Hidrantë	4					1	
Kutia e Ndihmës së parë	1	1	1	1		1	
Kamera Sigurie	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Trafo Sopot
Objekte Administrative	1	1	1	1			

Njësia Ligjore

Veprimet nëpër Gjykata, Prokurori dhe Përmbarues

KONTESTE PUNE

Dafina Deva 2 - C.nr. 168/18 – Padi - Kontest pune ,Kompania palë e paditur. Gjykata themelore në Gjakovë ka aprovuar ne tërësi Padia e paditëses. Kompania ka bere ankese ne Gjykatën e Apelit, presim Aktgjykimin e kesaj Gjykate . Lënda ne vazhdim te procedurës.

Nexhat Sefa - C.nr. 123/18 – Padi - Kontest pune ,Kompania palë e paditur. Kemi pranuar akt gjykimin nga Gjykata Themelore e Gjakovës ku është aprovuar ne tersi padia e paditësit Nexhat sefa. Avokati – Kompani ne afat ka ushtruar Ankese për Gjyk. e Apelit te Kosovës. Kontesti ne vazhdim te procedurës.

Musli Krasniqi - C.nr. 602/15 – Padi - Kontest pune , Gjykata Themelore ka marr aktvendim ne te mire te paditësit. Është ushtruar ankese ne Gjykatën e Apelit . Presim Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Ruzhdi Hasi – Padi - Kontest pune ,Kompania palë e paditur . Kemi pranuar Aktvendimin e Gjykatës se Apelit te Kosovës, ku ne baze te Aktvendimit te kësaj gjykate është Refuzuar ankesa e paditësi si e pasafatshme .Kontesti ka përfunduar ne tersi.

Adnan Nurkasa – C.nr. 216 /13 . Kontest pune . Kompania palë e paditur . Kemi pranuar Aktgjykimit e Gjykatës themelore te Gjakovë – Dega Rahovec, ku është aprovuar ne tersi Padia e paditësit. Kompania ka bere ankese ne Gjykatën e Apelit, presim Aktgjykimin e kësaj Gjykate. Kontesti është në vazhdim te shqyrtimit.

Beqir Zeqiroviq C.nr. 386/08, Kontesti pune ku pale e paditur në këtë kontest është Kompania. Është mbajt shqyrtimi kryesor . Gjykata Themelore merr Vendim ne te mirë te Kompanisë.

Paditësi ka bere Ankesë ne Gjykatën e Apeli . Kemi bere Përgjigje ne Ankesë . Presim Vendimin e Gjykatës se Apelit . Gjykata e Apelit ka marr aktgjykim me te cilën lenden e kthen ne rishqyrtim. Kemi pranuar thirrje nga Gjykata për mbajtjen e seancës me 15.12.2021.

Ismet Ahmeti- C.nr. 1792/21 – Padi - Kontest pune, është mbajtur shqyrtimi mbi propozimin për caktimin e masës se sigurisë. Gjykata Themelore ka marr aktvendim duke refuzuar propozimin për caktimin e masës. Kontesti është në vazhdim te shqyrtimit.

Shqipe Beqa - C.nr. 1739/21 – Padi - Kontest pune, Kompani ka dorëzuar ne gjykatë përgjigje ne padi. Kontesti është në vazhdim te shqyrtimit.

KONTESTE KOMPENSIM DEMI- KRONOLLOJIA

Musli Krasniqi C.nr.124/20 – Kemi pranuar Padi nga Gjykata themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, Kampania eshte paditur nga Puntori Musli Krasniqi i cili ne padi kerkone kompenzimin e pagava jubilarë. Zyra ligjore brenda afatit ka paraqitur Pergjigje ne Padi. Presim caktimin e shqyrtimit fillestar nga Gjykata.

A. Zajmi C.nr. 416/213 . Kontest për kompensim demi material .Kompania palë paditëse . Pas shqyrtimit të çështjes në procedurë të rregullt dhe përfundimit të seancave Gjykata merr Vendim ne te mirë të të paditurit. Kompania ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Kontesti është në vazhdim te shqyrtimit.

Bashkim Hasi,– C.nr.696/18 Rasti është në procedurë kontestimore për kompensimin e demit. Me kërkesë te paditurës është caktuar ekspertiza nga ana e Gjykatës, presim konkluzioni e ekspertizës Kontesti ne vazhdim te procedurës.

Pjeter Dema – C.nr. 206/08 .Kompania pale e paditur . Zyra ligjore ka pranuar AKTGJYKIM-in C.nr.494/2015, nga Gjykata Themelore në Gjakovë, ku - REFUZOHET në tërësi si e pa Themeltë KËRKESËPADIA e paditësit. Paditësi ka bere ankesë ne gjykatën e Apelit te Prishtinës. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit

Avni Thaqin – C.nr. 475/2015 Kompensim demi .Kompania pale paditëse. Me revizion Kompania ka kthye lëndën ne rishqyrtim.Shqyrtimi i lendes është ne Shkallë te pare .Kemi kundërshtuar marrjen e vendimit te Gjykatës për caktimin e dy ekspertëve ne këtë çështje kontestimore . Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

KEDS SH.A. Prishtinë - C. Nr. 184/16 . Kompania pale paditëse. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit .Gjykata ka caktuar Ekspertin për konstatimin e dëmit. Ekspertiza ne favor të Kompanisë. Gjykata me Aktgjykim ka aprovuar kërkesëpadinë e Kompanisë ne vlerë prej 5,455.91 euro me kamat 8%. Kompania KEDS SH.A. Prishtinë ka ushtruar Ankese për Gjyk. Apelit – Prishtinë, Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Drilon Casanova, dhe Valdrin Verandas DaSilva, - C.nr. 55/18. Padi për kompensim demi. Kompani palë e paditur .Kemi pranuar Aktvendimin e gjykatëse ku pjesërisht është miratuar kërkesëpadia e paditësi. Kompani ka bere ankese ne gjykatën e Apelit te Kosovës. Presim vendimin.

Bekim Kryeziu -C.nr.494/18 Padi për kompensim demi vlerën e kontestit prej 1,669.68 Euro. Kompani palë paditëse, kemi bërë Përgjigje në Padi të ushtruar në Gjykatën Themelore në

Gjakovë. Divizioni Civil. Presim mbajtjen e seancës të shqyrtimit paraprak. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Nesër Kuçi nga Komuna e Deçanit, -C.nr. 235/19. Padi për kompensim dëmi. Kompani palë paditëse . Kemi pranuar thirrje për seancën e shqyrtimit fillestar, ku me kërkesën te palës paditëse është Ndërprere procedura deri ne kryerje e trashëgimisë. Kemi pranuar Aktvendimin C.nr.235/19 në çështjen kontestimore ku është ndërprerë Procedura.

Murat Hoti nga F.Sh. Ratkoc KK. Rahovec C.nr. 228/18 Padi për kompensim dëmi vlerën e kontestit prej 886.00 Euro. Kompani palë e paditur . Është mbajtur seanca e shqyrtimi përgatitor është caktuar eksperti i Bujqësisë, kemi kundërshtuar ekspertizën e ekspertin presim Aktgjykimin e Gjykatës. Kemi pranuar Aktgjykimin i cili ka aprovuar ne tersi kërkesëpadinë. Kompania ka bere ankese ne gjykatën e Apelit. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Gasper Ceta, -C.nr.4/19 Padi për largimin e borxhit, vlerën e kontestit prej 736.81 Euro. Kompani palë e paditur. Presim mbajtjen e seancës të shqyrtimit paraprak. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Labinot Rexha nga Rahoveci, A.nr.255/2018 Padi për largimin e dënimeve administrative, vlerën e kontestit prej 736.81 Euro. Kompani palë e paditur .Kemi bërë Përgjigje në Padi të ushtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec. Divizioni Civil. Presim mbajtjen e seancës të shqyrtimit paraprak.

Burim Salih Hasanaj, Sahit Fazli Hasanaj, dhe Arbnor Isë Hasanaj. –C.nr. 207/2019 . Propozim i propozuesit i paluajtshmërisë .Ne Aktvendim e Gjykatës është hedhur Poshtë si të pa lejuar propozimin e Propozuesve ndaj kundërpropozuesit K.R.U. “ Gjakova” Sh. A . Pala propozuaese ka bere Ankese ne Gj. Apelit te Kosovës. Kemi pranuar Aktvendimin nga Gjykata e Apelit ku refuzohet ankesa. Propozuesit kane dorzuar kerkese per Revizon në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Pompa e benzines ”Stella”Sh.p.k, -C.nr. 55/18. Padi për kompensim dëmi. Kompania palë e paditur .Kemi pranuar Aktvendimin e gjykatëse ku është refuzuar ne tersi padia – kërkesëpadia e paditësit. Paditësi ka bre ankese ne gjykatën e Apelit te Kosovës. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Visar Gashi nga Rahoveci, A.nr.255/2018 Padi për kompensim dëmi. Kompani palë e paditur, vlerën e kontestit prej 5,000.00 Euro. Kemi pranuar fletëthirrje nga gjykata për mbajte te seancës. Pas mbajtjes se disa seancave me propozim te gjykatëse është arritur pajtim gjyqësorë. Me marrëveshje është bere kompensimi i demit ne vlere pre 2,000.00. Lënda ka përfunduar ne tersi.

Ismet Musa Alija nga F.Sh. Batush KK. Gjakovë C.nr. 1754/21. Padi për kompensim dëmi vlerën e kontestit prej 10,000.00 Euro. Kompani palë e paditur. Kompania ka dorëzuar përgjigje në padi.

Albion Neki Morina nga F.Sh. Nushpall KK. Rahovec C.nr. 341/20. Padi për kompensim dëmi vlerën e kontestit prej 1,000.00 Euro. Kompani palë e paditur. Kompania ka dorëzuar përgjigje në padi.

Metush Hoti, KK. Rahovec C.nr. 570/21. Padi për kompensim dëmi vlerën e kontestit prej 900.00 Euro. Kompani palë e paditur. Kompania ka dorëzuar përgjigje në padi.

K.R.U. "Gjakova", ka iniciuar Padi për Kompensim demi – Kundër Komunës së Junikut. Padia është dorëzuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës – Departamenti për Çështje Ekonomike, ende nuk kemi pranuar përgjigje në padi, apo caktim të seancës nga ana e Gjykatës.

Kompania K.R.U. "Gjakova", ka ushtruar Ankesë kundër Aktvendimit nr.21-INS-P-I4ITGJ-06 të dt. 09.08.2021 të Inspektoratit të MMPHI-së, ku është gjobitur Kompania në vlerë prej 5.000.00. Kompani nuk ka pranuar as një vendim nga organi i shkalles së dytë. Kompani ka pranuar njoftim për iniciimin e procedurës përmbartimore lidhur me vendim të Inspektoratit të MMPHI-së. Kompani ka ushtruar Kundërshtim kundër këtij Njoftimi.

Zyra ligjore ka pranuar Urdhrin për Përmbartim të Aktvendimit nr.21-INS-P-I4ITGJ-06, në afatin ligjor kemi dorëzuar kundërshtimin. Po ashtu Kompania ka dorëzuar Ankese për shkak të heshtjes Administrative të MMPHI-së lidhur me ankesën kundër Aktvendimit Nr.21-INS-P-I4ITGJ-06 të dt. 09.08.2021.

K.R.U. "Gjakova", Padi për iniciimin e konfliktit administrativ, me numër të lendes **A.nr.1026/19** për anulimin e vendimit të Ministrit për financa – Administrata tatimore e kosovare – Departamenti për ankesa. ende nuk kemi pranuar përgjigje në padi, apo caktim të seancës nga ana e Gjykatës. Lënda në vazhdim të shqyrtimit. (Në Gjykatën Themelore të Prishtinës – Departamenti për çështje Administrative).

K.R.U. "Gjakova", ka iniciuar Padi për Vërtetim të Pronësisë me numër të lendes **C.nr.1524/19**. Padia është dorëzuar në Gjykatën Themelore të Gjakovës në Divizionin Civil. Padia është ushtruar kundër – Ministria e Bujqësisë – Agjencinë Kosovare të Pyjeve, si pas-ardhës juridik i Ekonomisë Pyjore, Komuna e Gjakovës. Kemi pranuar përgjigje në padi. Presim caktimin e seancës nga ana e Gjykatës. Lënda në vazhdim të shqyrtimit. (Në Gjykatën Themelore të Gjakovës – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil).

K.R.U. "Gjakova", ka iniciuar Padi për kompensim demi ndaj ish punëtorëve të sajë: Nexhat Sefa. Shkendrit Cingu. dhe. Enxhell Marku

Shkendrit Cingu - K.R.U. "Gjakova", ka iniciuar Padi për kompensim demi, kemi pranuar përgjigje në padi, presim caktimin e seancës përgatitore nga Gjykata.

Nexhat Sefa - K.R.U. "Gjakova", ka iniciuar Padi për kompensim demi, kemi pranuar përgjigje në padi, presim caktimin e seancës përgatitore nga Gjykata.

Ministria e Bujqësisë – Agjencioni Kosovare të Pyjeve - K.R.U. "Gjakova" ka dorëzuar Propozim për ndërrimin e palujtshmerive – ngastrave kadastrale. Propozuesi - KRU GJAKOVA. Sh. A. Gjakovë. Kundër propozuesi – Ministria e Bujqësisë – Agjencioni Kosovare të Pyjeve, Presim caktimin e seancës nga ana e Gjykatës. Lënda në vazhdim të shqyrtimit. (Në Gjykatën Themelore të Gjakovës – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil).

K.R.U. "Gjakova", ka iniciuar Padi për Vërtetim të Pronësisë – Kundër Komunës së Rahovecit. Padia është dorëzuar në Gjykatën Themelore të Gjakovës – Dega Rahovec, kemi pranuar përgjigje

ne padi, presim caktim te seancës nga ana e Gjykatësë. – Po ashtu kemi dorëzuar parashtrese për caktimin e mase se përkohshme

Ç'ESHTJET PENALE

Zenel Muharrem Thaqi , - Zyra ligjore me kërkesë te Kompanisë ka ngritur Kallëzim Penal ndaj konsumatorit Zenel Muharrem Thaqi – Xërxe komuna e Rahovecit, ne dyshimin e bazuar sa ka kryer veprën penale te ndotjes se ujit te prijëse, Kallëzimin penal e kemi dorëzuar ne prokurorinë themelore te Gjakovës. Zyra ligjore ka pranuar AKTVENDIM-in PP/II.nr.1262/2019, nga Prokurua Themelore në Gjakovë, ku e HUDHË kallëzimin penal me arsyetimin se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepër penale. Nuk kemi te drejtën e ankesës.

Agron Kuqi, - Zyra ligjore me kërkesë te Kompanisë ka ngritur Kallëzim Penal ndaj Kryetarit te Komunës se Junikut z. Agron Kuqi, ne dyshimin e bazuar sa ka kryer veprën penale te pengimit te personit zyrtar ne kryerjen e detyrave te punese, si dhe ke bere thirrje për protestë gjithë populllore te sanksionuara me kodin penal te Kosovës. Nga organet e policisë se Kosovës, janë ftuar ne intervistë zyrtaret e kompanisë, po ashtu nga prokuroria janë ftuar zyrtaret ne pyetje nga prokurori i shtetit i cili miret me këtë raste. Kemi pranuar Aktvendim nga Prokuroria Themelore e Prizrenit – Departamentit për Krime te Renda, ku ne baze te aktvendimit kanë pushuar hetime ndej kryetarit te Komunës se Junikut z. Agron kuqi, ne baze te aktvendimit jemi udhëzuar ne kontest civil për kompensim dëmi. Jemi ne përgatitje te Padisë kundër Komunës se junikut.

Ali Muhamet Gjihollaj Zyra ligjore me kërkesë te Kompanisë ka ngritur Kallëzim Penal ndaj të dyshuarit Ali Muhamet Gjihollaj, kyçje ilegale të pa autorizuar në rrjetin shpërndarës të ujësjellësit. Kemi pranuar URDHËRES nga Prokuroria Themelore në Gjakovë për ta plotësuar KALLËZIM PENAL, të ngritur ndaj të dyshuarit Ali Muhamet Gjihollaj. Zyra ligjore ka dorëzuar Plotësimin e Kallzimit Penal sipas shkresave të cilat gjinden në lende. Kemi pranuar Aktgjykimin e gjykatësë te cilin e kanë shpallur fajtor, për dëme ekonomike jemi udhëzuar ne kontest civil.

Mentor R. Gashi - fsh. Xërxe komuna e Rahovecit, Zyra ligjore me kërkesë te Kompanisë ka ngritur Kallëzim Penal ndaj të dyshuarit Mentor Gashi. Kallëzimi penal eshte dorzuar në Prokur - rasti i inicuar është për keqperdorim të shërbimeve të ujësjellësit të sanksionuara ne baz të nenit 264 të KPRK-së.

Jeton Sadik Lulaj - fsh. Ratish i Ulët, Komuna e Deçanit Zyra ligjore me kërkesë te Kompanisë ka ngritur Kallëzim Penal ndaj të dyshuarit Jeton Sadiku Kallëzimi Penal eshte dorzuar në Prokurorin Themelore në Gjakovë ndaj të dyshuarit. Rasti i inicuar është për Peshkim të Kundërligjshëm të sanksionuara ne baz të nenit 353 të KPRK-së. Zyra ligjore ka pranuar AKTAKUZË nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, kundër të pandehurit Sherif Kuçana nga fsh. Buçaj Rep. e Shqipërisë tani me banim ne Nivokaz komuna e Gjakovës ku i njëjti është i ngarkuar me Vepër Penale nga Neni 357 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Brahim Sejdi Rexhepi- nga Gjakova- Zyra ligjore me kërkesë te Kompanisë ka ngritur Kallëzim Penal ndaj të dyshuarit Jeton Sadiku Kallëzimi Penal eshte dorzuar në Prokurorin Themelore në Gjakovë ndaj të dyshuarit. Rasti i inicuar është për Peshkim të Kundërligjshëm të sanksionuara ne baz të nenit 353 të KPRK-së.

Prend Kola nga fsh. Sopot KK. Gjakovë - Zyra ligjore ka pranuar AKTAKUZË nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, kundër të pandehurit Prend Kola nga fsh. Sopot KK. Gjakovë. Ku i njëjti është i ngarkuar me Vepër Penale nga Neni 357 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës

së Kosovës. Ndërsa kanë pushuar hetime sa i përket veprës penale Vjedhja e Pyllit e parashikuar me nenin 158 par 1, të KPRK-së.

KONTESTE KOMPENSIM BORXHI - KRONOLOGJIA PERSONA JURIDIK

Post Telekom i Kosovës –PP nr. 164/16 Padi kompensim borxhi . 1,180,75 Kompania palë paditëse . Kemi pranuar vendimin e gjykatës se Apelit ku lënda është rikthyer ne ri vendosje. Kemi pranuar fletëthirrje për caktimin e seancës kryesore, zyrtari ligjore është paraqitur ne seancë presim Aktvendimin e Gjykatës. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Stadimi i Qytetit – 2189. Kompania ka pranuar Aktvendimin AC.nr.2382 te Gjykatës se Apelit ku gjykata e ka vërtetuar Aktvendimin e Gjyk. Themelore te Gjakovës. Aktevendimi është dorëzuar tek përmbartuesi privat për ekzekutim te mjeteve ne Thesarin e Kosovës. Presim ekzekutimin e mjeteve nga përmbartuesi privat sipas aktvendimit te gjykatës se Apelit te Kosovës. Kontesti ne vazhdim.

Stadimi i Qytetit – 3937. p.nr.544/18. Kemi pranuar Aktvendimin nga gjykata është ne te mire te Kompanisë, debitori ka bere Ankese ne si kompani kemi bere përgjigje ne Ankese. Presim vendimin e Gjykatës se Apelit te Kosovës. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Komuna e Rahovecit – Objekti në Xerxe P.nr. 253/18. Zyra ligjore ka pranuar Aktvendimin PPP.nr.142/18 nga Gjykata Themelore dega në Rahovec, ku Gjykata **Pjeserisht e Aprovon** prapsimin e debitorit për borxhin 6,009.82 Euro si e parashkruar, mbetet në Fuqi Urdhëri për borxhin **204.78 Euro** si jo e parashkruar. Zyrja ligjore brenda afatit ka bërë Ankesë për Gjykatën e Apelit, presim vendimin e Gjykatës. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Komuna e Rahovecit ‘Zjarrfikësit Ratkoc’,C.nr.3/2014 - Gjykata Themelore Dega në Rahovec, Gjykata e **REFUZON** Padin (propozimin pre përmbartim) te kompanisë. Me parashtrese kemi kërkuar që të Aprovohet kërkesëpadia e precizuar e dt. 07.11.2019 me nr.2590 në shumën prej 647.06 Euro. Zyra Ligjore brenda afatit ligjor ka bërë Ankesë në Gjykatën e Apelit. Presim aktvendimin e gjykatës.

Debitor: KRU. Gjakova. – Kreditor: “ Korporata Energjetike e Kosovës – P.nr.835/18. Kemi dorëzuar Kundërshtim kundër urdhrin te Përmbartuesit Privat. Z. Enis Hoxha, sipas aktvendimit kemi bere pagesën e taksës gjyqësore. Lënda ne vazhdim te procedurës.

Komuna e Gjakovës - P.nr.937/19. Vlera 66,503.96 euro. Ndaj propozimi për përmbartim debitori ka ushtruar prapsim, brenda afatit ligjor është bere përgjigje ne prapsim, presim Aktvendimin e Gjykatës - kemi mbajtur seancë debitori i ka kryer të gjitha obligime. Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Telekomi Drejtoria - Gjakovë - P.nr.743/21. Debitori ndaj propozimi për përmbartim ka ushtruar prapsim, brenda afatit ligjor është bere përgjigje ne prapsim, Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

KEDS- TS - Prizren - P.nr.54621. Debitori ndaj propozimi për përmbartim ka ushtruar prapsim, brenda afatit ligjor është bere përgjigje ne prapsim, Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Posta e Kosovës SH.A. - Rahovec - P.nr.763/21. Debitori ndaj propozimi për përmbartim ka ushtruar prapsim, brenda afatit ligjor është bere përgjigje ne prapsim, Lënda ne vazhdim te shqyrtimit.

Paditurës Komuna e Gjakovës - kemi pranuar Aktvendimin Ac.nr.199/17, nga Gjykata e Apelit të Kosovës, në çështjen Juridike Kontestimore të paditurës Komuna e Gjakovës 'Fondi për Rregullimin e Tokave-Banesave' – C.nr.29/16, – **APROVOHET** e bazuar ankesa e përfaqësuese së autorizuar të paditurës Komuna e Gjakovës 'Fondi për Rregullimin e Tokave-Banesave' – PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe lënda kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

1. Lendet e procesuara te permbaruesi privat per komp. borxhi - 2021

Raporti i prezantuar ne formë tabelore i Kërkesave për Ekzekutim **Persona Juridik**, te dërguara tek Përmbauesit Privat gjatë vitit **2021** nga K.R.U "Gjakova" SH.A. –Gjakovë

VITI 2021	Nr. i Kërkesave	Vlera e përgjithshme ne euro
Numri i përgjithshëm i Kërkesave te dërguara te Përmbauesit Privat	60	271,092.85 euro
Nr. i kërkesave te përfunduara nga Përmbauesit Privat	15	
Në procedurë të përmbaimit - Gjykatë	19	
Rastet të pa përfunduara (debitor pa llogari bankare, ose pa të ardhura, ose debitor te vdekur)	26	

Raporti i prezantuar ne formë tabelore i Kërkesave për Ekzekutim **Persona Fizik**, te dërguara tek Përmbauesit Privat gjatë vitit **2021** nga K.R.U "Gjakova" SH.A. –Gjakovë

VITI 2021	Nr. i Kërkesave	Vlera e përgjithshme ne euro
Numri i përgjithshëm i Kërkesave te dërguara te Përmbauesit Privat	230	244,583.94 euro
Nr. i kërkesave te përfunduara nga Përmbauesit Privat	36	
Në procedurë të përmbaimit - Gjykatë	44	
Rastet të pa përfunduara (debitor pa llogari bankare, ose pa të ardhura, ose debitor te vdekur)	150	
Vlera totale e inkasuar për vitin 2021 nga te gjitha lendet që janë në procedurë.	totali	132,812.04 euro

Veprimat e Zhvilluar ne Departamentin e Burimeve Njerëzore

Në Departamentin e Burimeve Njerëzore në vazhdimësi janë realizuar të gjitha aktivitetet dhe kërkesat e nevojshme që dalin nga marrëdhënia e punës në përputhje me kërkesat e stafit të kompanisë dhe dispozitave ligjore ne fuqi.

BNJ luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e suksesit të ardhshëm të KRU-Gjakova Sh.a, duke vepruar kështu, udhëhiqet nga vizioni i saj afatgjatë për të punuar dhe për të krijuar një mjedis ku punonjësit mund të lulëzojnë, dhe për të ofruar performancë të qëndrueshme organizative. Veçanërisht, disa prioritete strategjike afatgjata janë identifikuar për BNJ si më poshtë :

- Për të aplikuar ekspertizën e kapitalit njerëzor në mënyrë më bindëse për të mbështetur zhvillimin dhe zgjerimin e kompanise në të ardhmen, edhe në sektorin e ujerave të zeza.
- Për të ndërtuar dhe permiresuar aftësitë e menaxherëve dhe stafit permes trajnimeve të vazhdueshme.

Në vitin 2021, aktivitetet tona të BNJ-së janë në përputhje me këto prioritete, të cilat kanë qenë në fokus të veçantë të kompanise dhe në pajtim me Manualin e BNJ dhe Planin e Biznesit, dhe zbatimi i tyre në të ardhmen.

Departamenti i Burimeve Njerezore duhet të menaxhojë kontratën e punës duke:

- Siguruar që kushtet e çdo kontratë të punës të përmbushen plotësisht bazuar në ligjet dhe rregulloret e brendshme/udhëzimet administrative.
- Siguruar se parimi i drejtësisë bazuar në ligjet përkatëse është përmbushur plotësisht.
- Përcaktimi i kushteve të shërbimit është përcaktuar dhe plotësuar , për shembull, për ndërprerje të marrëdhënies kontraktuale, njoftimi paraprak është dhënë sipas ligjeve në fuqi, ose në vend të njoftimit bëhet një pagesë kontraktuale.
- Dhe, kur Departamenti I BNJ përballët me sfida ligjore, konsultohet me departamentin administrative/njesine ligjore.

Departamenti i Burimeve Njerezore përbëhet nga dy punonjës me orare të plotë të cilët janë të përkushtuar për të ofruar shërbimet më të mira të mundshme për kompaninë. Këto dy pozicionet përfshijnë:

1. Drejtorin e Burimeve Njerezore, dhe
2. Specialisten e Departamentit të Burimeve Njerezore.

Çdo anëtar i ekipit të BNJ është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve më të mira të mundshme për të gjithë punonjësit e K.R.U-Gjakova SH.A.

Nr .	LISTA E AKTIVITETEVE, VEPRIMEVE DHE VENDIMEVE TË CILAT JANË PËRPILUAR, PËRFUNDUAR/ EKZEKUTUAR GJATE MUJIT JANAR - DHJETOR 2021	
1	Përpilimi/ndryshim plotësim i rregullores për sistematizim te punëve dhe detyrave të punës-dhe rregullores për Pagat te KRU Gjakova.	2
2	Përpunimi i tabelarit të pagave.	1
3	Përpilimi i kërkesës me ndryshim plotësimet e Rekës së Keqe dhe ujerave te ndotura.	1
4	Përpilimi i raporteve te ndryshme për nevojave të kompanisë dhe bordit të drejtorëve.	1
5	• Përpilimi i vendimeve për ndërprerje te marrëdhënies se punës dhe ekzekutimi i tyre. • Përpilimi I vendimeve për pagës përcjellëse me rastin e vdekjes se punëtorit dhe ekzekutimi i tyre. • Përpilimi i vendimit pune shtese, • Vendime për ri sistemim te brendshëm, • Vendim për pushim me pagesë-rast vdekje te babait te tij,	57

	• Përpilimi i vendimit për shpërblimin e punëtorëve dhe ekzekutimi i vendimeve, • Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, • Përpilimi i vendimit për pagesë përcjellëse me rastin e pensionimit, • Përpilimi i vendimit për lirim të përkohshëm nga puna e punëtorit, • Përpilimi i vendimit të pushimit vjetor për 2 punëtor në përpjesëtim me kohën e kaluar në punë, • Përpilimi i vendimit të punës shtese, përveç atyre të përcaktuara me kontratën e punës. • Përpilimi i vendimit për shpërblim të punëtorëve dhe ekzekutimi i vendimeve, • Përpilimi i vendimit për pension të punëtorit , • Pagesë përcjellëse për pensionim , • Përpilimi i vendimit për zëvendësim të anëtarit të komisionit disiplinor, • Vendim –ushtrues detyre, • Vendim për punë shtese, • Përpilimi i vendimit për pushim pa pagës, • Vendime për shpërblime të punëtorëve , • Përpilimi i vendimeve për pushim pa pagesë , • Vendim për punë praktike, • Vendim për ushtrues detyre, • Vendim për punë shtese, vendim për pushim me pagës, • Ekzekutimi i vendimit për shpërblime të punëtorëve (50) euro, • Vendim për punë praktike . • Vendime të pushimit vjetor për 2 punëtorët në përpjesëtim me punën e kaluar.	
6	Vazhdimi i Kontratave në kohë të caktuar,	70
7	• Përgatitja dhe publikimi i dy konkurseve për 2 pozita të punës : Menaxher i Sektorit të ujerave të ndotura dhe Punëtor fizik • Konkurse: Inxhinier i proceseve, kimiste, operator, elektrikist, mekanik, shofer kamionit, dy pozita punëtor fizik dhe punëtor në Çkyçje. • Përgatitja e dy konkurseve për Punëtor fizik, dhe zyrtar për projektim dhe zhvillim. • Përgatitja dhe publikimi i 2 konkurseve të punës për 2 pozita të punës : Inxhinier i Elektroteknikës dhe Mekanikës, • Publikim i konkursit : Auditorë i brendshëm dhe përpilimi i dy konkurseve për punëtor fizik • Publikimi i 3 konkurseve (KE dhe KZF dhe auditorë), publikimi i dy konkurseve: lexues dhe pastrues.	22
8	Kontrata me kohë të pacaktuar të përhershme	21

9	• Menaxhimi i procedurave të rekrutimit për pozitën e punës: Shef i Njesisë se leximit të ujëmatësve, Punëtor fizik. • Rekrutimi për pozita te reja inxhi. elektrikes dhe mekanikes, • Rekrutimi Drejtor Teknik, • Rekrutimi i Brendshëm Udhëheqës NJ.O. Reka e keqe ,dhe kryepunëtori i grupit të mirëmbajtjes se ujësjellësit, rekrutimi për pozitën zyrtare për projektim dhe zhvillim , • Menaxhimi i procedurave të rekrutimit për 6 pozita te punës ne ITUN, • Menaxhimi i procedurave të rekrutimit rekrutimi për pozitën lexues shpërndarës i faturave, rekrutimi për Drejtor i Departamentit Komercial dhe Arhivës.	17
10	Mbledhja e të gjithë formularëve te vlerësimit të performances	286
11	Skanimi i të gjitha dokumenteve sipas listës së kërkuara nga auditorët e jashtëm.	
12	Njoftimi i të gjithë gjitha kandidateve me telefon dhe me e-mail për pozitën e punës për testin me shkrim dhe intervistën me gojë.	
13	Njoftimi për rezultatet përfundimtare me telefon dhe me e-mail për personat e përzgjedhur dhe personat te cilët nuk janë përzgjedhur.	
14	Përpilimi i shkresës për anëtarët e komisionit te ankesave – ndaj vendimit të komisionit të përzgjedhjes.	1
15	Njoftimi me e-mail dhe me telefon i te gjitha kandidateve për pozitën e punës për testin me shkrim.	
16	Përgjigjja në ankesën me shkrim nga konkursi i publikuar për pozitën : Inxhinier i Mekanikës.	1
17	Përpilimi i shkresës për anëtarët e komisionit të ankesave – ndaj vendimit të komisionit të përzgjedhjes nga ankuesi.	1
18	Përgjigje të ndryshme për punëtor/kërkesa të ndryshme.	2
19	Referenca për pune praktike ne KRU-GJAKOVA SH.A, referenca për pune praktike, vërtetim për pune praktike.	13
20	Përgatitja e konkursit te brendshëm , për drejtor teknik, udhëheqës i NJ.O.Reka e keqe dhe kryepunëtori të grupit te mirëmbajtës se ujësjellësit, konkurs i brendshëm menaxher i prodhimit te ujit dhe udhëheqës i njësish operative.	5
21	Përpilimi i kontratës të punës për 8 punëtoreset ne ITUN ,përpilimi i dy kontratave: Udhëheqës i njësisë operative Reka e Keqe dhe Kryepunëtori i Grupit te Ujësjetlësit	10
22	Përpilimi i pushimeve vjetore /protokollimi për te gjithë punëtoreset e kompanisë	285
23	Përgjigjja në ankesën me shkrim nga konkursi i publikuar për pozitën : Inxhinier i Mekanikes	1
24	Kontrata e re e përpiluar ne baze te vendimit për përzgjedhjen e Drejtorit Teknik, përpilim i kontratës se re dhe sistematizimi ne vend tjetër te punës	2
25	Përpilimi i kërkesës për inicim te procedurës disiplinore për punëtor, Përgatitja e fletëthirrjeve për inicimin te procedurës disiplinore për punëtor.	12
26	Përgjigje të ndryshme për punëtoreset/kërkesa të ndryshme	

27	Plotësim /ndryshim i rregullores për sistematizimin te punëve detyrave te punës me e dy pozita te reja : Inxhinier i proceseve dhe shef i Njesisë së Arhives sipas rekomandimeve te konsulentëve dhe administratës.	1
28	Raporte të ndryshme për nevojat e kompanisë	6
29	Vërtetim për konfirmim të marrëdhënies së punës	1
30	Skanimi i te gjitha dokumenteve sipas listës se kërkuar nga auditorët e jashtëm	
31	Përgatitja e shpenzimeve te pagave te ndara ne 3 kategori (Aktivitet Biznes ore , Trajtimi I ujit ,kanalizim dhe ujerat e ndotura)	
32	Tabelari me ndryshime /pozitat e punës	1
33	Përpilimi i kërkesës drejtuar bordit te Drejtoreve lidhur me ndryshimin /plotësimin e rregullores	
34	Përpunimi i te dhënave për ditët e shfrytëzuar te pushimit vjetor/mjekësor	
35	Përpunimi ne Excel i te dhënave për punëtorit te cilët punojnë vikendeve.	
36	Përpilimi i procesverbalit për anulimin e konkursit: Menaxher i sektorit te ujerave te ndotura. Anulimi i konkursit për pozitën: Menaxher i sek.te ujerave te ndotura, anulimi i konkursit për punëtor Fizik dhe punëtor ne Çkyqja, anulimi konkursit: udhëheqës i njesisë operative Rahovec, anulim i konkursit :Zyrtar financiar dhe i thesarit .	6
37	Përgatitja e pagës në baze të % për Arkëtar/e të realizuara gjatë Muajit Shkurt2021	Çdo muaj
38	Analiza statistikore për numrin e femrave/meshkujve, grup - moshave, përkatësive etnike, departamenteve, shkollimit etj.	Çdo muaj
39	Përditësim i data bazës për punëtor në mënyre të vazhdueshme	Çdo muaj
40	Raport i anëtarësisë së sindikatës, barazimet/ akontacionet.	Çdo muaj
41	Menaxhimi ditor i hyrje/daljeve te punëtorëve, pushimeve vjetore, mjekësorë etj.	Çdo ditë
42	Pagat gjithnjë të llogaritura në kohen e duhur.	Çdo muaj
43	Llogaritja e pagave për të gjitha punëtorët në baze të karnetit për çdo departament/Njësi në baze të vendimeve, dhe akontacioneve të nënshkruara nga departamenti financiare të llogaritura me kohe dhe saktësi, të dërguara për ekzekutim tek Financat sipas afatit.	Çdo muaj
44	Kontrollimi ditor i hyrje/daljeve të punëtorëve dhe raportimi i rregullt për pushim dhe koordinimi i rregullt i pushimeve vjetore me udhëheqësit .	Çdo dite
45	Kontrollimi dhe barazimi i karnetave të orëve të punëtorëve me udhëheqësit kompetent.	Çdo muaj
46	Asistim dhëne punëtorëve në mbushjen e formularëve për pushim vjetor dhe koordinimi i pushimeve vjetore të punëtorëve me udhëheqësit kompetent.	Çdo dite

Tabelat e më poshtme paraqet numrin e punëtorëve dhe ndryshimet nga viti 2020-2021 dhe krahasimi sipas biznes planit.

Muaji	Dhjetor	2020	Numri i Përgjithshëm i punëtorëve	287
Muaji	Dhjetor	2021	Numri i Përgjithshëm i Punëtorëve	293

Muaji	Dhjetor	2021	Numri i Punëtorëve sipas planit të Biznesit të aprovuar	307
-------	---------	------	---	-----

Krahasimi i numrit të punëtorëve/sipas biznes planit 2020-2021 i paraqitur në diagram




Tabela - Numri i Përgjithshëm i Punëtorëve /dhe Edukimi i punëtorëve.

Nr. i përgjithshëm i punëtorëve	Meshkuj	Femra	TOTALI
Magjistër	4	7	11
Fakultet	48	26	74
Shkollë të Lartë	4	2	6
Shkollë të Mesme	150	13	163
Shkollë Fillore	34	5	39
Totali	240	53	293

Tabela - Numri i Përgjithshëm i Punëtorëve /dhe Edukimi i punëtorëve (%)

Kualifikimi i Punëtorëve -Gjendja : Dhjetor 2021						
KUALIFIKIMI						
Kualifikimi	Master	Fakultet	Shkolla e Larte	Shkolle e Mesme	Shkolle Fillore	Gjithsejte
	11	73	6	156	39	293
	3.75%	25.26%	2.05%	55.63%	13.31%	100.00%

Tabela e mëposhtme pasqyron ndarjen gjinore në kompaninë ku raporti është afërsisht 18 % deri 82% në favor të punëtorëve meshkuj.

Tabela : Numri i përgjithshëm i punëtorëve sipas gjinisë.

GJINIA	NR.	NR/%
Femra	53	18.09%
Meshkuj	240	81.91%
Total	293	100.00%

Tabela e mëposhtme pasqyron ndarjen gjinore në kompani ku raporti është afërsisht 18% deri 82% në favor të punëtorëve meshkuj.





Tabela e mëposhtme paraqet numrin e minoriteteve të përfshira në numrin e Përgjithshme të punëtorëve ku afërsisht 4% e punëtorëve i përkasin pakicave kombëtare/minoritete.

Nacionaliteti /Përkatësia etnike	Shqiptarë	Egjptas	Rom	Boshnjak	Turk	Totali
Numri Punëtorëve	282	7	1	2	1	293
Përqindja %	96.14%	2.39%	0.34%	0.68%	0.34%	100.00%

Tabela e mëposhtme paraqet numrin profilin e moshës së stafit të KRU- Gjakova ku 12.98% janë të moshës 60-65 vjeçare, 37.54% të punëtorëve janë të moshës nga 50-59 vjeçar, 18.60 % janë të moshës 40-49 vjeçar, 19.65% janë të moshës 30-39 vjeçar dhe 11.23 % janë të moshës 20-29 vjeçar.


Mosha e punëtorëve	Numri i Punëtorëve	Përqindja-%
20-29	35	11.95%
30-39	60	20.48%
40-49	54	18.43%
50-59	107	36.52%
60-65	37	12.63%
	293	100.00%

Mosha mesatare e punëtorëve është 47 vjet.



Janë shtatë (7) Departamente Organizative në kuadër të kompanisë si më poshtë:

Nr.	Spektori	Nr. i punëtorëve
1	Departamenti i Administratës	38
2	Departamenti i Burimeve Njerezore	2
3	Departamenti i IT-së	4
4	Departamenti i Prokurimit	4
5	Departamenti Teknik -GJK	90
6	Njesia Operative-Prizren	24
7	Njesia Operative-Rahovec-	32
8	Njesia Operative-Rekë e Keqe	10
9	Departamenti Komercial	76
10	Departamenti Financiar	13
	Totali në të gjitha Departamentet	293



Pandemia Virusi Kovid 19 preku në masë të madhe të gjitha bizneset në Kosovë gjithashtu edhe Ndermarrjet Publike . Ne KRU "Gjakova" Sh.A. nga virusi u infektuan disa punëtorë ,ndërsa në zbatim të Vendimeve të Qeverisë së Kosovës disa punëtorë u ungazhuan të punojnë nga shtëpia si dhe një pjesë tjetër të mbesin në shtëpi në ruajtje të shëndetit të tyre për shkak të moshës apo edhe sëmundjeve tjera përcjellëse .

Veprimtaria e zhvilluar nga Departamenti i Teknologjisë Informatike gjatë vitit 2021

Departamenti i Teknologjisë Informatike

Departament të Teknologjisë Informatike (DTI) është departament i cili është në shërbim të gjitha departamenteve dhe njësive tjera të kompanisë dhe i cili ua lehtëson atyre punët në fusha të ndryshme të veprimtarisë. Kur flasim për Departamentin e Teknologjisë Informatike atëherë kemi të bëjmë me një Departament i cili është në garë të përhershme me teknologjinë dhe ku arritja e një caku nuk do të thotë përfundim i garës, por vazhdim i garës me një aleat më shumë.

Teknologjia Informatike është lëmi që ka pas zhvillimin më të hovshëm teknik në tri dekadat e fundit. Rrjedhimisht në punën e këtij departamenti është vështirë të vendoset kufiri i qartë mes objektivit dhe arritjes së tij, sepse sapo të arrish një objektiv, shfaqet tjetri me më shumë sfida se ai paraprak.

Kompleksiteti i sistemit tonë kërkon që mirëmbajtja e tij të jetë e vazhdueshme, e menjëhershme, pa vonesa dhe mundësisht me zgjidhje të gatshme.

Për fat të mirë vitet e fundit nuk kanë munguar investimet në këtë sektor dhe kjo dukshëm e ka përmirësuar funksionalitetin e sistemit si tërësi, por investimet kryesisht janë fokusuar në pjesën hardverike të sistemit. Mungesa e një programi aplikativ të ERP-së, ka krijuar një zbrazëti të madhe për tërësinë e sistemit, për të cilën ende nevojiten shume investime ashtu që, në mos të mbushet tërësisht, atëherë së paku të zvogëlohet kjo zbrazëti. Kompania në bashkëpunim me konsulentët e jashtëm ka përpiluar një dosje të plotë të tenderit për prokurim ndërkombëtar të këtij programi. Departamenti i TI ka dhënë kontributin e saj maksimal në përpilimin e Specifikave Funksionale të programit ERP dhe në përpilimin e kushteve të konkurrimit, pasi që tenderi është paraparë që të zhvillohet me procedura ndërkombëtare të prokurimit. Dosja e Tenderit për ERP i është dërguar edhe donatorit të mundshëm për financim të furnizimit me paketën softuerike, Bankës Gjermane për Zhvillim - KfW për komente dhe Mos-kundërshtimin e tij, por mungesa e fondeve ka shkaktuar që ky softuer të mos mund të tenderohet ende.

Departamenti është fuqizuar me personel adekuat në lëmit e veçanta të TI dhe kryen me përgjegjësi detyrat e përcaktuara me përshtatjen e vendeve të punës.

Përveç organizimit të brendshëm të departamentit me ndarjen e punëve dhe përgjegjësi, Departamenti i TI ka kryer edhe të gjitha detyrat që i janë caktuar dhe që kanë dalë si pasojë e aktiviteteve të kompanisë.

Por mungesa e njohurive më të thella për teknologji informatike, kërkon që stafi përgjegjës për Teknologji Informatike në kompani, të jetë gjithmonë në dispozicion të shfrytëzuesve të resurseve informatike të kompanisë edhe për çështjet më triviale. Thellimi i njohurive të shfrytëzuesve të resurseve informatike të kompanisë për Teknologji Informatike do të rriste efikasitetin e shfrytëzuesve të resurseve informatike të kompanisë dhe kjo është paraparë që të bëhet në kuadër të Manualit të Politikave të Burimeve Njerëzore.

Përveç sfidave të cilat janë përmendur në veçanti për secilin sektor veç e veç, një sfidë e përgjithshme e departamentit të teknologjisë informatike është procedura e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve. Ligji i Prokurimi publik vështirëson shumë blerjen e pajisjeve dhe shërbimeve specifike që janë të nevojshme për mbarëvajtjen e punëve në këtë departament. Po ashtu, për shkak të pandemisë COVID-19, tregu i mallrave dhe shërbimeve të TI këtë vit ka qenë fluid dhe shumë i paqëndrueshëm. Kjo ka bërë që çmimet dhe livrimi i mallrave të jetë i paparashikueshëm si në vlerë ashtu edhe në kohë.

Përgjithësisht punët në Departamentin e Teknologjisë Informatike të K.R.U." Gjakova"sh.a. - Gjakovë gjatë vitit 2021 kanë shkuar mbarë. Gjatë vitit 2021 kemi pas suksese por edhe sfida. Ato janë përmendur më poshtë veç e veç sipas sektorëve të DTI.

Sektori i Administrimit të Sistemi Kompjuterik. Në fillim të vitit 2021 sistemi ka përjetuar ngjarjen më të rëndë që nga themelimi i departamentit të TI ku Serveri kryesor i administrimit të domenit të kompanisë, DHCP-së dhe Active Directory, ka rënë për shkak të prishjes së një pjese e cila nuk gjindej në treg. Me një angazhim të shtuar të stafit të DTI, kemi arritur që të funksionalizojmë dhe përmirësojmë sistemin me tipare të reja të cilat nuk i kemi patur në konfigurimin e vjetër.

Por menjëherë pas stabilizimit të sistemit, ndodh një ngjarje tjetër globale ku një përditësim i Sistemit Operativ Windows 10 shkaktonte probleme me printim në kompjuterët që përditësoheshin në këtë Sistem Operativ. Kjo na ka detyruar që për një periudhë të caktuar kohore ne të ndalim përditësimet e rregullta të SO duke rrezikuar sigurinë e sistemit por duke qenë vigjilent për çfarëdo vulnerabiliteti të mundshëm.

Gjatë vitit kemi bërë një inventar të pajisjeve të TI dhe një incizim të performancës individuale të pajisjeve. Këto informata janë futur në një tabelor në formatin Excel dhe ky tabelor është përditësuar vazhdimisht me informata të reja. Ky ushtrim na ka dhënë një informatë shumë të rëndësishme rreth pajisjeve të TI si dhe aftësive të këtyre sistemeve për të përballuar punët me të cilat ngarkohen, por po ashtu ka shërbyer edhe për përpilimin e listës së prioriteteve për furnizimi me pajisje të TI. Ky format do të shfrytëzohet gjithmonë para se të vendoset për furnizim me pajisje të TI.

Departamenti i TI po ashtu ka përpiluar edhe Specifikacionin Teknik të pajisjeve që duhet të blihen në kuadër të procesit të prokurimit të pajisjeve të Teknologjisë Informatike të Kompanisë për vitin 2022.

Për shkak të rënjes së performancës së disa kompjuterëve kemi nisur një fushatë të zëvendësimit të disqeve të forta HDD të kompjuterëve me disqe SSD, të cilët e kanë rritur performancën e kompjuterëve për së paku 30%.

Edhe këtë vit, një përparësi e madhe i është dhënë mirëmbajtjes së porto-arkave mobile, të cilat për shkak se gjatë gjithë kohës ndodhen në teren, ato duhet të jenë në gjendje të funksionojnë pa probleme. Për këtë arsye prokurimi i pajisjeve teknologjike në këtë vit është fokusuar në furnizimin

me pajisje të reja të këtij sektori. Kjo rezultoi shumë e qëlluar sepse porto-arkat mobile këtë vit kanë pasur një performancë shumë më të mirë se viteve të kaluara pikërisht për shkak të këtij furnizim, sepse problemet e raportuara nga ky sektor kanë qenë minimale dhe kryesisht që janë zgjidhur me kapacitete të brendshme.

Sektori i Administrimit të Sistemi Kompjuterik ka bërë mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve të cilat kanë pasur defekte ose ka pasur probleme me punën e tyre si dhe ka ofruar asistencës në punë për të gjithë operatorët që kanë pasur probleme me softuerët e ndryshëm. Formatimet e plota të

sistemit operativ, janë tregues i cenueshmërisë së sistemit për shkak se disa sisteme janë pa licenca e sidomos ato të vjetrat.

Spektori i Administrimit të Rrjetit Kompjuterik- në këtë sektor jemi ballafaquar me disa probleme për shkak se, gjatë punimeve të rehabilitimit të objektit të drejtorisë, janë shkatërruar pothuajse të gjitha kanalet për strehimin e kablllove. Me këtë rast, sektori ka bërë menaxhimin e kablllove në të gjitha zyrat ku ka qenë gjendja më e keqe dhe zyrat tjera ku ka pas nevojë si pasojë e ndërrimit të planimetrisë së zyrës nga të punësuarit.

Sivjet edhe neve na është shfaqur një problem i cili ka filluar që të shfaqet globalisht e ai është pamjaftueshmëria me brezin e IP adresave dhe disa herë na ka ndodhe që të mos kemi IP te lire për përdoruesit ne Scopin e Internetit në DHCP. Pas llogaritjeve të nevojshme të subnetave kemi aplikuar te ISP dhe kemi marrë numër të mjaftueshëm te IP adresave për kompani.

Sivjet ka filluar të na shkaktoj problem edhe pajisja qendrore e rrjetës (centrali-switch-i) sepse në disa raste na ka dalë nga konfigurimi dhe na është dashtë që ta konfigurojmë sërish. Për fat rrjeta është e organizuar në VLAN dhe problemet ishin të izoluara në VLAN-in që kanë pas problem dhe jo në tërë sistemin.

Një problem tjetër paraqet përdorimi Wireless Router-ave në ato mjedise ku nuk ka rrjetë LAN për shkak të ndërrimit të planimetrisë së objektit gjatë rehabilitimit të tij. Routerët pa tela janë një mjedis mjaft i cenueshëm dhe gjatë procesit të rehabilitimit të rrjetit të kompanisë, ata janë paraparë të reduktohen në gjithsejta 3 cope, por me masa shtesë të sigurisë për të gjithë ata që do ti përdorin.

Ne tashmë e kemi filluar një proces të ristrukturimit të rrjetës pa tela duke i rikonfiguruar Wireless Routerat në Acces Point dhe duke mundësuar qasje të integruar dhe siguri më të madhe në qasje të rrjetës pa tela të kompanisë.

Në kuadër të tenderit për prokurimin e ERP, është paraparë edhe rindërtimi i plotë i rrjetës kompjuterike në drejtori dhe në të gjitha njësitë e kompanisë duke shfrytëzuar teknologjitë e reja dhe pajisjet më moderne të rrjetëzimit kompjuterik. Ne kemi përpiluar projektin dhe specifikacionin me paramasat dhe paralogari për materialin e nevojshëm për ndërtimin e rrjetës së re kompjuterike të kompanisë, e cila është përfshirë në dosjen e tenderit për prokurimin e ERP.

Spektori i Administrimit të Bazave të Dhënave, Web faqes dhe ERP – Bazat e të dhënave të kompanisë mbesin aseti më i vlefshëm jo-material i kompanisë dhe si i tillë duhet të ju kushtohet vëmendja më e madhe e mundshme. Ky sektor në fillim të vitit ka mbetur pa punonjësin që e mbulonte këtë sektor sepse ai vullnetarisht e ka lëshuar punën. Kjo na ka shkakuar shumë problem në fillim por me angazhimin e një punonjësi që ka punuar në faturim dhe që ka njohuri shumë të mira për DB, ky vakuum u plotësua. Angazhimi i punonjësit të faturimit e ka ndihmuar shumë sektorin edhe për një arsye sepse duke punuar në faturim punonjësi kishte njohuri shumë të mira se si funksionon sektori i faturimit dhe kjo na ka ndihmuar shumë në ballafaqimin me sfidat.

Në fillim të vitit kishim një mospërputhje prej 11.000 deri në 17.000€ në barazimin mes "Librit të shitjes" dhe "Librit Kryesor" për deklarimin e TVSH-se për Dyqanet, Entet dhe Industrinë. Me angazhimin e punonjësit të ri kjo diskrepancë mes këtyre dy librave është zvogëluar në 0.96€. Kjo u realizua duke i rishikuar dhe harmonizuar shërbimet e të gjithë konsumatorëve sepse këto mos barazime për deklarim te TVSH-se ne Financa kishin të bënin me mungesën e shërbimeve apo shërbimet jo adekuate tek konsumatorët.

Në shtator jemi ballafaquar me një problem serioz të performancës së MS SQL Serverit dhe kjo na ka detyruar përkohësisht ta zëvendësojmë serverin e kontabilitetit me një kompjuter të thjeshtë

deri sa e kemi gjetur zgjidhjen për problemin. Pas rregullimit të serverit të kontabilitetit, kemi bërë disa optimizime të programit dhe problemi u rregullua. Kjo na ka mundësuar që të nxjerrim disa raporte të personalizuar të cilat janë kërkuar nga Bordi i Drejtorëve dhe nga menaxhmenti i kompanisë. Në ndërkohe e kemi hap një tender për furnizim me server të ri për programin e kontabilitetit.

Kemi bërë automatizimin e krijimit të backup-it për data bazat FM2013, CRS, GIS dhe Vektor si dhe rregullimi i indekseve të tabelave çdo ditë pas mesnate, ashtu që të mos ndikohet në performancën e sistemit gjatë ditës.

Një tjetër problem ka qenë ndërprerja e plotë e sistemit të GIS për një ditë e cila është shkaktuar nga një .log fajl i cili e kishte "pushtuar" tërë hapësirën e diskut të Serverit. Kjo na ka detyruar të mendojmë në blerjen e një serveri të ri për GIS dhe shqyrtimin e mundësisë së migrimit nga ky server në një server tjetër të ri sepse hapësira e tij tashmë është e kufizuar për sasinë e informatave që janë duke u ruajtur në të.

Sektori ka bërë edhe mirëmbajtjen e web faqes së kompanisë sipas kërkesave të menaxhmentit dhe të ARRU. Informatat janë përditësuar rregullisht dhe janë mirëmbajtur ashtu që faqja të jetë lehtë e qasshme, intuitive dhe informative.

Sektori i Administrimit të Sigurisë Informatike - Siguria informatike është një nga elementet më të rëndësishme të sistemit të TI. Siguria informatike është duke u identifikuar si problemi më i madh global në teknologjinë informatike dhe si i tillë duhet të adresohet me mjete dhe resurse adekuate.

Problemet me të cilat në përgjithësi jemi përballur sivjet kanë qenë: Problemet harduerike (teknike), problemet softuerike, problemet me programin e Faturimit, mungesa e njohurive më të thella për Teknologji Informatike të shfrytëzuesve të resurseve të Teknologjisë Informatike dhe Problemi me viruse që barteshin nga interneti dhe USB.

Një problem specifik që ka filluar të bëhet gjithnjë e më i përhapur gjithandej në sektorin e IT është problemi i sigurisë informatike i cili rrezikon në masë të madhe integritetin e sistemeve. Ky problem tashmë është i pranuar edhe ndërkombëtarisht dhe shpresojmë se do të ndërmerren hapa të nevojshëm ligjor që këto problem të adresohen edhe në aspektin ligjor përveç atij teknik, me të cilin jemi duke u adresuar tashme.

Problemet softuerike kryesisht kanë të bëjnë me ato raste ku sistemet janë të pa-licencuara sepse ato kanë prirje më të larta që të shkaktojnë probleme të natyrës së sigurisë softuerike.

Një masë e përditësuar sivjet në administrimin e sigurisë së sistemit të teknologjisë informatike është futja e të gjithë kompjuterëve në Domen. Me këtë mundësohet administrimi i centralizuar i kompjuterëve, shfrytëzuesve dhe resurseve tjera periferike të teknologjisë informatike. Po ashtu kemi vendosur disa rregulla përmes Group Policy në Domain Controller. Këto Group Policy mundësojnë që shfrytëzuesit të mos mund të qasen në faqet që konsumojnë panevojshëm resurse të rrjetit.

Kemi konfiguruar një Server në të cilin është instaluar një aplikacion i grupit të aplikacioneve DNS Sinkhole, i cili mundëson që trafiku i internetit të filtrohet nga miliona domene të padëshirueshme që dërgojnë reklama dhe informata të pa kërkuara. Me rifreskimin e databazës së reklamave në AD NETWORK BLOCKER, shtimin e disa RegEXC dhe shtimin e tri resurseve të reja të listave për bllokim të reklamave, numri i domeneve të padëshiruara të bllokuara tani është afro 4.3 milion domene ose rreth 28.9% e trafikut të përgjithshëm të internetit në kompani.

Po ashtu kemi marrë të gjitha masat e sigurisë që kanë të bëjnë me portet e cënueshme si porti 3389 për qasje në kompjuter nga largësia.

Një problem shumë i madh me të cilin në vitin 2021 është përballur kompania ka qenë infektimi me programe të padëshirueshme si viruse, trojanë, worm etj. të cilat në kompani përcilleshim përmes USB dhe të cilat kishin prejardhje nga interneti. Implementimi i masave të përmendura më

lartë si implementimi i Intranetit dhe Parimeve të shfrytëzimit të resurseve informatike do të zvogëlonte dukshëm këtë fenomen në kompani.

Mungesa e dhomës së dedikuar të serverëve në kompaninë tonë është identifikuar si një problem shumë serioz i sigurisë informatike pasi që dhoma aktuale serverëve është lehtë e qasshme.

Sugjerime dhe propozime për përmirësimin e performancës së Departamentit të Teknologjisë Informatike – departamenti i TI vlerëson se ka shumë hapësirë për përmirësime në këtë departament. Përmirësimet kryesore në të cilat kompania duhet të fokusohet janë:

- Prokurimi i një programi të ERP
- Ekzekutimi i rrjetës së re kompjuterike në Drejtorinë e kompanisë dhe në zyrat e Njësive Operative
- Përmirësimi i sigurisë së sistemit si në aspektin fizik ashtu edhe në atë softuerik.
- Përditësimi i databazës me informacione të cilat aktualisht nuk janë në data bazë.
- Prokurimi i licencave të Sistemeve Operative dhe Aplikacioneve.
- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve në përdorimin e sigurtë të pajisjeve të TI
- Përpilimi dhe detyrimi i zbatimit të *Parimeve të Shfrytëzimit të Resurseve Informatike të Kompanisë*

Konkluzion – Përkundër të gjitha vështirësive të hasura gjatë vitit 2021 për shkak të ngjarjeve katastrofike që kanë ndodhur gjatë vitit, sistemi si tërësi ka pas një performancë të kënaqshme por ende ka hapësirë për përmirësime si në infrastrukturë, softuerë (veçanërisht me prokurimin e një sistemi ERP), siguri fizike dhe softuerike, si dhe në avancimin e njohurive për Teknologji Informatike.

Shërbimi për konsumatorë

Sektori për MKP me qëllim të harmonizimit (bashkërenditjes) sa më të mirë të punëve dhe detyrave të punës në mes të shërbimeve për konsumator në Kompani, në funksion të realizimit të objektivave kryesore të Kompanisë dhe arritjes së standardeve shërbyese për të gjithë konsumatorët e vet brenda zonës së definuar të furnizimit pa dallim, në nivelin e ndërmarrjeve të vendeve në rajon, ka vepruar në drejtim të:

Plotësimit të hartimit dhe jetësimit të proceduarve interne për veprime përkatëse të Kompanisë

Sektori për Marrdhenje me Konsumatorë ka hartuar në pajtim me kornizën ligjore për ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe tani po implementohen këto procedurat interne: Procedura për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve; Procedura e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit; Procedura për Matjen e Konsumit të Ujit ; Procedura për Ndërprerjen e Shërbimeve të Ujit; Procedura për Menaxhimin dhe Kontrollimin e Debitorve etj.

Përmirësimi të relacioneve me konsumatorë

Kujdes i duhur i është kushtuar: Funksionimit të qendres së thirrjes; Pranimit dhe zgjidhjes me kohë dhe të drejtë të ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve; Përkujdesjes së duhur ndaj konsumatorëve për pajisje me Kontrata të Shërbimit, Marrëveshjet për Riprogramimin e borxheve të konsumatorëve; Menaxhimin e debitorve; Ngritjes së nivelit të komunikimit kompani-konsumatorë (informimi i plotë, i drejtë dhe me kohë i konsumatorëve mbi aktivitetet e Kompanisë, përmes mediave, në mënyrë elektronike etj.);

Zhvillimit të marketingut të nevojshëm për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve për pagesat e faturave dhe racionalizimit të shpenzimit të ujit;

Përmirësimi të relacioneve menaxhuese në Kompani


Sektori për Marrdhenje me Konsumatorë rëndësi të veçantë i ka kushtuar ngritjes së shkallës së azhuritit në shkëmbimin e informacioneve, raporteve zyrtare në mes të sektorëve dhe

departamenteve të Kompanisë për bashkërenditje dhe organizim adekuat të veprimeve përbrenda kompanisë në drejtim të: Planifikimit dhe Inspektimit, identifikimit dhe procedimit të mëtutjeshëm të Kyçjeve ilegale dhe rasteve të shfrytëzimit të paligjshëm të shërbimeve të ujësjellësit; Planifikimit dhe veprimit të kordinuar në ndërmarrjen e ekzekutimit të Shkqçjes së konsumatorëve borxhlinj nga ana e Departamentit të Shitjes dhe ekipeve të shkqçjes; Përpilimit të skemave për stimulimin e grupeve të Shkqçjes dhe Kontroles; Riprogramimit të pagesës së borxheve të konsumatorëve në këste; Matjes dhe faturimit të ujit të konsumuar; Pengimit të keqpërdorimit të shërbimeve të ujësjellësit përmes bllobimit të ujmatësve, me qëllim të ngritjes së shkallës së arkëtimit dhe zvogëlimit të keqpërdorimeve janë iniciuar dhe zbatuar procedurat për shkqçje të konsumatorëve të pandërgjegjshëm me borxhe të akumuluar, sipas procedurave të përcaktuara nga ARRU-ja ,poashtu edhe të objekteve të braktisura për identifikimin dhe anulimin e paraqitjeve të dyfishta.

Raporti i Njoftimeve për Shkqçje gjatë vitit 2021 në raport me vitin 2020

	Përshkrimi	2020	2021	Ndryshimi i krahasuar me 2020
1	Njoftimet për Shkqçje	343	220	35.68 %më pak

Grafikoni i Njoftimeve për Shkqçje gjatë vitit 2021 në raport me vitin 2020



Për shkak të gjendjes së krijuar nga COVID-19 , dhe duke iu referuar vendimit të Autoritetit Rregullativ lidhur me pezullimin e konsumatorve për shkqçje gjatë vitit 2021 janë dërguar njoftime për shkqçje, ku si total janë dërguar gjithsejtë 220 vërejtje.

Gjatë vitit 2021 për shkak të gjendjes së krijuar nuk kemi mundur të kemi rezultate të mëdha në lidhje me borxhet e vjetërsuara. Është bërë identifikimi i konsumatorve të cilët kanë borxhe të akumuluar, kemi vazhduar pastaj me konsumatorët që nuk kanë pagesa brenda një viti, si dhe identifikimi i tyre në teren për gjendjen reale të tyre, për inkasimin e mjeteve më shumë jemi fokusuar tek ndjekja e rrugëve ligjore, nëpërmes përmbartësve privat. Edhe ky vit ishte i vështirë gjatë komunikimit me konsumatorë, pasi që arsyeja që nxjerrin për mos pagesë është situata aktuale prej pandemisë, nga qendra e thirrjeve janë thirrë më shumë se 640 konsumator lidhur me akumulimin e borxhit të tyre, si vlerë nga thirrjet janë inkasuar afër : 18420 euro, po ashtu janë thirrë edhe konsumatorë që nuk i janë përmbajtur ratave me këste dhe janë bërë lista për procedura të mëtutjeshme, sipas rregullorve në fuqi.

Veprimet e përkujdesjes për konsumatorë –Kërkesat dhe Ankesat e konsumatorëve

Përkujdesja për konsumatorë është zhvilluar në vazhdimësi në pranimin e përditshëm të ankesave / kërkesave me shkrim, telefonatave, apo kontaktit të përditshëm me konsumatorë, edhe në evidentimin, shqyrtimin, zgjidhjen dhe vendosjen lidhur me ankesat / kërkesat e parashtruara të konsumatorëve.

Menaxhimi i ankesave/kërkesave të konsumatorëve, bëhet përmes modulit të instaluar në Sektorin për Marrdhenje me Konsumator, është kërkuar që të instalohet dhe në shërbimet tjera

përkatesë për konsumatorë, për të mundësuar koordinimin e plotë interaktiv në shqyrtimin, zgjidhjen dhe vendosjen lidhur me ankesat/kërkesat.

Ankesat/Kërkesat e parashtruara nga konsumatorët janë trajtuar dhe vendosur në pajtim me Rregulloren 01/2017 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve, të bazuara me dispozitat e përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

Siq shihet edhe në tabelar kemi rritje të numrit të Kërkesave teknike dhe komerciale pasi në vitin 2021 është bërë edhe ndarja në programin CRS, ku i kemi futur të gjitha kërkesat teknike dhe komerciale.

Raporti i Ankesave/Kërkesave

Nr.	Përshkrimi	2020	2021	Ndryshimi krahasuar me 2020
1	Gjithsejtë Ankesa/Kërkesa të pranuar	3713	3769	1.51% më shumë
2	Ankesa/Kërkesa teknike	3009	1015	65.16% më shumë
3	Ankesa/Kërkesa komerciale	704	2754	291.19 më shumë
4	Të shlytuara dhe zgjidhura me kohë	3713	3748	0.94 % më shumë

Spektori Marrdhenje për Konsumatorë ka bërë pranimin dhe procedimin e aplikacioneve për kyçe të reja në shërbimet përkatesë, më pas lidhjen e kontratave të shërbimeve me konsumatorët e kyçur, në të gjitha rastet e kyçjeve të rregullta dhe legalizimeve kur konsumatori ka ardhë në kompani si dhe regjistrimin e tyre si konsumatorë. Konsumatorët i ka pajisur me Kontratë të Shërbimeve edhe në rastet kur ata kanë kërkuar ndonjë shërbim.

Raporti i Kyçjeve dhe Kontratave të shërbimeve në vitin 2020 dhe 2021


Nr.	Përshkrimi	2020	2021	Ndryshimi krahasuar me 2020
1	Marrëveshjet për riprogramim të pagesës të borxhit	328	700	113.41% më shumë
Nr.	Përshkrimi	2020	2021	Ndryshimi krahasuar me me 2020
1	Kyçe të reja gjithsejt	2839	2047	27.90% më pak
2	Kyçe me procedurë të rregullt	1967	689	64.97 më pak
3	Kyçe me paraqitje të detyrueshme kontrolla	872	1358	55.73% më shumë
4	Kontata të Shërbimeve, të realizuara	3246	2904	10.54 % më pak

Grafikoni- i Marrëveshjeve për Riprogramim të Pagesës së Borxhit në Këste

Përmes Sektorit për Marrdhenje me Konsumatorë janë arritur marrëveshje për riprogramime të pagesës së borxheve më këste me ata konsumatorë të cilët në pamundësi të pagesës së

menjëhershme të borxhit kanë kërkuar të i'u mundësohet pagesa me këste ku në vitin 2021 kemi pasur një rritje të madhe të numrit të riprogramimeve të borxhit .

Grafikoni- i Marrëveshjeve për Riprogramim të Pagesës së Borxhit në Këste



Kontaktet e rregullta janë mbajtur me **ARRU** –në , si me raportimin e të dhënave për relacionet e zhvilluara mujore Kompani-Konsumator, poashtu edhe me **KZAK**– nënkupton komisionin për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve lidhur me shërbime të ujit, si organ përfundimtar në procedurën administrative në ARRU të Konsumatorëve, ku nga ana e shërbimit tonë i'u janë afruar të gjitha përgjigjet dhe dokumentacionet e nevojshme të kërkuara.

Është marrë pjesë aktive në të gjitha takimet e punës të organizuara nga **ARRU** -ja . Poashtu kontakte përmes emailit apo direkt janë zhvilluar sa herë që është paraqitur nevoja për sqarime në interpretim të rregullave, për zgjidhjen e problemeve të veçanta.

Hulumtimi i Opinionit të Konsumatorëve

KRU "Gjakova" SH.A. për të njohur më mirë opinionet dhe perceptimet e konsumatorëve, për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit që ka ofruar gjatë vitit 2021, është duke zhvilluar një hulumtim të opinionit të konsumatorëve.

Qëllimi i hulumtimit është që KRU "Gjakova" SH.A. dhe palët tjera të interesuara të njoftohen me qëndrimet e konsumatorëve për shërbimet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit gjatë vitit 2021, në tërë zonën shërbyese të KRU "Gjakova" SH.A. për të krijuar një pasqyrë të këtyre shërbimeve në aspektin e kënaqësisë së konsumatorëve. Gjetjet nga ky hulumtim do të përdoren si udhërrëfyes për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të përmirësuar nivelin e shërbimeve në të cilat adresohen shqetësimet e konsumatorëve, dhe avanconin imazhin e kompanisë.

Informimi

Edhe gjatë vitit 2021 Sektori për Marrdhenje me Konsumatorë, në bashkpunim me zyrën për informim ka arritur të prezantoj me sukses të gjitha ngjarjet ,zhvillimet, informatat dhe të arriturat duke luajtur një rol kyq në informimin e opinionit për të gjitha risit e kompanisë ,duke qenë ndërmjetësuese e denjë .

Deri me 31.12.2021 në total janë të lidhura 24,244 kontrata me konsumatorët.

e.)TRANSAKSIONET E KONSIDERUESHME QË PËRFSHIJNË K.R.U."GJAKOVA "SH.A. GJAT VITIT 2021

Titulli i Aktivitetit të prokurimit	Operatori Ekonomik Fitues i Tenderit	Data e nënshkrimit kontratës	Vlera e Kontratës së nënshkruar
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit Brekoci III (Lagja e Jetishëve) -punë shtesë	" K-ING " SH.P.K., Kalabria Blloku A1 Llamella B K5/18, 10000, PRISHTINË	08.01.2021	€ 2,578.56
Furnizim - Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijes për të gjitha njësitë me pjesë më të mëdha se 2" (coll) dhe më të vogla se 2" (coll)" - Ritender	N.P.T. "Xërxa", XËRXË, -, XËRXË	11.01.2021	€ 1,200,000.00
Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informatike për KRU Gjakova - Ritender	TECH VISION SH.P.K., Aktash 1, PRISHTINË	10.02.2021	€ 13,440.00
Furnizim me material hixhenik	Shaip Mustafa B.I., Pal Palucaj, 10000, PRISHTINË	19.02.2021	€ 2,417.95
Hulumtimi i Kënaqshmerisë së Konsumatorve për shërbimet e ofruara nga K.R.U " Gjakova" Sh.A për vitin 2020	N.SH. " ASIXON ", Mustafa Venhari, SU 7/2,H-1,Nr.5, -, PRISHTINË	23.02.2021	€ 1,650.00
Furnizim i punëtorëve me mjete pune për të gjitha njësitë-Ritender 2	N.P.T. " Bajra ", Lidhja e Prizrenit, Prishtine.	17.09.2021	€ 13,993.01
Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Hasit të Prizrenit –faza 1	Grup i Operatorëve Ekonomik FIDANI- BETON SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K., Arben Qerimaj , Nr 180, 51000, Baballoq / Deçan	28.04.2021	€ 266,796.70
Servisimi i pompave dhe rimbështellja e motorëve të KRU Gjakova sh.a.	" AULONA " SH.P.K., Pjeter Bogdani, Gjakovë,	22.04.2021	€ 27,000.00
Mirëmbajtja e bazës së të dhënave të Kompanisë	Fatmir Murtezaj, RR.Naum Veqilharxhi nr.35, Fushe Kosove	13.04.2021	€ 3,510.00
Furnizim me autogoma dhe bateri për nevojat e KRU Gjakova	„ Eurogoma " Sh.p.k., Ish Fabrika e Qumshtit, FUSHË KOSOVË	30.04.2021	€ 67,456.30
Sherbime televizive informative dhe përcjellja e aktiviteteve të KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë	"Syri" Sh.p.k., Kolë Lleshi 28, GJAKOVË	21.04.2021	€ 6,000.00
Furnizim me klorur të Hekurit FeCl3	" Profitech " SH.P.K., Rr. Ilaz Kodra Nr. 5, Prishtine	14.05.2021	€ 16,380.00
Mirëmbajtja/ Servisimi i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a.	Ilir Noshi, yjet e erenikut, gjakove	15.06.2021	€ 230,000.00

Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Xërxe, Gexhë, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol	Grup i Operatorëve Ekonomik Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K., Rr. Arben Qerimaj , Nr 180, Deçan	03.06.2021	€ 456,397.61
Furnizim me rroba pune- ritender	EXIM JATEX SH.P.K., Nëna Terezë pa nr., Gjakovë	30.07.2021	€ 17,030.00
Asfaltimi i pjesëve ku është dëmtuar asfalti me rastin e defekteve nëpër terë njësit e kompanisë për KRU Gjakova	BERISHA COM SH.P.K., GJAKOVË, UJEZ	06.07.2021	€ 69,564.00
Rrethoja e objekteve (trafos dhe stacionit të pompave) në Sopot	N.SH.T. VIKTORY COM, Rr. Tirana, 50000, Gjakovë	13.07.2021	€ 16,093.54
Sherbimet e Internetit	Ati - Kos SH.P.K., rr. "Tirana", GJAKOVË	25.06.2021	€ 3,972.00
Furnizim me material elektrik për nevojat e mirëmbajtjes elektrike (ndiqimi për objekte, ormanet elektrik, rele niveli, kablo, ndërprerës automatik)- Ritender 3	Eor Group SH.P.K., Dëshmorët e Ponoshecit, PRISHTINË	30.11.2021	€ 30,649.02
Asfaltimi i rrugës nga rruga kryesore deri te rezervoari në Batush dhe objekti administrativ, L=900m	"Euroasphalt "Sh.p.k., Skenderbeu (Jasht Qytetit), GJAKOVË	12.08.2021	€ 47,981.00
Furnizim me material të shtypur	N.T. "Agimi- De", Sheshi Mentor Tolaj, DEÇAN	11.08.2021	€ 8,900.80
Furnizim me Kompjuter dhe Laptop për KRU 'Gjakova' sha	STORM ICT L.L.C., RR. Tahir Zajmi p/n, PRISHTINË	27.08.2021	€ 13,473.00
Furnizim me Pjesë rezervë të pajisjeve të Teknologjisë Informatike për KRU Gjakova- Ritender	ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, GRACANICA	26.11.2021	€ 1,505.00
Furnizim me Barriera (rampa)	"BEHARI" SH.P.K., L.e Pejës, FUSHË KOSOVË	26.08.2021	€ 3,150.00
Furnizim me Sulfat alumini Al ₂ SO ₄ x nH ₂ O	Seykos SH.P.K., 28 Nëntori - Dardani, PRISHTINË	10.09.2021	€ 33,600.00
Aparate kundër zjarrit	'TEKNIKU' SH.P.K., KOMPL.INDUSTR.T EKNIKU/MAGJ.GJAKOVË-PRISHTINË, Kosovo	24.09.2021	€ 1,450.00
Furnizim me Serverë	Grup i Operatorëve Ekonomik AYEFL EET L.L.C.; global CT Digital Kosovo SH.P.K.,	29.10.2021	€ 23,531.34

	Arberia 3, Veranda C2/7, Prishtinë		
Furnizim me material laboratorik Fiziko-Kimik dhe Bakteriologjik për nevojat e KRU "GJAKOVA" SH.A	N.T.P "ERAMED", Vasil Andoni, PRISHTINË	11.11.2021	€ 40,205.40
Rrethoja e parcellës te Diga (në mes të rrugës dhe gjelbërimit) te Liqeni- Ritender	" Eko Term " SH.P.K., Brigada 123 pn, 23000, Suhareke	09.12.2021	€ 9,288.00
Mbulimi i gypave DN 250mm që furnizojn me ujë të pijes 34 fshatrat e Rekes së keqe afër kaptazhës	" V - SHEHU " SH.P.K., Junik, Junik	25.10.2021	€ 14,493.50
Furnizim me pelet për NJ.O. Rahovec dhe NJ.O. Reka e Keqe	N.T.P."GRESA - COMMERCE ", Pirane, -, PIRANE	11.11.2021	€ 1,952.00
Furnizim me pompa dozuese te klorit	" HPI " SH.P.K., Prishtinë, 10000, Prishtinë	13.12.2021	€ 6,750.00
Dekorimi i Objektit te drejtorise për festat e fund vitit	Luljeta Partolla B.I., uck, 50000, gjakova	09.12.2021	€ 2,723.00
Furnizim me pajisje për zyre për Nj.O. Batushë	NTSH,,Nobeli" Rr,,Ferhat Binishi pn" Gjakovë	22.01.2021	€ 971.00
Furnizimi me Invertor 4000VA për zyren e Fakturimit të KRU Gjakova	'Lena' SHPK, Rr 'Bardhyl Qaushi' p.n, Gjakovë	25.01.2021	€ 970.00
Reklama ndriqese me emërtim të Kompanisë KRU" Gjakova" për Nj.O. Batushë	D.P.Z. 'D-Creation' Rr. 'Orize'/p.n, Gjakovë	16.02.2021	€ 970.00
Pastrimi i xhamave të Objektit Administrativ – Drejtorisë	N.Sh 'Beni Clean' Rr. 'Fehmi Agani' 167 Gjakovë	10.03.2021	€ 960.00
Furnizimi me kubza nga betoni per nevojat e ekipeve te mirembajtjes se KRU Gjakova	'Kulla- AH' SHPK, Rr. 'Vaso Pash Shkodrani' Gjakovë	22.04.2021	€ 910.00
Furnizimi me blloka te cimentos nga betoni dhe cemento per nevojat e ekipeve te mirembajtjes se KRU Gjakova.	'Kastrati Bau' Rr 'Mark Malota', Gjakovë	12.05.2021	€ 952.20
Furnizim me Rafta metalik pesë rendësh per nevojat e kompanisë	D.P.T.,Agrofititmi" Rr,,K.Bujanit "p.n, Gjakovë	17.05.2021	€ 950.00
Prerja e gypit metalik DN280	Gjelbrim Fetija BI, rr. 'Uçk', Gjakovë	29.06.2021	€ 965.00
Furnizim me material metalik	'Haki Juniku' BI, rr 'Skenderbeu' Gjakovë	28.07.2021	€ 972.00
Shpenzime për marketing, reklama, fletëpalosje, material propagandistik	N.T.SH."Nobeli", Nëna Terezë, 50000, GJAKOVË	16.12.2021	€ 969.00
TOTALI:			€2,663,520.93

f.) SYGJERIME DHE PROPOZIME PËR NDRYSHIME TË CILAT ME ARSYE PRITET QË TË RRISIN PERFORMANCEN E NP

- Të ofrojmë shërbime të pandërprera për të gjithë konsumatorët
- Të përmbushim apo të tejkalojmë të gjitha nivelet e aktiviteteve të planifikuara në mirëmbajtje.
- Të furnizojmë ujë cilësor dhe me efektshmëri më të mundshme mjedisore, duke i përmbushur pothuaj të gjitha në afat
- Të përmbushim apo edhe tejkalojmë monitorimin e të gjitha detyrave
- Të zvogëlojmë humbjet e ujit.
- Të mirëmbajmë funksionalitetin e mbarë infrastrukturës
- Të bëjmë investimet e planifikuara dhe të kumund të shfaqen e kushtet mundë të vihet në rrezik biznesi jonë
- Të planifikojmë zvogëlimin e shpenzimeve për energji dhe karburante
- Të bëjmë planifikimin e investimeve vetanake
- Të arrijmë të përmbushim kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve
- Të furnizojmë shërbime cilësore dhe në kufijtë e parametrave të lejuara, sipas standardeve.
- Të reduktojmë në masë të madhe rrezikun nga përmytjet nga kanalizimi fekale dhe atmosferik, gjatë periudhave me të reshura me intezitet dhe kohë të tej zgjatur
- Të angazhohemi në mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve tanë, dhe kjo të jetë aktivitet qenësor në vazhdimësi.
- Të shtojmë kontrollin e shpenzimeve dhe të këmbëngulim për rritjen e të hyrave nga arkëtimi



K.R.U."GJAKOVA"SH.A
Rr."U.Ç.K" nr. 7 –Gjakovë ,Kosovë
www.gjakova.com